



PUNIM I POLITIKAVE

Nr.1 /16 – qershor 2016

Çfarë ndodhi me shqiptarët e Kosovës:

**Ndikimi i religjionit në identitetin etnik në
periudhën e shtet-ndërtimit**

Ky projekt është përkrahur nga Ambasada Norvegjeze në Prishtinë



Me përkrahje institucionale të Ambasadës së Francës në Prishtinë

Përmbajtja dhe pikëpamjet të shprehura në këtë botim janë të KIPRED-it, dhe nuk mund të merren si pikëpamje të donatorit.

Përgatitur nga: Agon Demjaha dhe Lulzim Peci

Kontribues: Mentor Agani dhe Gent Gjikolli

Vërejtje përkthimi: Versioni origjinal i punimit është punar në gjuhën angleze

Copyright © 2016, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org apo: +381 38 227 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave

Rr. Abdyl Frashëri 44

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni dhe faksi: +381 38 227 778

www.kipred.org

Përmbajtja:

Përmbledhje Ekzekutive	4.
Hyrje	8.
I. Origjina sekulare e nacionalizimit shqiptar	9.
II. Identiteti etnik shqiptar dhe religjioni në Jugosllavi(të)	20.
III. Shqiptarët e Kosovës: Lidhja në mes të identitetit dhe përkatësisë fetare.....	24.
IV. Analiza e hulumtimit të opinionit publik	74.
V. Konkluzione dhe rekomandime	80.

Përmbledhje Ekzekutive

Kuptimi i zhvillimit të natyrës sekulare të identitetit kombëtar shqiptar paraqet pikën fillestare të analizimit të ndikimit të religjionit në ndërrimin e identitetit etnik të shqiptarëve të Kosovës, të cilët, gjatë shekullit të kaluar, vazhdimisht kanë kultivuar sekularizmin dhe bashkëjetesën fetare si një instrument i nacionalizmit vetëmbrojtës.

Procesi i Rilindjes Kombëtare filloi si një fenomen i elitar, gjegjësisht si një lëvizje lartë-poshtë kulturore. Përveç vonesës së tij, nacionalizmi shqiptar ka pasur edhe një veçori tjetër të veçantë krahasuar me popujt e tjerë të Ballkanit – ky nacionalizëm ishte sekular si në origjinë ashtu edhe në karakter. Pasi Perandoria Osmane dhe fqinjët e saj insistonin që të bënin ndarjen e shqiptarëve sipas linjave të tyre fetare, për rilindësit shqiptarë ishte vendimtare tejkalimi i ndasive fetare duke zgjedhur një identitet sekular nacional, i cili do të ishte i bazuar në “unifikimin kulturor dhe gjuhësor”. Prandaj, sekularizmi – fillimisht duke qenë së pari shqiptar, i shoqëruar me bashkëjetesën fetare, u bë tipar kyç i nacionalizmit shqiptar.

Gjatë sundimit pothuajse 90 vjeçar të Jugosllavisë/Serbisë, nacionalizmi shqiptar në Kosovë vazhdoi të ishte sekular për nga natyra. Një realitet i tillë shtroi trasenë e një nacionalizmi të ri shqiptar në Kosovë, dhe i strukturoi referencat e tija kolektive si vetëmbrojtje e identitetit etnik, që i kundërvijehet fetarizimit që përdorej si një instrument për asimilim. Procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe beteja për pavarësi gjatë periudhës 1989-1999 shënoi homogjenizmin më të fortë shoqëror të shqiptarëve të Kosovës. Tiparet kryesore të nacionalizmit shqiptar gjatë kësaj kohe u karakterizuan me një orientim pro-perëndimor dhe me një unifikim të përgjithshëm të shqiptarëve pavarësisht prej sfondit shoqëror apo fetare.

Megjithatë, pas çlirimit dhe vendosjes së Administratës së Kombeve të Bashkuara, ngjashëm me vendet e tjera ish-komuniste, rigjallërimi i religjionit filloi edhe në Kosovë. Rrethanat e reja në mënyrë të pashmangshme kanë shkaktuar një proces të transformimit dhe ridefinimit të pozitës së religjionit. Prezenca e Islamit dhe Krishterimit u bënë të dukshme dhe të theksuara në të gjitha sferat publike, duke filluar nga jeta personale deri në shoqërinë e gjerë, përfshirë edhe politikën. Pasojat e luftës kishin krijuar rrethana të reja në vitet e para pas vitit 1999, duke ofruar një terren të frytshëm për fetarizimin e shoqërisë. Fillimisht vendi u ballafaqua me një dezorientim shoqëror, varfëri të lartë, ekonomi të dobët dhe dykuptimësi politike, të cilat e shndërruan Kosovën në tokë pjellore për rigjallërimin e religjionit. E tërë shoqëria kosovare shumë shpejt u ekspozua me një shumëllojshmëri të ideve konkurruese, të cilat në të njëjtën kohë ishin edhe më liberale dhe më konservative.

Popullata e Kosovës e rrënuar nga lufta ju ekspozua organizata të ndryshme ndërkombëtare me bazë fetare dhe me agjenda radikale, të cilat u përhapën në vend pas luftës. Nën maskën e ndihmës humanitare, këto organizata kanë përdorur pa mëshirë varfërinë dhe kushtet shoqërore të kosovarëve, veçanërisht në hapësirat rurale, duke dëmtuar seriozisht traditat kulturore të këtyre komuniteteve. Veç kësaj, gjatë kësaj periudhe, ndryshimet demokratike kanë mundësuar zhvillimin e lidhjeve të reja në mes të Kosovës dhe botës islame, duke favorizuar kështu përtëritjen e doktrinave të ndryshme religjioze. Rigjallërimi i islamit në Kosovë në njërin anë u ndikua nga organizatat e Arabisë Saudite dhe shtetet e Gjirit Persik, dhe Turqia në anën tjetër. Gjerësisht, qëllimi primar i tyre ishte kontrollimi i jetës shpirtërore të popullatës, politizimi i islamit dhe inkurajimi i kundërshtimit të sekularizmit në Kosovë, qëllimi kryesor i shumicës së organizatave të Lindjes së Mesme ishte prezantimi dhe përforsimi i islamit radikal, i cili gjithashtu shkaktoi fërkime brenda Bashkësisë Islame të Kosovës. Për më tepër ata përpiqeshin të dobësojnë ndjenjën nacionale të shqiptarëve dhe qëndrimin e tyre pro-perëndimor që dominon në Kosovë, përmes forcimit të solidaritetit mysliman ndër shqiptar në llogari të identiteti etnik sekular . Si pasojë, çështja njëherë e pakontestuar rreth modelit të islamit në Kosovë, si model i veçantë tradicional, gradualisht filloi të ndryshojë, e me të edhe identiteti etnik i shqiptarëve të Kosovës dhe bashkëjetesa e tyre fetare.

Periudha që nga Shpallja e Pavarësisë është e një rëndësie të jashtëzakonshme, pasi ajo karakterizohet me shfaqjen e disa faktorëve të posaçëm. Fillimisht, pavarësia e Kosovës nënkupton se elita politike kosovare, në veçanti qeveria, e kishte rritur autoritetin si dhe përgjegjësinë në lidhje me të gjitha çështjet e rëndësishme në vend. Së dyti, Shpallja e Pavarësisë formalizoi fillimin e një procesi të krijimit të një identiteti të ri kosovar për shqiptarët e Kosovës. Një proces i tillë krijoi një hapësirë shtesë për të manovruar dhe forcuar identitetin fetar (mysliman). Së treti, Shpallja e Pavarësisë së Kosovës koincidoi me ekspansionin global të rrjeteve radikale islamike, të ashtuquajturave “Pranvera Arabe” dhe krijimin e të ashtuquajturit “Shtetit Islamik të Irakut dhe Sirisë” (ISIS). Këta faktorë së bashku kanë krijuar një realitet që ka rezultuar në radikalizmin dhe ekstremizmin e shtresave të caktuara të shqiptarëve myslimanë në Kosovë.

Qëndrimi i institucioneve të Kosovës dhe elitës së saj politike ndaj islamit politik në përgjithësi, dhe radikalizimit të tij në Kosovë, në veçanti, ka qenë së paku i paqartë. Edhe pse të gjitha partitë kryesore politike në Kosovë janë sekulare, ato në përgjithësi kanë dështuar në adresimin e shenjave gjithnjë në rritje të radikalizmit në mesin e shqiptarëve myslimanë të Kosovës. Me përjashtim të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e cila në mënyrë të hapur ka dënuar fjalimet e tilla publike, partitë e tjera politike kanë qëndruar mjaft të heshtura në këtë drejtim. Fatkeqësisht, shumica e

partive të tjera politike kanë flirtuar me grupet e tilla radikale me qëllim të sigurimit të mbështetjes elektorale.

Për sa i përket religjionit dhe ndërrimit të identitetit në mesin e shqiptarëve të Kosovës, krijimi i identitetit të ri kosovar paraqet një pasojë tjetër të rëndësishme të pavarësisë së Kosovës. Shqiptarët e Kosovës, të cilët kanë kultivuar një identitet të fortë etnik, pas pavarësisë janë përballur me një realitet paksa konfuz. Pas përfundimit të projektit politik për një Kosovë të pavarur, ata papritur ju ekspozuan lojaliteteve divergjente. Natyrisht, duke qenë një shtet i pavarur, Kosova u përballë me sfidën e krijimit të një identiteti kombëtar sekular, i cili do të mund të tejkalonte ndarjet etnike dhe fetare. Si rezultat, simbolet e shtetit të ri, si flamuri dhe himni kombëtar iu shmangën çdo simboli kombëtar shqiptar nga e kaluara. Megjithatë, “ri-brendimi” i Kosovës ka pasur në mënyrë të pashmangshme një ndikim denacionalizues mbi shqiptarët e Kosovës. Fatkeqësisht, në vend se identiteti shtetëror i Kosovës dhe ai shqiptar të trajtoheshin si komplementare, debatet politike në Kosovë shpeshherë i kanë portretizuar ato si ekskluzive. Si pasojë, besnikëria e shqiptarëve të Kosovës nga koha e pavarësisë është zhvendosur ngadalë nga shqiptaria dhe shteti i Kosovës, në një identitet fetar, me shfaqjen e elementeve të islamit radikal.

Këto gjetje janë mbështetur në rezultatet e sondazheve të opinionit publik, të cilat qartë indikojnë një zhvendosje madhore të identitetit të shqiptarëve të Kosovës nga identiteti sekular etnik në një etni fetare. Gjithashtu, rezultatet e hulumtimit tregojnë që standardi i jetesës nuk është përcaktues as i bashkëjetesës fetare dhe as i mos-tolerances fetare dhe ekstremizmit. Këto rezultate sfidojnë seriozisht paradigmen socio-ekonomike për shpjegimin e mos-tolerances fetare dhe ekstremizmit. Në vend të kësaj, paradigma ideologjike, siç është e dokumentuar gjithashtu edhe nga hulumtimi kualitativ, provon të jetë korniza shpjeguese për zhvendosjet e rëndësishme sociale dhe të identitetit në mesin e shqiptarëve të Kosovës, përkatësisht nga identiteti sekular etnik dhe bashkëjetesës fetare, në një fetarizim të shpejtë etnik, me një rritje graduale të mos-tolerancën fetare dhe ekstremizmit.

Fakti më brengosës që nxirret nga këto gjetje është projektimi, që nëse trendi i tanishëm i de-sekularizmit të identitetit etnik të shqiptarëve të Kosovës vazhdon me të njëjtin ritëm edhe në dy dekadat e ardhshme, atëherë në Kosovë shumë lehtë mund të shfaqen edhe tri sub-identitete nacionale, gjegjësisht, muslimanët shqiptarë, krishterët shqiptarë, dhe shqiptarët (e vjetër). Kjo pa dyshim që do të shënonte përfundimin e shqiptarizmit siç ne e njohim, e me të bashkë edhe fundi i Kosovës sekulare dhe pro-perëndimore.

Rekomandime:

- Institucionet qeveritare dhe udhëheqësit politik duhet që të prezantojnë një diskurs të përbashkët publik i cili do të promovonte identitet sekular dhe bashkëjetesën fetare në mesin e shqiptarëve të Kosovës, si dhe harmoninë në mes të identitetit etnik shqiptar dhe atij kosovar, të cilat janë mjetet më të natyrshme dhe më efikase në trajtimin e religjiozitetin politik, radikalizmit dhe ekstremizmit.
- Meqenëse karakteri sekular i identitetit etnik të shqiptarëve të Kosovës përkon me vlerat moderne evropiane dhe Kushtetutën e Kosovës, ai nuk duhet të shihet si një rrezik nga bashkësia ndërkombëtare për ndërtimin e një vendi koheziv multi-etnik; përkundrazi, një karakter i tillë duhet të konsiderohet si pasuria më e vlefshme për mbrojtjen e rendit të tij sekular kushtetues.
- Sistemi i drejtësisë i Kosovës duhet të zbatojë vemdosshmërisht kornizën ligjore (Kodin Penal) ndaj gjuhës së urrejtjes, për sa i përket urrejtjes fetare dhe etnike, si dhe predikimit të ekstremizmit.
- Ligji për Bashkësitë Fetare duhet të miratohet sa më shpejt që të jetë e mundur, i cili duhet të përcakton vendin këtyre bashkësive në rendin sekular kushtetues të Kosovës, si dhe llogaridhënien e tyre financiare, përfshirë edhe Shkollat e jashtë-ligjshme Kuranore.
- Fakulteti i Shkencave Islame të Kosovës duhet të përfshijnë në planprogramet e tij edhe lëndët e Religjioneve Krahasuese, Historinë e Popullit Shqiptar dhe të Kosovës, si dhe Historinë e Shtetit dhe Ligjit Shqiptar, në mënyrë që t'i shmanget modeleve arsimore të mohimit të së kaluarës fetare dhe nacionale, me qëllim të kultivimit të bashkëjetesës ndër-fetare.
- Planprogramet e shkollave të mesme duhet të përfshijnë lëndën mbi Historinë e identiteteve kulturore dhe fetare në Kosovë, përkatësisht krishterimit romak, krishterimit ortodoks, islamit dhe protestantizmit, në mënyrë që të forcojë mirëkuptimin reciprok dhe bashkëjetesën fetare në vend. Planprogrami dhe tekstet përkatëse duhet të porositen nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, që të hartohen nga një universitet ndërkombëtar i rangut më të lartë në këtë fushë.
- Prishtina duhet t'i korrigjoj marrëdhëniet e saj me Ankaranë në lidhje me ndikimin fetar dhe nënvlerësimin e sekularizmit të shqiptarëve të Kosovës dhe të shtetit të Kosovës. Turqia duhet të kuptojnë se marrëdhëniet miqësore me Kosovën mund të zhvillohen në një mënyrë të shëndetshme, vetëm duke respektuar identitetin sekular etnik të shqiptarëve të Kosovës, si dhe interpretimin e tyre të së kaluarës historike.

Hyrje

Ky punim është një hulumtim hyrës që ka për qëllim të analizoj ndikimin e islamit dhe krishterimit në identitetin etnik të shqiptarëve të Kosovës, të identifikojë ndërrimet e identitetit që janë shfaqur gjatë periudhës së shtet-ndërtimit, si dhe të vë në pah implikimet e tyre për të ardhmen e shoqërisë kosovare dhe vlerave të saj.

Gjatë periudhës së komunizmit, bashkësitë fetare ishin nën kontrollin e shtetit, dhe ndikimi i tyre në shoqëri ka qenë mjaft i kufizuar. Me fillimin e tranzicionit dhe përpjekjeve për çlirimin e Kosovës, në mesin e shqiptarëve etnik ishte zhvilluar një pluralizëm politik, duke u bazuar në sekularizmin e fuqishëm etnik dhe një bashkëjetesë multi-fetare, e cila, si e tillë, përkonte me vlerat dhe aspiratat moderne evropiane. Në të kaluarën, të dy udhëheqësit fetarë shqiptarë, si të krishterë a shtu edhe myslimanë, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ndërtimin e këtij identiteti. Megjithatë, ky identitet sekular shoqëror dhe politik i shqiptarëve të Kosovës, ka filluar të zbehet menjëherë pas luftës së vitit 1999, me ndërhyrjen e organizatave me bazë fetare, të cilat kishin ardhur nga vendet e Lindjes së Mesme. Për më tepër, pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008, islami politik dhe radikal filloi të merr një terren të rëndësishëm në Kosovë, dhe kjo përkoi edhe me "Pranverën Arabe" dhe shfaqjen e "Shtetit Islamik të Irakut dhe Sirisë" - ISIS.

Për të kuptuar më mirë marrëdhëniet në mes të etnisë dhe fesë në mesin e shqiptarëve të Kosovës, dy kapituj e parë të këtij studimi do të merren me analizimin e origjinës sekulare të identitetit kombëtar shqiptar, si dhe me identitetin e shqiptarëve dhe religjionin në Kosovë gjatë sundimit të Jugosllavisë. Analizimi i rolit të fesë mbi ndërrimin e identitetit bashkëkohor politik dhe etnik do të diskutohen në kapitullin e tretë, shqiptarët etnik dhe shtet-ndërtimi i Kosovës: Lidhja në mes të identitetit etnik dhe përkatësisë fetare, ndërsa kapitulli i fundit analizon rezultatet e sondazheve të opinionit publik dhe përforcimin e identitetit fetar në mesin e shqiptarëve të Kosovës. Në fund, ky studim nxjerrë përfundimet në lidhje me identifikimin e faktorëve kyç që kanë ndikuar në përforcimin e identiteteve fetare, në kurriz të identitetit sekular etnik të shqiptarëve të Kosovës, pasojat e tij për të ardhmen e Kosovës, duke ofruar gjithashtu edhe një varg rekomandimesh me qëllim të rritjes së karakterit sekular të identitetit shqiptar të Kosovës dhe të bashkëjetesës multifetare.

I. Origjina sekulare e nacionalizimit shqiptar

Fundi i shekullit të XIX shënon rënien e Perandorisë Osmane dhe fillimin e Rilindjes Kombëtare për popujt e Ballkanit. Ishe pikërisht gjatë kësaj periudhe kur ata “strukturuan çështjet vendore për të mbështetur zgjerimin territorial kombëtar me qëllim të tkurrjes së Perandorisë Osmane, shpeshherë duke u futur në gara reciproke dhe ekskluzive me njëri-tjetrin.”¹ Nën kërcënimin e nacionalizimit serb dhe atij grek si dhe pretendimeve territoriale, shqiptarët që kanë jetuar nën Perandorinë Osmane praktikisht u detyruan që të zhvillojnë agjendat vetanake kombëtare si mjet për vetë-mbrojtje.² Formacionet shtetërore në Ballkan nga fundi i shekullit të XIX dhe në fillim të shekullit XX, i gjetën shqiptarët në një situatë thujse të pazakontë: ata akoma nuk kishin zhvilluar ndonjë ndjesi të fuqishme kombëtare, ndërsa në anën tjetër kishin një lëvizje kombëtare më të dobët krahasuar me popujt e tjerë të Ballkanit.³ Rrjedhimisht, procesi i “nacionalizimit” të shqiptarëve nuk ka qenë i lehtë, jo vetëm për shkak të vonesës relative të tij, por gjithashtu se përgjatë historisë, ata kanë qenë shtetas të shteteve të ndryshme dhe gjithashtu i janë nënshtruar programeve të ndryshme të nacionalizimit.

Gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë, kur idetë liberale të Periudhës së Iluminizmit së bashku me idetë revolucionare të Revolucionit Francez kishin arritur tek popujt e Ballkanit, Rilindja Kombëtare kishte filluar edhe në këtë pjesë të Evropës. Shumë udhëheqës dhe intelektualë shqiptarë, të njohur si Rilindësit, u ndikuan nga idetë Evropës Perëndimore, dhe ju rrekën misionit për të drejtuar kombin e tyre drejt pavarësisë kombëtare. Megjithatë, siç shihet nga analiza e mëposhtme, kur vetëdija kombëtare filloi të rritet midis popujve të ndryshëm në Perandorinë Osmane, shqiptarët tashmë ishin duke praktikuar religjione të ndryshme, duke folur dialekte të ndryshme dhe duke përdorur alfabetë të ndryshme.⁴ Këto ndarje fetare, kulturore dhe sociale gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë kanë penguar shqiptarët nga zhvillimi i një themeli të fortë për ngritjen e vetëdijes së përbashkët kombëtare në një masë të gjerë. Për këtë arsye, rilindësve shqiptarë i është dashur që të zhvillojnë një agjendë të veçantë kombëtare, në mënyrë që të ishte e përshtatshme për të gjithë shqiptarët pavarësisht nga dallimet e tyre fetare, gjuhësore, kulturore, sociale dhe ekonomike. Për më tepër, një agjendë e tillë kombëtare duhej të ishte në gjendje të kapërcente të gjithë faktorët e përmendur më lart, të cilët seriozisht pengonin zhvillimin e një vetëdije të përbashkët kombëtare shqiptare.

¹ Hupchick, Dennis F., *The Balkans: from Constantinople to Communism*. New York: Palgrave Macmillan, 2002, f. 274.

² Ibid, f. 274.

³ Misha, Piro, “Invention of Nationalism: Myth and Amnesia,” in Stephanie Schwandner-Sievers and Bernard Fisher eds. *Albanian Identities: Myth and History*, London: Hurst, 2002, f. 40.

⁴ Vickers, Miranda, *Between Serb and Albanian: A History of Kosovo*. New York: Columbia University Press, 1998, f. 40.

Procesi i Rilindjes Kombëtare Shqiptare ka filluar si një fenomen elitar apo si një lëvizje lartë-poshtë kulturore. Së pari, kjo lëvizje filloi në mesin e Arbëreshëve, të cilët jetonin në Italinë e Jugut, si dhe në disa qendra politike dhe ekonomike të Perandorisë Osmane, siç janë Janina dhe Stambolli. Fillimisht, frymëzimi i nacionalistëve shqiptarë erdhi nga Iluminizmi i Evropës dhe shkrimet e ndryshme të shkollarëve perëndimorë, si dhe udhëtarëve dhe poetëve të ngjashëm. Duke parasyh faktin se perëndimorët kishin vërejtur se shqiptarët përbënin një komunitet të dallueshëm etnografik dhe linguistik, të cilët kishin gjuhën dhe kulturën e tyre të veçantë, ata luajtën një rol të rëndësishëm në ndërtimin e identitetit kombëtar të shqiptarëve.⁵ Rilindësit shqiptarë dëshironin shpëtimin e shqiptarëve nga Perandoria Osmane, ndërsa në të njëjtën kohë kërkonin vazhdimisht përkrahjen dhe drejtimin e fuqive të vendeve të Evropës Perëndimore për arritjen e këtij qëllimi. Në këtë periudhë janë shkruar poezi dhe libra për Skënderbeun, i cili, me kalimin e kohës nga nacionalistët shqiptarë ka marrë një vend qendror si hero kombëtar. Identiteti i Skënderbeut si një princ i krishterë, aleanca me Mbretërinë e Napolit, si dhe njohja që ai kishte marrë nga Vatikani dhe papati – ishin përdorur si argumente për të afirmuar identitetin evropian të shqiptarëve.⁶

Në librin e mirënjohur “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet” në pjesën e cila flet për Skënderbeun, rilindësi i shquar Sami Frashëri e lartëson figurën e Skënderbeut thuajse në përmasa mitologjike. Ai pohon se të gjitha shtetet e Evropës ishin në pritje që Skënderbeu të shpëtonte Evropën.⁷ Po në të njëjtën mënyrë edhe Naim Frashëri (vëllai i Sami Frashërit) në poemën e tij epike “Historia e Skënderbeut” e përshkruan Skënderbeun si simbolin rezistencës shqiptare dhe të krishterë evropiane kundër Osmanëve Myslimanë. Kështu, Skënderbeu u bë simbol i përsosur kombëtar për nacionalistët shqiptarët, të cilët kërkonin nga bashkëkombësit e tyre që të shikonin përtej së kaluarës së tyre osmane, ndërsa përpjekja e tyre për të bindur Evropën se Skënderbeu ishte “Kampioni i Krishterimit”, është dëshmi e afinitetit kulturor të Shqipërisë ndaj Evropës. Për të shfaqur orientimin strategjik të shqiptarëve drejt Evropës dhe qytetërimit perëndimor, Naim Frashëri madje shkoi një hap më tutje duke deklaruar se për shqiptarët “dielli lind në Perëndim.”⁸

Përveç vonesës së tij, nacionalizmi shqiptar kishte një tjetër tipar të veçantë në krahasim me popujt e tjerë të Ballkanit - në origjinën dhe karakterin e tij ai ishte sekular. Ka pasur disa faktorë të rëndësishëm dhe të ndërthurur në mes vete, të cilët kanë

⁵ Pirro Misha, “Invention of Nationalism: Myth and Amnesia”, in Schwandner-Sievers & Bernd J. Fischer eds. *Albanian Identities: Myth and History*, Indiana University Press, 2002, f. 33.

⁶ Skendi, Stavro, *The Albanian National Awakening*, Princeton: Princeton University Press, 1967, f. 4.

⁷ Ky libër fillimisht është publikuar në vitin 1980 në Bukuresht, dhe përfaqëson programin më të artikuluar të Rilindjes Shqiptare dhe ka pasur një ndikim shumë të madh në mesin e intelektualëve shqiptarë. Shiko Sami Frashëri, *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është, e çdo të bëhet?*, Prishtinë: Dijs, 1999, f. 32.

⁸ Rrapaj dhe Kolasi, 2013, f. 212.

formësuar nacionalizmin shqiptar, dhe që kanë kontribuar si vonesën, ashtu edhe në sekularizmin e tij. Së pari, në rastin e shqiptarëve, feja ka qenë më tepër një faktor përçarës se sa unifikues. Në fakt, mos-ekzistenca e një feje të përbashkët ka qenë element i rëndësishëm që ka pasur një ndikim të madh në vonesën dhe sekularizmin e nacionalizmit shqiptar. Teksa për nacionalizmat e tjerë të Ballkanit, feja si një faktor i unifikimit të popujve, ka luajtur një rol pozitiv në zhvillimin e nacionalizmit në lëvizjet kombëtare të vendeve të Ballkanit, në rastin e Shqipërisë feja padyshim ka luajtur më tepër një rol përçarës.⁹ Shqiptarët në përgjithësi kanë qenë të ndarë në tri religjione: Islamin, Krishterimin Ortodoks dhe Krishterimin Romano-Katolik. Myslimanët, të cilët përbënin rreth 70 për qind të popullatës ishin të ndarë në Myslimanë Suni (të cilët përbëjnë shumicën) dhe Myslimanë Bektashi, një sekt liberal Shiit, i cili në mënyrë heterodokse dhe sinkretike ka ushqyer pionierët e parë të lëvizjes kombëtare në mesin e myslimanëve shqiptarë.¹⁰ Për më tepër, zonat e banuara me shqiptarë përbënin një tablo komplekse religjioze. Katolikët përqëndroheshin rreth qytetit të Shkodrës, të krishterët ortodoksë gjendeshin kryesisht në pjesën jugore të lumit Shkumbin, përreth qyteteve të Korçës dhe Gjirokastrës, ndërsa myslimanët jetonin kudo në vend, porse shumica ishin të përqendruar në rajonin e Kosovës. Vetëm shqipfolësit myslimanë ishin aleatë dhe të barabartë me osmanët. Ata punësoheshin dhe paguheshin mirë, shumë prej tyre kishin arritur të ngriheshin në pozita të larta administrative dhe gjithashtu ata ishin të mbrojtur nga cenimet sllave dhe greke.¹¹

Pasi që të dyja, Perandoria Osmane dhe fqinjët e saj insistonin që Shqipëria të ndahej në bazë të linjave fetare, për rilindësit shqiptarë ishte vendimtare t'i tejkalonin ndasitë fetare, duke këmbëngulur për një identitet sekular të shqiptarëve të bazuar në "unitetin kulturor dhe gjuhësor" se sa në diversitetin fetar.¹² Prandaj, sekularizmi u bë tipari kryesor i Rilindjes Kombëtare shqiptare. Zgjidhja për "Çështja e fesë" mori përgjigjen e saj duke u bazuar në sloganin "Feja e shqiptarit është shqiptaria" e marrur nga poezia e të famshmit Pashko Vasa, "Oh moj Shqipëri e mjera Shqipëri". Në këtë poezi, Pashko Vasa, një i krishter romano-katolik nga qyteti i Shkodrës, i cili në Perandorinë Osmane kishte mbajtur disa pozita të larta administrative, u bënë thirrje shqiptarëve që "të mos shikojnë kisha e xhamia" sepse "feja e shqiptarit është shqiptaria!"¹³ Është e qartë se idetë që ndërthuren në këtë poezi janë radikale, në thirrjen për unifikim sekular dhe etno-linguistik të shqiptarëve, si dhe në porositë e saj kundër të huajve dhe kundër klerikëve. Vasa akuzoi që të dy establishmentet religjioze shqiptare, si ato të krishter

⁹ Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit Shqiptar: lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*, Tiranë, Botime Përpjekja, 2012, f. 138.

¹⁰ G. W. Gawrych, *The Crescent and the Eagle: Ottoman Rule, Islam and the Albanians, 1874-1913*, London dhe New York, 2006, f. 21.

¹¹ Misha, f. 41.

¹² Ibid., f. 210.

¹³ Pashko Vasa, "Oh moj Shqipëri e mjera Shqipëri," në letërsinë shqipe: *Një Histroi e Skurtër* ed. Robert Elsie, London: I.B. Tauris, 2005, pf. 84-88.

ashtu edhe ate mysliman, për bashkëpunim dhe shfrytëzim të religjionit për ndarje të shqiptarëve. Për më tepër, Pashko Vasa u bëri thirrje shqiptarëve që të refuzojnë religjionin, si burim të identitetit të tyre dhe të përvetësojnë laicizmin, religjionin civil pseudo-Rusonian, të bazuar në identitetin etno-linguistik dhe kombëtar.¹⁴

Karakteri sekular i nacionalizmit shqiptar mund të mbështetet edhe me faktin se rilindësit shqiptarë myslimanë dhe të krishterë kanë punuar së bashku për “çështjen shqiptare” pavarësisht nga prapavija e tyre fetare. Në anën tjetër, edhe pse Hastings argumenton se Judo-krishterimi ka qenë “ndërtuesi” i nacionalizmit në shekullin e XIX, dhe Islami si “frenues” i tij, për shqiptarët kjo ishte ndryshe.¹⁵ Shumica e rilindësve shqiptarë kanë qenë myslimanë, të cilët edhe për kundër faktit se kanë mbajtur poste të larta administrative në Perandorinë Osmane, i kishin bashkuar forcat për një Shqipëri të pavarur.¹⁶ Për më tepër, njëjtë sikurse edhe bashkëkombësit e tyre të krishterë, edhe rilindësit myslimanë, gjithashtu i kundërshtuan ndarjet fetare, dhe në vend të tyre bënë thirrje për shqiptarinë. Për shembull, në poemën e tij “Fe ç’është, komb ç’është”, Skendo Frashëri, djali i Abdyl Frashërit, u bëri thirrje shqiptarëve të krishterë dhe myslimanë që të hapnin sytë, pasi ata janë vëllezër dhe se kanë qenë gjithnjë shqiptarë.¹⁷

Në anën tjetër, natyra e civilizimit dhe trashëgimisë shqiptare ka qenë një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ka penguar zhvillimin e vetëdijes kombëtare shqiptare. Dallimet dhe nivelet e ndryshme të zhvillimit brenda komunitetit shqiptar kanë inkurajuar krijimin e klaneve dhe lokalizmave, duke e bërë në këtë mënyrë natyrën e shoqërisë shqiptare një pengesë serioze për arritjen e unitetit. Përveç dallimeve të tyre fetare, shqiptarët kishin edhe ndasi gjuhësore, kulturore, sociale dhe ekonomike.¹⁸ Në aspektin gjuhësor, shqiptarët ishin të ndarë në mes të dialektit verior gegë dhe dialektit toskë të përdorur nga jugorët, edhe pse gjuha e tyre e përbashkët amëtare ishte unike në mesin e të gjitha gjuhëve të tjera të Ballkanit. Komunikimi në mes të Veriut dhe Jugut ishte shumë i vogël, ndërsa dallimet e theksueshme të dialekteve kanë qenë pengesë që gjuha e

¹⁴ Licursi, Emiddio Pietro, “Empire of Nations: The Consolidation of Albanian and Turkish National Identities in the Late Ottoman Empire, 1878 – 1913,” Bachelor Thesis, Columbia University, 2011, f. 58.

¹⁵ Hastings, Adrian, *The Construction of Nationhood: Ethnicity, Religion and Nationalism*, Cambridge University Press, 1997, f. 165.

¹⁶ Abdyl Frashëri – anëtar i parlamentit të dytë osman nga Janina; Ismajl Qemajli - anëtar i parlamentit të restauruar osman në vitin 1908, kryetar i kuvendit të deputetëve osmanë dhe guvernator i Bejrutit; Hasan Prishtina – ishte tre herë anëtarë i parلمانetit osman nga Vilajeti i Kosovës.

¹⁷ Emri i vërtetë i Skendo Frashërit ishte në të vërtetë Mit’hat Frasherit, dhe ai ishte biri i rilindësit të parë shqiptar Abdyl Frasherit. Shiko Skendo Frasherit, “Fe Ç’është, Komp Ç’është,” *Journal Albania*, Brussels, 25 qershor 1897.

¹⁸ Bernd J. Fischer, “A Brief Historical Overview of the Development of Albanian Nationalism,” e prezantuar në diskutime pranë Qendrës për Studime të Evropës Lindore më 23 Mars 2005, Washington D.C., f. 2; http://opus.ipfw.edu/history_facpres/1 (14.04.2016).

përbashkët të jetë element unifikimi i vetë-identitetit etnik shqiptar. Mungesa e një alfabeti standard letrar ka penguar mëtutje identitetin gjuhësor etno-nacional, dhe deri në vitin 1908, shkrimet e pakta në gjuhën shqipe kanë përdorur transkriptimet e modifikuara të gjuhës së folur me bazë latine ose arabe.¹⁹ Për më tepër, ashtu sikurse vë në pah Fischer “kjo përçarje e unitetit është nxitur nga bashkë-ekzistenca e tri fazave kontradiktore të civilizimit: klaneve të ashpra dhe të pavarura malore në Veri, të bejlerëve feudalë në Jug (të cilët sunduan fshatarët e urtë toskë myslimanë) si dhe popullsia më e arsimuar dhe urbanizuar të periferive helene dhe katolike.”²⁰

Situata u komplikua edhe më tepër për shkak të faktit se ndryshe nga “kombet” e tjera të Ballkanit, shqiptarët nuk kanë pasur shtet të tyre para vitit 1912, as me të drejtën e tyre dhe as me ndonjë emër tjetër.²¹ Si pasojë, shqiptarët nuk mundeshin ta kthejnë kokën prapa dhe të shikojnë një perandori të fuqishme mesjetare, siç ishin Perandoria e Carëve të Bullgarisë apo Serbia e Stefan Dushanit.²² Për më tepër, Mbretëria e Serbisë e Stefan Dushanit, e cila kolapsoi në vitin 1355 ka përfshirë gjatë një kohe edhe territorin e Kosovës dhe është zgjeruar në jug në pjesët e tjera të trojeve shqiptare. Posedimi i territoreve të banuara me shqiptarë nga ana e një shteti mesjetar serb, më vonë do të bëhet themeli i pretendimeve nacionaliste serbe mbi territoret e banuara me shqiptarë në shekullin e XIX. Për këtë arsye, Lëvizja Kombëtare shqiptare në fund të shekullit të XIX u desh patjetër të bazohej në përkatësinë etnike, duke u dalluar kështu nga përvojat e popujve fqinjë të Ballkanit. Në vend se të theksohej një e kaluar e lavdishme kombëtare dhe një religjion i përbashkët, si dy elemente kryesore të identitetit të tyre etnik, shqiptarët zgjodhën një bazë tjetër, atë të sekularizmit të identitetit të tyre etnik apo kombëtar.²³

Rrjedhimisht, përpos dallimeve fetare, rilindësve shqiptarë u është dashur që të përballen edhe me mungesën e një shteti të fuqishëm nga e kaluara, si dhe dallimet gjuhësore, kulturore, sociale dhe ekonomike në mesin e shqiptarëve. Për të tejkaluar këto dallime dhe për të krijuar një ndjesi të unitetit, nacionalistët shqiptarë, ngjashëm me “Risorgimenton” italiane,²⁴ filluan të shkruanin dhe të shpërndanin shkrime të

¹⁹ Hupchick, f. 303.

²⁰ Fischer, 2005, f.2.

²¹ Noel Malcolm, “Myth of Albanian National Identity: Some Key Elements,” in Schwandner-Sievers & Bernd J. Fischer eds. *Albanian Identities: Myth and History*, Indiana University Press, 2002, f. 73.

²² Csaba-Barnabas Horvath, “The Onset of Albanian Nationhood,” *International Relations Quarterly*, Vol. 3, Nr. 2, Verë 2012, f. 1.

²³ Guy, Nicola C., “Ethnic nationalism, the Great powers and the question of Albanian independence, 1912-1921,” PhD thesis, Durham University. Department of History, 2008, f. 28.

²⁴ Lëvizja Risorgimento Italiane ishte një lëvizje ideologjike dhe letrare e cila ndihmoi lindjen e vetëdijes kombëtare të popullit italian, dhe si e tillë krijoi rrugën për disa ngjarje politike të cilat ndikuan në çlirimin e shtetit të Italisë nga dominimi i huaj dhe në unifikimin politik. Kjo lëvizje pretendonte se italianët ishin pasardhës etnik, kulturor dhe gjuhësor të Romakëve antik të cilët kishin jetuar në Gadishullin Italian për shekuj të tërë.

ndryshme për të kaluarën e lavdishme të shqiptarëve. Për më tepër, rilindësit shqiptarë formuan klube kulturore, organizata politike dhe publikonin gazetat e tyre. Shkrime të ndryshme të publikuara gjatë kësaj periudhe pretendonin vazhdimësinë direkte etno-lingvistike me pellazgët dhe ilirët antikë, e cila i shërbeu projektimit të kulturës shqiptare në një të kaluar të lavdishme. Figura e Skënderbeut është përdorur edhe për të nxitur ndjenjën e krenarisë për historinë e përbashkët. Edhe pse ishin kryesisht të shqetësuar me çështjet politike, rilindësit shqiptarë nisën zhvillimin etno-kulturor të shqiptarëve, pasi ishte e qartë se për arritur sukses në realizimin e programit kombëtar, ishte i nevojshëm një identitet konkret etnik. Përfundimisht, dhe për herë të parë, gegët në veri dhe toskët në jug arritën të bashkohen nën një partneritet konkret të punës.²⁵

Megjithatë, pamundësia për përdorimin e një religjioni të përbashkët si një shënues parësor etnik për identitetin e tyre, rilindësit shqiptarë e bënë gjuhën shqipe si tiparin përcaktues të identitetit dhe të lëvizjes kombëtare. Të ndodhur në një realitet të tillë, gjuha e shkruar shqipe u bë pararendës i domosdoshëm për zhvillimin kulturor dhe politik. Duke përfituar nga rritja e interesimit të filologëve nga Evropa Perëndimore për gjuhën shqipe, intelektualët shqiptarë e shpallën atë si gjuhë antike të familjes së gjuhëve Indo-Evropiane (Iliriane), dhe filluan të krijojnë gramatikën, fjalorët dhe përmbledhjet e folklorit. Më vonë, në vitin 1879, intelektualët shqiptarë të drejtuar nga familja Frashëri themeluan “Shoqërinë për Zhvillimin e Gjuhës Shqipe.”²⁶ Përparimi më i madh në këtë drejtim është arritur në Kongresin e Manastirit në vitin 1908, kur është vendosur për unifikimin e alfabetit të gjuhës shqipe. Pavarësisht debatit të ashpër mes bektashinjve, katolikëve dhe disa shqiptarëve ortodoksë, të cilët insistonin në alfabetin latin, dhe myslimanët suni dhe disa shqiptarë ortodoksë, të cilët mbronin një dorëshkrim arab apo ortodoks, vendimi ishte marrë për të përdorur një alfabet të standardizuar të gjuhës shqipe me bazë latine për gjuhën e shkruar dhe arsimim.²⁷ Kongresi vetë ishte një shpalosje e sekularizmit të nacionalistëve shqiptarë, pasi që delegatët shqiptarë me prejardhje nga të gjitha religjionet u bashkuan për të vendosur për një çështje kaq të rëndësishme.

Duhet të përmendet se përgjatë tërë ekzistencës së saj, Perandoria Osmane me paramendim ka themeluar struktura dhe politika administrative me qëllim që të pengonte zhvillimin e vetëdijes kombëtare në mesin qytetarëve të saj. Teksa disa prej këtyre politikave janë aplikuar në përgjithësi për popujt e Ballkanit, të tjerat janë aplikuar në mënyrë specifike ndaj shqiptarëve. Në mënyrë që të kuptohet se si këto masa kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në vonesën dhe sekularizmin e nacionalizmit shqiptar, është e rëndësishme që të analizohet struktura dhe funksionalizimi i mileteve,

²⁵ Hupchick, f. 305.

²⁶ Ibid., f. 306.

²⁷ Rrapaj dhe Kolasi, 2013, f. 205.

vilajeteve si dhe të politikave shkollore në Perandorinë Osmane. Në vitin 1453, pas pushtimit të Kostandinopojës, Sulltan Mehmeti II mori një vendim të rëndësishëm në lidhje me organizimin e perandorisë së tij të zgjeruar. Ai i krijoi sistemin e mileteve²⁸ me qëllim që të mbikëqyreshin dhe administroheshin qytetarët e perandorisë. Ky vendim ishte i domosdoshëm për krijimin e një strukture institucionale për integrimin administrativ të jo-myslimanëve të Ballkanit, gjithnjë e më shumë në rritje branda shtetit osman. Sistemi i “miletve” organizonte Perandorinë Osmane në bazë të përkatësisë fetare dhe jo në bazë të territorit, statusit ekonomik apo prejardhjes etnike. Një strukturë e tillë është aplikuar për katër shekuj e gjysmë me radhë e deri në kohën e Revolucionit të Turqve të Rinj në vitin 1908, i cili i dha formë jo vetëm mënyrës se si sunduesit osmanë i shikonin subjektet e tyre, por edhe mënyrës se si këto subjekte e shihnin veten dhe fqinjët e tyre.²⁹

Të gjithë subjektet ishin ndarë në tre *millete* kryesore, të cilët përfaqësonin besimet më të rëndësishme ekzistuese jo-myslimane: (1) të krishterët ortodoksë, të cilët përfaqësonin grupin e vetëm më të madh jo-mysliman dhe ekonomikisht më të rëndësishëm, të cilët udhëhiqeshin nga patriarku i Kostandinopojës; (2) Çifutët që kishin rëndësi të madhe tregtare dhe kulturore, të cilët kryesoheshin nga një përfaqësues i zgjedhur i Këshillit Rabinik në Stamboll; dhe (3) të krishterët armenë, të cilët kryesoheshin nga patriarku armen i Stambollit, i emëruar nga Sulltani, i cili përfaqësonte gjithashtu edhe subjektet romano-katolikë të Perandorisë.³⁰ Natyrisht, myslihanët përbënin *de facto* *miletin* e katërt, duke i bërë në të njëjtën kohë myslihanët e vendeve të Ballkanit anëtarë të "kombit politik" osman-turk, pavarësisht gjuhës së tyre amtare.³¹ Teksa për grekët, serbët dhe bullgarët ky sistem siguroi një formë të një lloji të ndërgjegjes kombëtare para-moderne dhe politike, për shqiptarët sistem ishte një sistem ndarës. Për më tepër, ky sistem përfaqësonte një element nga i cili e kanë origjinën të metat kryesore të shqiptarëve.

Brenda një sistemi të tillë, grupi më i madh i shqiptarëve – myslihanët – ishin konsideruar si turq. Në anën tjetër, shqiptarët ortodoksë nuk patën kishën e tyre kombëtare, siç e kishin grekët, bullgarët apo serbët, dhe si të tillë i takuan kishës greke,

²⁸ Në gjuhën e sotme turke fjala “milet” do të thotë “komb”, megjithatë në shekullin e XV dhe përgjatë kohës së Perandorisë Osmane përdorimi i këtij termi nuk ishte fokusuar në komb porse në religjion, dhe në realitet kuptimi i kësaj fjale ka qenë “komb fetar”.

²⁹ Payton, James R. Jr., "Ottoman Millet, Religious Nationalism, and Civil Society: Focus on Kosovo," dokumente të zakonshme mbi religjionin në Evropën lindore: Vol. 26: çështja 1, artikulli 2, 2006, f. 12.

³⁰ Duhet të përmendet se kur sistemi i miletit u institucionalizua, katolikët nuk pranuan të regjistroheshin në këtë kornizë zyrtare. Për shkak të aleancës franceze me turqit kundër Habsburgëve, katolikët e botës osmane morën si shpërblim një mbrojtës të Portës në personin e ambasadorit francez. Në këtë mënyrë, në fillim të reformave të Tanzimatit mileti Katoliko Romak u krijua edhe nga Perandoria Osmane. Shiko Roumen Daskalov dhe Alexander Vezhenkov eds. *Entangled Histories of the Balkans - Volume Three: Shared Pasts, Disputed Legacies*, Brill, 2015, f. 386.

³¹ Hupchick, f.133.

pasi që jetonin kryesisht në zonat jugore afër Greqisë. Prandaj, një sistem i tillë i milletit, i cili i konsideronte shqiptarët myslimanë si “turq” dhe ortodoksët si “grekë”, rezultoi në krijimin e dy grupeve të mëdha shqiptare, që kishin më shumë të përbashkëta me turqit dhe grekët se sa me njëri-tjetrin. Grupi më vogël shqiptar, katolikët, formalisht nuk i takonin asnjërës prej kishave kombëtare të vendeve fqinje, porse në mënyrë formale përfaqësoheshin nga patriarku armen. Në mënyrë paradoksale, edhe pse shqiptarët katolikë ishin më “perëndimorët”, pa përfaqësim të duhur deri në fillimin e Reformave të Tanzimatit, ata mbetën pjesa e popullsisë më pak të zhvilluar në aspektin ekonomik dhe më të voglit në numër.³²

Identifikimi i milletit eliminoi të gjitha konsiderata etnike, dhe si i tillë nuk kishte asnjë konotacion të ndërlidhur me konceptin territorial të Evropës Perëndimore për kombet. Përkatësia e milletit qeveriste jetën e individëve, pa marrë parasysh se ku dikush jetonte brenda perandorisë apo pavarësisht se sa e përzier ishte popullsia. Ata ishin të gjithë anëtarë të komuniteteve të tyre me vetë-administrim pa ndonjë pretendim për komunitetet e tjera. Rrjedhimisht, për të gjithë qytetarët osman, vendlindja e tyre shtrihej kudo brenda kufijve të perandorisë, duke rritur kështu popullata e përziera etnike në tërë Ballkanit.³³ Pasi që në sistemin e milletit komunitetet etnike nuk kishin kufij gjeografikë, çdo komunitet kulturor, i konsideronte si të vetat të gjitha territoret bashkësia fetare e të cilit përbënte shumicën. Si rezultat, pasi Perandoria Osmane filloi të shpërbëhej, nacionalistët grekë filluan t'i shikojnë territoret e Shqipërisë së Jugut si të tyre, ndërsa serbët i pretendonin pjesët veriore të territoreve të banuara me shqiptarë. Për këtë arsye, një sistem i tillë që nga fillimi ka bartur në vetvete mundësinë e luftërave të përgjakshme.

Është e qartë, se gjerësisht sistemi i mileteve ka ofruar një tokë frytshme për grekët, serbët dhe bullgarët, për krijimin e shteteve të tyre kombëtare me mbështetjen e drejtpërdrejtë të kishave përkatëse, për nacionalizimin shqiptar ai ka paraqitur një pengesë serioze. Vetëm shkëputja radikale nga sistemi i *milletit* bëri të mundur ndryshimin e paradigmes, e cila i mundësoi dy komuniteteve më të mëdha shqiptare të shiheshin si një komunitet, i ndarë nga grekët dhe turqit, dhe jo si grek apo turk me tipare tjera gjuhësore.³⁴ Nga ana tjetër, edhe pse nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, ë Evropën Lindore, feja filloi të venitej në raport me konceptit gjerman për kombet, i cili bazohej në themelet gjuhësore, feja në Ballkan mbeti shumë më gjatë një shënues i rëndësishëm i identitetit, se sa në vende të tjera. Vetëm me shpërbërjen e

³² Horvath, 2012, f. 2.

³³ Hupchick, f.134.

³⁴ Horvath, 2012, f. 2.

sistemit të mileteve, shqiptarët ishin në gjendje të dilnin dhe të shpalosnin një etni apo nacionalitet të veçantë duke u bazuar në modelin gjerman.³⁵

Në anën tjetër, *vilajetet*, si regjione administrative kontribuan edhe më tej në izolimin e brendshëm dhe ndarjen e shqiptarëve, të cilët jetonin në Perandorinë Osmane. Nëse sistemi i *miletit* i kishte ndarë shqiptarët në bazë të religjionit, vilajetet këtë ndarje e kishin bërë në baza territoriale. Pasi që osmanët i ndanin subjektet e tyre në njësi administrative pa marrë parasysh nacionalitetet e tyre, territoret shqiptare përfunduan të ndara në katër vilajete të ndryshme: Kosovë, Shkodër, Manastir dhe Janinë. Nuk është për t'u habitur se pse një nga kërkesat kryesore nga ana e elitave nacionaliste shqiptare në fazat e hershme ishte krijimi i një njësie të vetme administrative e cila do të përfshinte të gjitha territoret shqiptare. Megjithatë, pavarësisht disa ndarjeve rajonale të trojeve shqiptare gjatë sundimit osman, një rajon i tillë i vetëm administrativ nuk u krijua asnjëherë. Mungesa e një qendre të vetme administrative, fetare dhe kulturore ka ndikuar negativisht në formimin e vetëdijes së përbashkët kombëtare në mesin e popullit shqiptar.³⁶ Për më tepër duke qenë të vetëdijshëm se gjuha, arsimimi dhe kultura janë elemente kritike në zhvillimin e nacionalizimit shqiptar, osmanët kishin vënë kufizime të caktuara për mësimin e gjuhës shqipe. Prandaj, shqiptarët myslimanë ndiqnin shkollat islamike, katolikët ndiqnin shkollat italiane, ndërsa ortodoksët mund të ndiqnin shkollat greke.³⁷ Si rrjedhojë një gjë e tillë pengoi procesin e krijimit të gjuhës së përbashkët të shkruar, e cila përfundimisht do të mund të çonte drejt letërsisë së përbashkët, dhe zbulimin pasues të një të kaluarë të përbashkët dhe rritjen e nacionalizimit modern shqiptar.³⁸

Faktori i fundit i cili ka formësuar nacionalizimin shqiptar ndërlidhet me faktin se shqiptarët nuk kishin ndonjë patron apo mbrojtës të fuqishëm. Siç ka treguar përvoja nga Kongresi i Berlinit, lëvizja kombëtare shqiptare ka vuajtur nga pengesa serioze që ishte shkaktuar nga mungesa e një patroni apo mbrojtësi, të cilin shqiptarët nuk e kishin ashtu sikurse ishte rasti me popujt e tjerë të Ballkanit.³⁹ Me fjalë të tjera, një vit para se të mbahej Kongresi i Berlinit në vitin 1877, intelektuali i mirënjohur shqiptar Abdyl Frashëri së bashku me një grup e udhëheqësve shqiptarë në Stamboll, kërkoi nga Fuqitë e Mëdha që territoret e banuara me shqiptarë të mos fragmentoheshin brenda perandorisë. Ata kërkuan nga Porta e Lartë që të krijonte një krahinë Osmane ku do të

³⁵ Duijzings, Ger, *Religion and Politics in the Identity of Kosovo*, London: Hurst & Company, 2000, pf. 7-8.

³⁶ Jonilda Rrapaj dhe Klevis Kolasi, "The Curious Case of Albanian Nationalism: the Crooked Line from a Scattered Array of Clans to a Nation-State," *The Turkish Yearbook of International Relations*, Volume 43, 2013, f. 199.

³⁷ Barbara Jelavich, *History of the Balkans: Twentieth Century*, Cambridge, Cambridge University Press, 1999, f.85.

³⁸ Fischer, 2005, f.1.

³⁹ Fischer, 2005, f.2.

përfshiheshin të gjitha territoret e banuara me shqiptarë.⁴⁰ Megjithatë, Kongresi i Berlinit nuk mori parasysh ankesat e shqiptarëve, mohoi ekzistencën kombit shqiptar prapa një shprehje gjeografike, duke i dhënë dritën e gjelbër krijimit të shteteve të pavarura të Malit të Zi dhe Serbisë. Që atëherë, për nacionalistët shqiptarë u bë çështje esenciale tërheqja e vëmendjes së Fuqive të Mëdha dhe sigurimi i një mbrojtësi prej Fuqive të Mëdha, përmes demonstrimit të një identiteti të veçantë shqiptar dhe karakterit evropian të kombit shqiptar.⁴¹

Në të vërtetë, një realitet i tillë i ka përballur nacionalistët shqiptarë me një dilemë mjaft të ndjeshme. Në njërin anë, ata kishin nevojë të tërhiqnin vëmendjen e Fuqive të Mëdha duke demonstruar identitetin e dallueshëm shqiptar dhe karakterin e evropian të kombit shqiptar. Ndërsa në anën tjetër, për sa kohë që Perandoria Osmane mbeti një fuqi e qëndrueshme, ata mendonin se interesat shqiptare do të mund të mbroheshin, të paktën përkohësisht dhe në mënyrë adekuate, nëse mund të sigurohej një shtet me autonomi të kënaqshme brenda perandorisë.⁴² Për këtë arsye rreth tetëdhjetë delegatë, shumica e të cilëve ishin udhëheqës fetar myslimanë, drejtues të klaneve dhe njerëz të tjerë me ndikim nga katër vilajetet osmane të banuara me shqiptarë, të cilët në vitin 1878 formuan Lidhjen e Prizrenit, fillimisht punuan vetëm për të fituar autonomi e shqiptarëve, por jo për të krijuar një Shqipëri të pavarur.⁴³ Me anë të kësaj logjike, Lidhja e Prizrenit në fillim nuk u kundërshtua nga Stambolli, pasi që autoritetet osmane dhe ata të Lidhjes së Prizrenit gjetën një qëllim të përbashkët në rezistimin e presioneve për pretendime territoriale që vinin nga shtetet e sapo formuara në Ballkan pas Kongresit të Berlinit. Megjithatë, kur kjo qëndrueshmëri u komprometua, për nacionalistët shqiptarë u bë e domosdoshme që të siguronin një mbrojtës në mesin e fuqive të mëdha. Në të njëjtën kohë, ata vazhdimisht bënë thirrje për një shtet të pavarur shqiptar, i cili do të përbëhej nga të gjitha viset shqiptare, të cilat më parë ishin nën sundimin osman. Në ndërkohë, duke qenë se interesimi për çështjen shqiptare ishte rritur, në veçanti nga Italia dhe Austro-Hungaria, kishte shtyrë shqiptarët të besonin se këto dy fuqi do të ishin të gatshme që të pengonin zgjerimin e Greqisë dhe Serbisë në territoret e banuara me shqiptarë. Përpjekjet e Italisë dhe të Austro-Hungarisë në eksportin detar, tregti dhe arsim, i dhanë mundësi shqiptarëve që të ekspozoheshin me idetë dhe kulturën perëndimore, si dhe të krijojnë lidhje të rëndësishme në mes tyre dhe këtyre fuqive evropiane.⁴⁴ Përfundimisht, Austro-Hungaria luajti një rol kyç si në pavarësinë e vet-deklaruar të shtetit shqiptar në nëntor

⁴⁰ Perry, f. 266.

⁴¹ Rrapaj dhe Kolasi, 2013, f. 211.

⁴² Guy, 2008, f. 43.

⁴³ Për më gjerë në lidhje me rilindjen kombëtare shqiptare shiko Skendi, Stavro, *Rilindja Kombëtare Shqiptare 1888-1912*. Princeton: Princeton University Press, 1967, pf. 88-108.

⁴⁴ Fischer, 2005, f.3.

të vitit 1912, ashtu edhe në njohjen e saj ndërkombëtare në dhjetor të vitit 1913 në Konferencën e Ambasadorëve në Londër.

Pikërisht, pas suksesit mahnitës të shteteve të Ballkanit në fillim të Luftës së Parë Ballkanike, Fuqitë e Mëdha e pranuan që *status quo-ja* e tillë nuk mund të ishte më e pranueshme. Austro-Hungaria ishte e vetëdijshme se ishte i nevojshëm një veprim i shpejtë, në qoftë se nocioni i një Shqipërie të pavarur nuk do të ishte plotësisht i pranueshëm para fitimeve territoriale të aleatëve fitimtarë Ballkanik. Prandaj me mbështetjen diplomatike të Vienës, tetëdhjetetë delegatët nga e tërë Shqipëria u mbledhën në Kongresin e Vlorës më 28 nëntor 1912 dhe shpallën shtetin e pavarur të Shqipërisë.⁴⁵ Vetë deklarimi i pavarësisë ishte një provë tjetër e karakterit sekular të nacionalizmit shqiptar, pasi që delegatët pjesëmarrës ishin përfaqësues shqiptar, si të religjionit islam ashtu edhe atij të krishterë. Austro-Hungaria edhe një herë shfaqti interesin më të lartë për çështjen shqiptare, në rradhë të parë duke luajtur një rol shumë të madh në organizimin e Konferencës së Ambasadorëve në Londër në dhjetor të vitit 1912. Viena tradicionalisht ka qenë mbrojtëse e popullatës katolike pakicë në Ballkan, posaçërisht në veri të Shqipërisë. Rrjedhimisht, mund të pretendohet se ajo vërtetë ka punuar në interes të kombësisë dhe përkatësisë etnike, gjë që Kongresi i Berlinit do t'i merrte për bazë për marrëveshjet e ardhshme.

Sido që të jetë, ia vlen të përmendet se argumentet nacionale dhe ato morale janë përdorur nga Austro Hungaria vetëm në rastet kur ato i përshtateshin interesave të saj ekonomike dhe strategjike. Ekonomikisht, Austria ishte eksportuesi dhe importuesi më i madh në dhe prej Ballkanit Perëndimor. Në aspektin strategjik, edhe pse ishte më tepër e interesuar në rajonin bregdetar të veriut (Scutari), se sa në brendinë territoriale të Kosovës apo të zonave jugore, të cilat përbënin konflikt ndaj ambicieve greke, në fund, Viena përkrahu vetëm një shtet të vogël të Shqipërisë.⁴⁶ Si rezultat i kësaj, Konferenca konfirmoi ekzistencën e shtetit shqiptar, pak a shumë brenda kufijve që ka sot, por në pjesë të caktuara linjat kufitare kishin nevojë të rregulloheshin më tutje.⁴⁷ Megjithatë, Aleatëve të Ballkanit që ishin kundër Turqisë Osmane, u ishin dhënë pjesë të mëdha të territorit, kryesisht të banuar me shqiptarë, përfshirë edhe territorin e Kosovës. Shumica e zonave të banuara me shqiptarë ju dhanë Serbisë dhe Malit të Zi, ndërsa Greqia mori rajonin e madh jugor, të njohur si Epiri i Veriut nga Greqia apo Çamëria nga Shqipëria.⁴⁸ Kështu shteti i sapo krijuar shqiptar përfshiu jo më shumë se pesëdhjetë për qind të territoreve të banuara nga popullsia shqiptare. Si rezultat i kësaj, u krijua pakica më e madhe në Evropë, me që më shumë shqiptarë jetonin jashtë shtetit shqiptar, se sa

⁴⁵ Gewehr, Wesley M., *The Rise of Nationalism in the Balkans, 1800-1930*. New York: H. Holt and Company, 1931, f. 91.

⁴⁶ Guy, 2008, f. 79.

⁴⁷ Judah, f. 38.

⁴⁸ Gallagher, Tom, *Outcast Europe: The Balkans, 1789-1989*. London: Routledge, 2001, f.64.

brenda kufijve të saj. Është ironike, se edhe përkundër faktit që shqiptarët e Kosovës i bënë shumicën e kryengritjeve çlirimtare, vetë Kosova mbeti nën sundimin e Serbisë dhe jashtë kufijve të shtetit të sapo krijuar të Shqipërisë. Si rezultat, kjo çoi në rritje të një nacionalizmi të ri shqiptar, në mesin e atyre shqiptarëve që mbetën jashtë kufijve të Shqipërisë, veçanërisht në Kosovë.

II. Identiteti etnik shqiptar dhe religjioni në Jugosllavi(të)

Gjatë periudhës kohore në mes të krijimit të shtetit shqiptar dhe Luftës së Parë Botërore, nacionalizmi i shqiptarëve të Kosovës u rrit me anë të revoltave të përgjithshme ndaj fuqisë ushtarake të Serbisë dhe më vonë edhe ndaj Bullgarisë (1915-1918). Qëllimi kryesor i saj ishte bashkimi i territoreve të zonave kulturore shqiptare të lëna jashtë kufijve shtetëror të Shqipërisë me ato të Shqipërisë. Nacionalistët shqiptarë u organizuan kryesisht rreth Komitetit për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës, i cili në një formë të shthurur kishte ekzistuar qysh prej majit të vitit 1915. Ky komitet ishte themeluar në Shkodër me qëllim primar për të bërë fushatë kundër vendimit për caktimin e kufijve të Konferencës së Ambasadorëve, me fjalë të tjera për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e të gjitha tokave të banuara me shqiptarë. Një objektivë tjetër ishte edhe organizimi i sulmeve kundër Serbisë dhe kontrabandimi i armëve për kryengritësit në kufi. Kjo kryengritje ishte drejtuar nga Hoxhë Kadriu nga Prishtina, ndërsa shumica e anëtarëve të tjerë ishin azilantë politikë nga Kosova, dhe dy më kryesorët ishin Hasan Prishtina dhe Bajram Curri.⁴⁹

Kur më 1 dhjetor 1918 u krijua Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve – e quajtur jo-formalisht si Jugosllavia – një numër shumë i madh i popullit shqiptar u integrua në shtetin e Serbisë dhe Malit të Zi për kundër vullnetit të tyre dhe nën kushte veçanërisht të dhunshme.⁵⁰ Me qëllim të ndryshimit të realitet etnik në Kosovë, Serbia u përfshi në fushatë terrori, duke bërë kolonizim në njërin anë, dhe dëbimin e dhunshëm të shqiptarëve në anën tjetër. Gjatë periudhës deri në vitin 1939, përafërsisht 40,000 qytetarë sllavë ortodoksë ishin shpërngulur në Kosovë, duke u dhënë tokë e zgjedhur dhe përfitime të tjera, ndërsa më tepër se gjysmë milion e shqiptarëve etnik ishin detyruar të emigronin nga ky rajon.⁵¹

⁴⁹ Vickers, Miranda, *Between Serb and Albanian: A History of Kosovo*, New York: Colombia University Press, 1998, f. 93.

⁵⁰ "Carnegie Endowment for International Peace" Raporti i Komisionit Ndërkombëtar për hetimin e shkaqeve dhe Sjelljen e Luftërave Ballkanike, Washington, D.C., 1914, <http://www.archive.org/details/reportofinternat00inteuoft> (18.04.2016).

⁵¹ Poulton, f. 91.

Pjesa më e madhe e periudhës midis dy luftërave botërore është karakterizuar me periudhat e rezistencës së armatosur shqiptare kundër autoriteteve serbe, dhe politikat shtypëse të qeverisë së Serbisë. Serbët besonin se ishte veçanërisht e padëshirueshme që shqiptarët të arsimoheshin në gjuhën shqipe, nga fika se lidhjet gjuhësore do të mund të ushqenin nacionalizmin shqiptar.⁵² Pikërisht, asimilimi gjuhësor ishte pjesë e tendencës për të serbizuar rajonin, një ideologji e cila ishte planifikuar bile edhe para Luftës së Parë Botërore. Rrjedhimisht, autoritet serbe mbyllën të gjitha shkollat shqipe, të cilat ishin hapur në kohën e Perandorisë Austro-Hungareze, gjatë okupimit të Kosovës në periudhën e Luftës së Parë Botërore. Në vend të tyre, institucionet e vetme arsimore që u lejuan nga regjimi serb ishin shkollat fetare, si ato islamike ashtu edhe ato katolike.⁵³ Është e qartë se autoritet serbe ishin më tepër të prirë për të theksuar prapavijën fetare se sa atë etnike të shqiptarëve të Kosovës. Për më tepër, në vitin 1937, Vaso Cubrilovic propozoi që shqiptarët të riklasifikoheshin si “turq” duke i shtrënguar që të emigronin, duke ua bërë jetën në Kosovë të padurueshme dhe të mjerë. Përfundimisht, u bënë edhe marrëveshje konkrete në mes të Serbisë dhe Turqisë për të inkurajuar zhvendosjen e dhjetëra mijëra shqiptarëve nga Kosova në Turqi – një politikë e cila vazhdoi edhe nga Jugosllavia socialiste gjatë viteve 1950ta dhe 1960ta.⁵⁴

Sido që të jetë, këto shkolla fetare gradualisht u kthyen në qendra të fshehta arsimimi, duke u shfrytëzuar si platforma për të gjeneruar dhe shpërndarë idetë nacionaliste shqiptare. Për shkak të ndalimit të vazhdueshëm të shkollave laike shqiptare në Jugosllavinë në mes dy luftërave botërore, kleri mysliman filloi të ndjek trendin e mëparshëm të prezantimit të gjuhës shqipe në shkollat fetare.⁵⁵ Ky mision i ri kombëtar i shkollave fetare i detyroi autoritet e arsimit të Serbisë që të zëvendësonin me forcë imamët shqiptarë me imamë nga Bosnja, të cilët nuk flisnin fare gjuhën shqipe. Është e dukshme që një politikë e tillë kishte për qëllim të parandalonte aktivitetet nacionaliste të shqiptarëve brenda institucioneve fetare. Megjithatë, shqiptarët e Kosovës edhe një herë i dhanë përparësi gjuhës së tyre nacionale kundrejt identifikimit të përbashkët fetar, dhe kështu mësuesit myslimanë të Bosnjës u përballën me një kundërshtim të ashpër dhe bojkot nga ana e bashkë-besimtarëve të tyre shqiptarë në Kosovë.⁵⁶

⁵² Perritt, Jr Henry, *The Road to Independence for Kosovo: A Chronicle of the Ahtisaari Plan*, Cambridge: Cambridge University Press, 2010, f. 18.

⁵³ Merdjanova, Ina, *Rediscovering the Umma: Muslims in the Balkans between Nationalism and Transnationalism*, Oxford University Press, 2013, f. 43.

⁵⁴ Sipas Noel Malcolm, nën presionin e autoriteteve jugosllave nga viti 1945 në vitin 1966 rreth njëqind mijë shqiptarë të Kosovës emigruan në Turqi në mënyrë që myslimanët të identifikoheshin si "turq", shiko Malcolm, Noel, *Kosova: Një Histori e Shkurtër*, New York: New York University Press, 1998, f. 322-323.

⁵⁵ Vokri, A., *Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy Luftërave Botërore (1918–1941)*, Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Kosovës, 1990, pf. 303–14.

⁵⁶ Pirraku, M., “Kulturno-prosvetni pokret Albanaca u Jugoslaviji (1919–1941),” *Jugoslovenski istorijski casopis* 1–4, 1978, p. 361.

Megjithatë, nacionalistët shqiptarë po ashtu arritën të ringjallnin shkollat e fshehta shqiptare që ishin tërësisht sekulare.⁵⁷ Rrjedhimisht, gjatë kësaj periudhe nacionalizmi shqiptar në Kosovë vazhdoi të jetë sekular në natyrën e tij. Edhe pse shqiptarët e Kosovës ishin kryesisht myslimanë, por që kishte edhe minoritete të rëndësishme të romano-katolikë dhe disa të krishterëve ortodoksë, islami historikisht ka luajtur vetëm një rol periferik në identitetin e shqiptarëve të Kosovës. Edhe pse shqiptarët e Kosovës kanë vazhduar të mbajnë muajin e Ramazanit dhe festat e tjera myslimane, shumica e tyre e kanë konsideruar veten e tyre para se gjithash shqiptarë, dhe vetëm rastësisht myslimanë.⁵⁸

Edhe pas Luftës së Dytë Botërore shqiptarët e Kosovës mbetën si pjesë e Jugosllavisë socialiste edhe përkundër premtimeve se do t'i bashkoheshin Shqipërisë nëse do të bashkoheshin me partizanët për të luftuar forcat okupatore. Rrjedhimisht në dhjetor të vitit 1944, Komiteti Nacional Çlirimtar Shqiptarë për Kosovën shpalli bashkimin e Kosovës me Shqipërinë.⁵⁹ Megjithatë, pas një kërkese të bërë në korrik nga ana e "Këshillit Rajonal Popullor" të pazgjedhur të Kosovës, i cili kishte 142 anëtarë dhe vetëm 33 prej tyre ishin shqiptarë, në shtator të vitit 1945 Kosova formalisht iu aneksua Serbisë si një "rajon autonom."⁶⁰ Për më tepër, shqiptarët e Kosovës në Jugosllavinë socialiste arritën të njihen vetëm si kombësi dhe jo si komb, pasi që "atdheu" kombëtar shqiptar ishte jashtë territorit të Jugosllavisë.⁶¹ Përveç kësaj, edhe pse në bazë të regjistrimit civil të kryer në vitin 1948 serbët dhe malazezët përbënin vetëm 27.5 për qind të popullsisë së Kosovës, të gjitha institucionet e Kosovës dhe në veçanti shërbimet e sigurisë dominoheshin nga serbët dhe malazezët.⁶² Një realitet i tillë krijoi një shteg për një nacionalizëm të ri shqiptar në Kosovë që strukturoi referencat e tij kolektive.

Edhe pse në Kosovë, shkollat shqipe u hapën menjëherë pas establishimit të regjimit komunist, vetëm pak vite më vonë pushteti i Jugosllavisë rrëzoi aspiratat e shqiptarëve për vetëvendosje duke mbyllur shumicën e shkollave shqipe dhe duke ndaluar simbolet dhe festat kombëtare shqiptare. Sërish shqiptarët u inkurajuan që të identifikoheshin si "turq", gjerësa hapeshin shkolla të reja turke. Në të njëjtën kohë, në vitin 1953 një traktat qeveritar u nënshkrua me Turqinë, me anë të së cilit lejoheshin turqit e

⁵⁷ Shiko, Banac, Ivo, *The National Question in Yugoslavia: Origins, History, Politics*, Ithaca, NY: Cornell University Press, 1984, pf. 377.

⁵⁸ Perrit, 2010, f. 19.

⁵⁹ Calic, Marie-Janine, "Kosovo in the twentieth century: A Historical Account," in Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur eds. *Kosovo and the Challenge of Humanitarian Intervention: Selective Indignation, Collective Action, and International Citizenship*, Tokyo: United Nations University Press, 2000, f. 19.

⁶⁰ Malcolm, f. 315.

⁶¹ Rusinow, Dennison, *The Yugoslav Experiment 1958-1974*. Berkeley and Los Angeles: University of California Press, 1977, f.188.

⁶² Judah, f. 51.

Jugosllavisë që të emigronin në këtë vend. Një gjë e tillë bëri që të shpërthejë një eksod masiv drejt Turqisë, me ç'rast shumë shqiptarë dhe sllavë myslimanë u detyruan të prezentoheshin si turq, në mënyrë që të ishin në gjendje të lëshonin vendin e tyre.⁶³ Si rrjedhojë nacionalizmi shqiptar në Kosovë dhe pjesë të tjera të Jugosllavisë u rrit si një reagim ndaj diskriminimit të madh etnik, për shkak të krijimit të shteteve kombëtare siç ishin Serbia, Maqedonia dhe Mali i Zi mbi premisat ekskluzive etno-linguistike. Politikat e tilla diskriminuese i ndihmuan edhe rritjes së vetëdijes për një identitet shqiptar dhe për promovimin e një solidariteti mbarë-shqiptarë në ish-Jugosllavi. Një identitet i tillë shqiptar u formua kryesisht me anë të një ideologjie nacionaliste sekulare, duke u bazuar në simbolet kombëtare dhe mitet ekskluzive, dhe jo në përkatësinë fetare. Historia e vonë e shqiptarëve të Kosovës e bënë të qartë se referencat fetare islame kanë munguar në diskursin dhe jetën politike të lëvizjes së tyre nacionaliste.⁶⁴

Shfaqjet më radikale të nacionalizmit shqiptar në Kosovë, siç janë demonstratat me anë të së cilave ishte kërkuar ngritja e statusit të Kosovës në një republikë në kuadër të federatës në vitin 1968 dhe 1981, ishin gjithashtu në rigorozisht sekulare. Intelektualë, studentë dhe qytetarë të zakonshëm shqiptarë u bashkuan në këto ngjarje me një agjendë shumë nacionaliste dhe plotësisht të pavarur nga përkatësia e tyre fetare. Për më tepër, që nga viti 1974, kur Kushtetuta e re i dha autonomi më të madhe Kosovës, shqiptarët u përqendruan vetëm në avancimin e të drejtave të tyre etnike, gjuhësore dhe arsimore, në vend të atyre fetare. Megjithatë, represioni i ashpër ndaj shqiptarëve pas demonstratave të vitit 1981 edhe më tej përkeqësoi marrëdhëniet serbo-shqiptare, duke kontribuar në një rritje të nacionalizmit shqiptar. Pastaj, politikat nacionaliste në Kosovën e Sllobodan Millosheviqit edhe një herë arritën të nxisin nacionalizmin mbrojtës shqiptar, këtë herë në mesin e shqiptarëve të Kosovës.

⁶³ Sipas burimeve jugosllave gjatë kësaj periudhe rreth 80,000 njerëz kishim emigruar, ndërsa në bazë të burimeve të Turqisë shifra arrinë në 150,000. Shih Merdjanova, 2013, f. 43.

⁶⁴ Iseni, Bashkim, "National Identity, Islam and Politics in the Balkan," Brückenschläge - "Bosnischer Islam" für Europa, Stuttgart-Hohenheim, 20-22.11.2009, f. 3.

III. Shqiptarët e Kosovës: Lidhja në mes të identitetit dhe përkatësisë fetare

III.1. Lufta për pavarësi dhe homogjenizmi shoqëror: 1989-1999n

Kur në vitin 1986 Slobodan Millosheviqi u bë Kryetar i Lidhjes Komuniste të Serbisë, nacionalizimi i Serbisë ishte tashmë duke u promovuar në mënyrë aktive nga intelektualët dhe politikanët e Serbisë përgjatë tërë vendit.⁶⁵ Pas zgjedhjes së tij, Millosheviqi u koncentrua në sigurimin e shumicës së votave të nevojshme në Presidencën rotative të Jugosllavisë, që ishte paraqitur pas vdekjes së Titos. Fillimisht, ai i inkurajoi dhe i mbështeti protestat masive në Vojvodinë dhe Mal të Zi, të cilat çuan drejt dorëheqjes së qeverive të tyre përkatëse. Regjimet kukulla të sapo krijuara në këto dy njësi federale ishin besnike ndaj Millosheviqit dhe kontrolloheshin plotësisht nga ai. Në vitin 1989 një kushtetutë e ndryshuar e Serbisë, e cila do të reduktonte ndjeshëm pushtetin e dy krahinave autonome iu dorëzua për miratim qeverive të Kosovës, Vojvodinës dhe Serbisë.⁶⁶ Këto ndryshime janë miratuar për herë të parë më 10 mars 1989 nga ana e Kuvendit të Vojvodinës, më pas nga Kuvendi i Kosovës më 23 mars dhe nga Kuvendi i Serbisë në 28 mars.⁶⁷ Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës e rrethuar nga policët dhe tankset, i detyroi deputetët që të votojnë në favor të ndryshimeve kushtetuese, ndryshime këto që do të rivendosnin pushtetin e Serbisë mbi krahinën.⁶⁸ Me anë të kësaj Serbia fitoi kontrollin e tre ulëseve të presidencës federale, që së bashku me kontrollin e plotë mbi regjimin kukull të Malit të Zi, do t'i jepte Millosheviqit katër nga tetë ulëset në luftën e tij për të ruajtur kontrollin mbi federatën.⁶⁹

Shqiptarët reagueshan ndaj shtypjes së autonomisë së Kosovës me anë të protestave masive përgjatë tërë krahinës. Mijëra njerëz dolën që të marrin pjesë në demonstratat, të cilat u shpërndan me forcë nga forcat speciale, duke rezultuar me vrasjen e 29 protestuesve dhe plagosjen e 97 civilëve dhe 30 policëve.⁷⁰ Këto protesta etnike u mbështetën fuqishëm nga intelektualët shqiptarë, studentët dhe qytetarët e thjeshtë përgjatë tërë Kosovës, shumica e të cilëve ishin arrestuar dhe më vonë edhe gjykuar. Më 5 korrik 1990, Kuvendi i Serbisë shpërndau Kuvendin e Kosovës si dhe Këshillin Ekzekutiv Krahinor të Kosovës, duke marrë kontrollin e plotë dhe të drejtpërdrejtë të krahinës. E tërë struktura e administratës krahinore u shpërnda dhe praktikisht brenda

⁶⁵ Gagnon, V. F., "Ethnic Nationalism and International Conflict: The Case of Serbia," *International Security*, Vol. 19, No. 3, Winter 1995/1995, f. 132.

⁶⁶ Një miratim i tillë nga Kosova ishte i nevojshëm pasi që kushtetuta e Serbisë nuk ka mundur të ndërrohet pa pëlqimin e dy krahinave.

⁶⁷ Këto ndryshime, edhe pse formalisht nuk e kishin shfuqizuar autonominë e Kosovës, në thelb e kishin degraduar seriozisht atë. Kosova ra nën vartësinë e Serbisë, dhe fuqia e saj e vetos u hoq.

⁶⁸ Për detaje shiko Judah, f. 67.

⁶⁹ Ibid. f. 74.

⁷⁰ Sipas shifrave zyrtare 24 shqiptarë ishin vrarë gjatë këtyre demonstratave, shënimet jozyrtare thonë se 70 demonstrues ishin vrarë.

natës shqiptarët u larguan nga vendet e tyre të punës, juu mohua e drejta për arsimim në gjuhën e tyre amëtare dhe ju ekspozuan një abuzimi masiv të së drejtave të njeriut dhe lirive civile.⁷¹

Kur komunizmi filloi të rrënohej në Evropën Qendrore dhe atë Lindore, edhe Lidhja e Komunistëve të Kosovës u shpërbë brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore. Rrjedhimisht, më 23 dhjetor 1989 u themelua Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Ibrahim Rugova u zgjodh kryetari i parë i saj. LDK-ja në të vërtetë ishte një lëvizje e gjerë politike, e cila shumë shpejtë i absorboi edhe anëtarët e Partisë Komuniste dhe prej kësaj kohe e deri në luftën e Kosovës në vitin 1999 u bë pika fokale kryesore e rezistencës ndaj sundimit të Serbisë.⁷² Gjatë kësaj periudhe u themeluan edhe organizata të tjera të pavarura, siç janë Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMLDNJ) në vitin 1989 dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) në vitin 1990. Ndërkohë, gjatë viteve të 90ta, të gjitha republikat jugosllave e braktisën Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, duke adaptuar sisteme demokratike shumëpartiake. Kosova, megjithatë, në vend se të përjetonte një tranzicion nga një sistem njëpartiak në një sistem shumëpartiak, ajo përtjetoj një tranzicion nga një sistem njëpartiak majtist komunist në një sistem njëpartiak të djathtë.⁷³ E mbështetur nga shumica dërmuese e shqiptarëve të Kosovës, LDK-ja e udhëhequr nga Ibrahim Rugova adaptoi rezistencën paqësore si mjet kundër regjimit të Serbisë. Të përballur me një kundërshtar, i cili perceptohej si gjenocidal dhe i cili ishte i etur për të provokuar luftën, rezistenca paqësore u shfaq si një mundësi e shqiptarëve për mbijetesë.⁷⁴ Megjithatë, duhet të përmendet se rruga paqësore ishte më shumë se sa një shfaqje e realitetit pasi që u bë edhe pjesë e ndërtimit të një identiteti “modern” shqiptar. Një gjë e tillë u përkrah si nga udhëheqësit e fshatit ashtu edhe nga intelijenca urbane në një përpjekje të përbashkët për të shmangur një tragjedi. Udhëheqësit e fshatrave e panë këtë si një pikë kyçe për të ruajtur shoqërinë shqiptare në Kosovë përgjatë kohës së luftës. Intelijenca urbane, në anën tjetër, e shikoi si një lëvizje e cila do ta përfronte

⁷¹ Shfuqizimi i autonomisë së Kosovës u pasua nga një sërë aktesh ligjore, të vlefshme vetëm për territorin e Kosovës, me anë të së cilave iu privuan shqiptarë të Kosovës shumë të drejta themelore të njeriut. Ato përfshinin Aktin për Marrëdhënie Pune në Rrethana të Veçanta, Aktin e Arsimit, dhe Aktin e Kufizimit të Transaksioneve për Patundshmëri. Si rezultat i kësaj prej 170,000 shqiptarëve të punësuar në sektorin publik, 115,000 ishin larguar nga puna. Akti i Arsimit pothuajse kishte dëbuar gjysmë milioni të rinj shqiptarë nga sistemi arsimor shtetëror; shih Muhamedin Kullashi, “Kosovo and Disintegration of Yugoslavia,” në editorialet e Dusan Janjic dhe Shkelzen Maliqi, eds. *Conflict or Dialogue: Serbian-Albanian Relations and Integration of the Balkans*, Subotica: Open University, 1994, f. 183.

⁷² Judah, f. 69.

⁷³ Agani, Mentor, “Integrimi i partive politike në organizatat ndërkombëtare të partive politike: Shpjegimi i Vonesës” Prishtina: KIPRED dhe KAS, 2015, pf. 5-8.

⁷⁴ Maliqi, Shkelzen, “Self-Understanding of the Albanians in Nonviolence,” in D. Janjic’ and S. Maliqi (eds), *Conflict or Dialogue: Serbian-Albanian relations and integration of the Balkans*, Subotica, 1994, f. 239.

qëndrimin e Kosovës me pjesën tjetër të Evropës.⁷⁵ Mbi të gjitha, kjo ishte periudha kur ndodhi një homogjenizim i madh i të gjitha shtresave të shqiptarëve të Kosovës pavarësisht nga feja, pasuria, klasa dhe profesioni.⁷⁶ Ndërkohë, aparteidi i cili po ndodhte *de facto* në vend kishte shtyrë komunitetin etnik shqiptar në margjinat e organizimit shoqëror dhe ekonomik, duke e çuar atë drejt krijimit gradual të institucioneve të tyre paralele, me një presidencë funksionale, qeveri, legjislativ dhe një sistem edukativo-arsimor dhe mjekësor.⁷⁷

Edhe pse komuniteti shqiptar i Kosovës ishte me shumicë myslimane, islami kishte mbetur plotësisht i marginalizuar në mesin e shqiptarëve të Kosovës gjatë kësaj periudhe. Në të njëjtën mënyrë sikurse edhe rilindasit shqiptarë të fundshekullit të XIX dhe fillim-shekullit të XX, edhe shqiptarët e Kosovës e kundërshtuan fuqishëm politizimin e islamit. Përkundrazi, ata promovuan vlerat e tyre evropiane dhe perëndimore si një vulë dalluese e “identitetit të tyre evropian.”⁷⁸ Për më tepër ata në mënyrë të vazhdueshme janë mbledhur rreth simboleve katolike, siç ishin para së gjithash Skënderbeu dhe Nëna Terezë, duke shënuar festat e shenjta katolike dhe duke marrë pjesë në ceremonitë e kremtimit të Pashkëve dhe Krishtlindjeve. Një shfaqje e tillë e solidaritetit për barazinë fetare me anë të së cilës shumica myslimane e Kosovës tregonte respekt për pakicën katolike, kishte për qëllim të demonstronte gjithashtu se ata nuk ishin myslimanë fundamentalistë ashtu siç ishin portretizuar në propagandën serbe.⁷⁹ Autoritetet e arsimit kishin vendosur që në klasat e shkollave fillore dhe të mesme shqipe të vendosej portreti i Skënderbeut. Heroi i madh kombëtar i krishterë nga shekulli i XV sërish nxiti ndjenjën e kombit të përbashkët mbarëshqiptar. Në anën tjetër, “unifikimi shpirtëror” me anë të arsimit shërbeu si një pararendës i një unifikimi politik mbarëshqiptar.⁸⁰

Megjithatë, udhëheqësit e bashkësive fetare, si myslimanë ashtu edhe ata katolikë, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në homogjenizimin kombëtar etnik të shqiptarëve në Kosovë dhe luftën e tyre kundër Serbisë. Qysh prej fillimit të viteve të 90ta udhëheqësia e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK)⁸¹ e ka përshtatur linjën e veprimit të saj me agjendën politike të elitës politike kosovare, duke lobuar në mënyrë aktive në favor të

⁷⁵ Clark, Howard, *Civil Resistance in Kosovo*, London: Pluto Press, 2000, f. 66.

⁷⁶ Kostovicova, Denisa, *The Politics of Identity and Space*, New York: Routledge, 2005, f. 117.

⁷⁷ Për një shpjegim të detajuar në lidhje me këtë çështje shiko Pula, Besnik, “The Emergence of the Kosovo ‘Parallel State’ 1988-1992,” *Nationalities Papers* 32, no. 4 (dhjetor 2004): pf. 797-826.

⁷⁸ Merdjanova, 2013, f. 45.

⁷⁹ Clark, 2000, f. 66.

⁸⁰ Gjatë kësaj periudhe, ka pasur thirrje për krijimin e një sistemi të unifikuar mbarë shqiptarë të arsimit, në vend të se të kishte dy sisteme arsimit të ndara në Kosovë dhe në Shqipëri; shih Kostovicova, 2005, f. 131.

⁸¹ Bashkësia Islame e Kosovës (BIK).

pavarësisë së Kosovës.⁸² Përveç kësaj, objektet fetare myslimane, sidomos *Medreseja* në Prishtinë, janë përdorur shpesh për mbajtjen e takimeve të Kuvendit dhe atyre të Qeverisë. Për sa i përket rezistencës së përgjithshme kundër sundimit të Serbisë, islami edhe më tepër e ka fuqizuar kundërshtimin ndaj serbëve ortodoksë, ndërsa konflikti i armatosur së bashku me kufijtë etnikë i ka përforcuar edhe ata fetarë.⁸³ Në mënyrë të ngjashme, edhe udhëheqësit dhe inteligjenca e bashkësisë katolike kanë qenë shumë aktive gjatë periudhës së rezistencës paqësore kundër Serbisë. Anton Çetta, Don Lush Gjergji, Mark Krasniqi, përveç se kanë mbajtur pozita të larta në institucionet paralele të Kosovës, gjithashtu kanë luajtur edhe një rol të rëndësishëm në fushatat për pajtimin e gjaqeve.⁸⁴ Më e rëndësishmja është se udhëheqësit e bashkësive fetare në Kosovë në mënyrë aktive kanë bashkëpunuar me elitën politike dhe strukturat e tjera përkatëse me qëllim të avancimit të pozitës së shqiptarëve dhe Kosovës gjatë periudhës 1989-1999.⁸⁵ Megjithatë, gjatë kësaj periudhe për shumicën dërrmuese të shqiptarëve besimi nuk kishte fare të bënte me fenë. Ata personalisht kishin shtrirë besimin e tyre të madh drejt Rugovës, i cili si një njeri i urtë, i guximshëm dhe i kujdesshëm që duhej ta dinte më së miri se çfarë ishte gjëja me e mirë për Kosovën.⁸⁶

Nëse rruga paqësore ishte forma themelore e rezistencës, atëherë solidariteti, sistemi paralel arsimor dhe shëndetësor dhe fushatat për faljen e gjaqeve ishin elementet kryesore përkufizuese të rezistencës etnike dhe civile që drejtpërdrejtë kontribuan në homogjenizimin dhe mobilizimin e madh të shqiptarëve të Kosovës. Në fillim të viteve të 90ta ishin zhvilluar forma të ndryshme të rezistencës civile, siç ishin vendosja e qirinjeve në dritare apo ballkone para fillimit të orës policore apo organizimi i demonstratave me një orë heshtje në rrugët e Prishtinës, duke mbajtur afishe të mbishkruara me fjalët “Stop Dhunës”. Ajo që është më e rëndësishme, si pjesë e rezistencës civile ndaj Serbisë, është se shqiptarët e Kosovës krijuan sistemin e tyre paralel të arsimit dhe shëndetësisë. Edhe për kundër faktit se arsimit ishte organizuar në shtëpi dhe garazhe private, në veçanti për nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët e universitetit, ishte arritur që të krijohet një kurrikulë e re e cila kishte për qëllim të promovonte identitetin shqiptar.⁸⁷ Sistemi paralel i arsimit e kishte galvanizuar edhe më tepër veprimtarinë e të

⁸² Iseni, f. 5.

⁸³ Merdjanova, 2013, f. 44.

⁸⁴ Anton Çetta ishte Kryetari i parë i Shoqatës Nënë Tereza, themeluesi dhe udhëheqësi i Komitetit për Pajtimin e Gjaqeve në Kosovë dhe në vitin 1992 ai u zgjodh si anëtar i LDK-së në Kuvendin e Kosovës; Don Lush Gjergji e k atrashëguar Çettën në krye të Shoqatës Nëna Terezë dhe ishte gjithashtu anëtar i për Pajtimin e Gjaqeve, Mark Krasniqi ishte anëtar i Kuvendit të Kosovës gjatë legjislaturës së viteve 2001-2004, 2004-2007, dhe 2007-2010 duke përfaqësuar Partinë Shqiptare Demokratike të Kosovës dhe LDK-së, dhe ka shërbyer edhe si Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

⁸⁵ Bashkëpunimi më i madh në mes të Nikë Prelaj dhe Don Lush Gjergjit me Rexhep Bojën vërehet gjatë fushatës së pajtimit të gjaqeve.

⁸⁶ Clark, 2000, f. 117.

⁸⁷ Kastrati, Ardian, “Civil Society Development and its Impact on the Democratization Process in Kosovo,” *Mediterranean Journal of Social Sciences*, Vol. 6 No. 2 S5, April 2015, f. 74.

gjithë komunitetit shqiptar të Kosovës, duke kontribuar kështu në homogjenizimin e paparë të saj. Institucionet paralele u shndërruan në një aspekt të rëndësishëm të krenarisë kombëtare dhe u bënë motivim për ngulmim të vazhdueshëm të shqiptarëve për shtetësinë e tyre. Një sistem i tillë arsimor përveç se ishte një mishërim i rezistencës civile dhe paqësore, njëkohësisht shërbeu edhe si një argument për të dëshmuar ekzistencën e shtetit të pavarur të Kosovës.⁸⁸

Në anën tjetër, pasi që me mijëra punëtorë shëndetësorë ishin larguar nga puna prej spitaleve publike, shqiptarëve të Kosovës iu desht që të organizonin edhe sistemin e tyre paralel të shëndetësisë. Shtylla kryesore e sistemit të shëndetësisë ishte “Shoqata Nëna Terezë” (SHNT) e cila në mënyrë simbolike kishte marrë emrin e Nënës Terezë – figurës së mirënjohur katolike shqiptare. Një paraqitje tjetër e marrëdhënieve të shkëlqyera ndërfaqetare që ekzistonin në mesin e shqiptarëve në Kosovë gjatë kësaj periudhe ishte edhe emërimi i Anton Çettës - një intelektual të shquar katolik shqiptar - si drejtor i parë i Shoqatës. Për më tepër, Shoqata ofroi shërbime mjekësore dhe shpërndarje të ushqimit për të gjitha kategoritë e popullatës civile shqiptare nëpër tërë Kosovën, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre fetare.⁸⁹ Shoqata Nëna Terezë e hapi klinikën e saj të parë në Prishtinë në mars të vitit 1992, duke vazhduar ndërkohë zgjerimin e shtrirjes së rrjetit të saj të klinikave për ofrim të shërbimeve mjekësore. Rrjedhimisht, në fillim të vitit 1998 një rrjet i tillë në vetvete përfshinte 91 klinika dhe diku afër 7000 vullnetarë të anagzhuar që ofronin shërbimet e tyre mjekësore dhe shpërndarjen e ndihmave humanitare për rreth 350,000 njerëz. Duhet të përmendet se të gjitha trajtimet, përfshirë edhe medikamentet, ishin pa pagesë, për të gjithë qytetarët, pavarësisht prejardhjes së tyre etnike apo fetare. Është shumë interesante se për shkak të rritjes së mbështetjes ndërkombëtare,⁹⁰ klinikat e SHNT-së shumë herë ishin më mire të furnizuara me medikamente se sa vetë klinikat serbe, dhe si rezultat i kësaj edhe shumë serbë filluan të kërkojnë trajtim pranë këtyre klinikave.⁹¹ Nga njëra anë, një realitet i tillë vuri në dukje se vetë-organizimi i shqiptarëve mund të ishte më efektiv se sa regjimi i Serbisë në ofrimin e shërbimeve mjekësore ndaj qytetarëve. Në anën tjetër, një gjë e tillë e kishte shfaqur në praktikë solidaritetin e shqiptarëve për kujdes ndaj njerëzve prej të gjitha grupeve etnike dhe fetare.

Elementi përfundimtar që ka luajtur një rol të rëndësishëm në tërë procesin e homogjenizimit të shqiptarëve të Kosovës ishte padyshim edhe lëvizja e madhe për pajtimin e gjaqeve në Kosovë. Historikisht, kodi zakonor, i cili ka qenë më i shprehur në mesin e shqiptarëve, ka qenë Kanuni i Lekë Dukagjinit. Kanuni, në mes të tjerash, ka

⁸⁸ Kostovicova, 2005, f. 97.

⁸⁹ Për detaje shiko Clark, 2000, f. 107; shiko gjithashtu Kastrati, 2015, f. 74.

⁹⁰ Prej vitit 1994, Shoqata Nëna Terezë ka pranuar mbështetje të konsiderueshme nga organizatat ndërkombëtare si *Medecins sans Frontieres* dhe *Catholic Relief Services*.

⁹¹ Clark, 2000, f. 108.

përfshirë edhe një rregull ligjore të përpunuar, me anë të së cilës ishte përpjekur të rregullohej çështja e gjakmarrjes.⁹² Pas shtypjes së autonomisë së Kosovës, motivimi kryesor për t'i dhënë fund gjakmarrjes ishte nevoja që shqiptarët e Kosovës të bashkoheshin në luftë kundër sundimit serb. Brenda një realiteti të tillë, shqetësimi kryesor ishte padyshim mbrojtja e kombësisë shqiptare, e përfaqësuar përmes një strategjie të mbrojtjes kombëtare kundër regjimit serb.⁹³ Prandaj, në njërin anë Kanuni u shndërrua në një pikë të rëndësishme reference për të portretizuar kundërshtimin e Serbisë. Në anën tjetër, i shërbeu qëllimit për përfundimin e unitetit në radhët e shqiptarëve. Një mënyrë që shqiptarët zgjodhën për të reaguar ndaj represionit dhe dhunës së Serbisë ishte eliminimi i dhunës në mesin e tyre.⁹⁴ Rrjedhimisht, në fillim të viteve të 90ta, elita intelektuale shqiptare e Kosovës, e drejtuar nga Anton Çetta, inicioi një fushatë mbarëkombëtare për pajtimin e gjaqeve. Gjatë një periudhe disa vjeçare, afërsisht 500 aktivistë udhëtuan nëpër gjithë Kosovën për të bindur familjet në gjakmarrje për ta falur gjakun dhe për t'i dhënë fund gjakmarrjes.⁹⁵ Sipas burimeve të caktuara, kishin ndodhur rreth 2,000 ceremoni të pajtimit, ndërkaq që ishin pajtuar qindra familje të përfshira në 1200 raste të gjakmarrjes në tërë Kosovën.⁹⁶ Gjatë kësaj periudhe, dallimet fetare jo vetëm që nuk ekzistonin fare dhe ishin mposhtur nga homogjenizimi etnik, për më tepër Kosova kishte dëshmuar një bashkëpunim të paparë fetar si në nivel institucional ashtu edhe individual. Bashkësia Islame e Kosovës dhe Kisha Katolike fuqimisht i kanë mbështetur këto përpjekje, ndërsa dy udhëheqësit e tyre të shquar fetarë, Rexhep Boja dhe Don Lush Gjergji ishin përfshirë personalisht pothuajse në të gjitha tubimet për faljen e gjaqeve.

Megjithatë, nga fundi i viteve 90-ta u ngritën shqetësimet në mesin e shqiptarëve në lidhje me mos-vlerësimin e politikës paqësore nga ana e bashkësisë ndërkombëtare. Rrjedhimisht, prej vitit 1997 dhuna në Kosovë filloi të rritet dukshëm. Fluksi i armëve të vogla që depërtoi në Kosovë pas trazirave të dhunshme shoqërore në Shqipëri, në kombinim me një kolaps të plotë të rendit dhe ligjit, ndihmoi daljen në skenë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), një forcë e fshehtë guerile që zbatonte një strategji të sulmeve ndaj stacioneve policore dhe vrasjes së zyrtarëve policor serbë dhe bashkëpunëtorëve shqiptarë të regjimit serb.⁹⁷ Autoritetet serbe reagueshan me anë të bastisjeve policore, gjykimeve politike dhe brutalitetit ekstrem. Mes periudhës mars-tetor 1998 ishin vrarë afërsisht 2,000 shqiptarë, shumë shtëpi, dyqane dhe shkolla ishin

⁹² Kastrati, 2015, f. 74.

⁹³ Clark, 2000, f. 64.

⁹⁴ Kostovicova, 2005, f. 117.

⁹⁵ Pratt, Suzana, "Gjakmarrja: Albanian Blood Feuds and Restorative Applications of Traditional Justice," GAPS Conference submission, 2013, f. 13; https://www.academia.edu/4654081/Gjakmarrja_Albanian_Blood_Feuds_and_Restorative_Applications_of_Traditional_Justice (25.04.2016).

⁹⁶ Shiko Clark, Howard, "Nonviolent Struggle in Kosovo," *War Resisters' International*, 1 January 2001; <http://www.wri-irg.org/nonviolence/nvse16-en.htm> (25.04.2016).

⁹⁷ Calic, f. 28.

shkatërruar dhe rreth 400,000 civilë shqiptarë ishin detyruar të braktisnin shtëpitë e tyre.⁹⁸ Të ballafaquar me rrjedhën e refugjatëve në vendet fqinje, si dhe nga frika për një përhapje të luftës jashtë Kosovës, komuniteti ndërkombëtar gjatë muajit shkurt kishte planifikuar negociatat ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Rambuje të Francës. Duke u përballur në vazhdimësi me dhunën serbe dhe duke qenë se vetëm shqiptarët kishin nënshkruar marrëveshjen e paqes, me 24 mars 1999 NATO filloi sulmet e para ajrore kundër caqeve në Kosovë, dhe më pas edhe në Serbi. Pas 78 ditëve të vazhdueshme të fushatës ajrore të NATO-s kundër Republikës Federative të Jugosllavisë (RFJ), më 10 qershor 1999 përfaqësuesit e Armatës Jugosllave dhe ata të NATO-s nënshkruan Marrëveshjen Teknike Ushtarake për tërheqjen e trupave jugosllave nga Kosova, gjë që i dha fund luftës.⁹⁹

Duhet të përmendet se gjatë periudhës së konfliktit të armatosur të viteve 1998-1999, shqiptarët kanë vazhduar të theksojnë karakterin sekular të nacionalizmit shqiptar duke bërë përpjekje për të parandaluar përfaqësimin e identitetit shqiptar si myslimanë në sytë e perëndimit. Asnjë grup politik shqiptar apo luftëtar nuk e ka identifikuar veten me përkatësinë fetare.¹⁰⁰ Udhëheqësit e UÇK-së ishin të vetëdijshëm se një përqaftim i mundshëm i islamit do ta rrezikonte seriozisht mbështetjen perëndimore ndërkombëtare për kryengritjen e tyre. Prandaj, ideologjia e UÇK-së ishte thuajse plotësisht e bazuar në nacionalizmin shqiptar, me theks të veçantë në përkatësinë etnike shqiptare, aspiratat nacionaliste dhe ato të kulturës shqiptare. Për më tepër, për shkak të homogjenizimit të fortë etnik dhe mobilizimit të shqiptarëve që nga viti 1989, UÇK-ja e kishte lehtë të izolohej nga idetë e huaja të fundamentalistëve islamikë nga Arabia Saudite që erdhën në Kosovë në numër të vogël për të depërtuar në radhët e UÇK-së.¹⁰¹ Një realitet i tillë është evidentuar ndër të tjera nga ana e gazetares Stacy Sullivan nga gazeta "Newsweek", e cila shkroi në mes tjerash se "përgjatë dy viteve sa kam raportuar për konfliktin e Kosovës, asnjëherë nuk kam parë luftëtarë muxhahedinë, të cilët i kam hasur në Bosnje, dhe as nuk kam dëgjuar ndonjë ushtar të UÇK-së duke aluduar për ndonjë lloj përkushtimi ndaj Islamit."¹⁰²

Argumentet e mësipërme ishin mbështetur plotësisht nga të gjithë personat të cilët ishin intervistuar si pjesë e këtij hulumtimi. Sipas Fatmir Sejdiut, periudha e viteve të 90ta në

⁹⁸ Shiko për shembull disa artikuj të publikuar gjatë muajit tetor të vitit 1998 në gazetën ditore në gjuhën shqipe në Kosovë, Koha Ditore, dhe raportet nga zyra e UNHCR në Prishtinë të nxjerra gjatë kësaj periudhe.

⁹⁹ Benson, f. 177.

¹⁰⁰ Merdjanova, 2013, f. 44.

1. ¹⁰¹ Perrit, Henry H., Kosovo Liberation Army: The Inside Story of an Insurgency, University of Illinois Press, 2008, f. 29.

¹⁰² Totten, Michael J., "Kosovo's Moderate Muslims: The world's newest country is a model of tolerance," The Wall Street Journal, 30 December 2008; <http://www.wsj.com/articles/SB123059201269240805> (25.04.2016).

Kosovë, është periudha e një homogjenizimi të përgjithshëm të shqiptarëve, si formë e vetë-mbrojtjes ndaj nacionalizmit ekstrem serb, i cili kishte për qëllim zhdukjen e plotë të etnisë shqiptare në Kosovë. Sejdiu thekson se ringjallja e nacionalizmit serb ka evoluar rreth tre shtyllave kryesore: (1) Kishës Ortodokse Serbe; (2) Akademisë së Shkencave të Serbisë; dhe (3) Institucioneve zyrtare politike. Një nacionalizëm i tillë kishte për qëllim vendosjen e dominimit serb si në Jugosllavi ashtu edhe në Kosovë. Sejdiu vë në pah se shqiptarët e Kosovës kishin reaguuar me një platformë të gjerë kombëtare e cila ngërthente të gjitha aspektet e jetës nëpërmjet një sistemi të pavarur paralel. Nën udhëheqjen e LDK-së, shqiptarët arritën të organizojnë vetveten gjatë kësaj periudhe si politikisht (zgjedhje, referendum, etj.) ashtu edhe në aspektin shoqëror (arsim, shëndetësi, art dhe kulturë). Tiparet kryesore të nacionalizmit shqiptar kishin orientim paqësor, pro-perëndimor dhe bashkim të shqiptarëve pavarësisht përkatësisë së tyre fetare apo shoqërore. Më vonë, për shkak të shqetësimeve që lindën në lidhje me rezistencën paqësore, e cila nuk po sillte rezultatet e dëshiruara, shqiptarët u detyruan që gradualisht të përfshiheshin në rezistencë të armatosur.¹⁰³

Në të njëjtën mënyrë, Albin Kurti beson se periudha e viteve 1989–1999 ka qenë periudhë kur të gjithë shqiptarët kanë qenë si të burgosur; kanë pasur barazi, por jo edhe liri; dhe Serbia ka qenë gardiani i burgut, i cili i mbante të gjithë shqiptarët të burgosur, të shtypur dhe të torturuar. Kushtet e tilla të barazisë pa liri, sipas Kurtit, e kanë çuar popullin drejt një solidariteti të gjerë popullor dhe shoqëror duke përfunduar identitetin kombëtar shqiptar, pasi që Serbia kishte diskriminuar shqiptarët në bazë të etnisë së tyre dhe jo për shkak se dikush ishte inxhinier apo mjek. Shqiptarët u bënë objekt i një shtypjeje të përgjithshme dhe masive vetëm për shkak të identitetit të tyre kombëtar. Kurti thekson se një realitet i tillë ka kontribuar në ringjalljen e nacionalizmit shqiptar dhe ka çuar në një homogjenizim të paparë etnik dhe social. Në të njëjtë kohë, shqiptarët kishin filluar ndërtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës nëpërmjet disa akteve siç janë Shpallja e Kushtetutës në Korrik të vitit 1990, Referendumi për Pavarësi në Shtator të vitit 1991, zgjedhjet e përgjithshme në Maj të vitit 1992. Sipas Kurtit procesi i homogjenizimit u përshpejtua edhe më tepër me krijimin e një sistemi alternativ paralel arsimor, nga niveli fillor deri në nivelin universitar. Për më tepër, Kurti është i bindur se të gjitha këto zhvillime kanë galvanizuar në mënyrë të jashtëzakonshme identitetin kombëtar në mesin e shqiptarëve, aq sa shprehja e famshme "feja e shqiptarëve është shqiptaria!" u bë edhe më e fuqishme se kurdoherë më parë. Sido që të jetë, ai e thekson gjithashtu se feja, si myslimane ashtu edhe ajo katolike, i kanë mbështetur fuqimisht këto zhvillime. Hoxhallarët dhe priftërinjtë ishin përfshirë së bashku në të gjitha veprimtaritë, prej ligjëratave nëpër xhamia dhe takimeve politike në objektet e medreseve, deri tek përfshirja e Don Lush Gjergjit dhe

¹⁰³ Intervistë me Fatmir Sejdiu, ish President i Republikës së Kosovës dhe ish Kryetar i LDK-së, Prishtinë, 10 shkurt 2016.

Rexhep Bojës në faljen e gjaqeve. Në të vërtetë Kurti beson se falja e gjaqeve, edhe pse shpeshherë e nënvlerësuar apo shumë pak e përmendur, ka luajtur një rol vendimtar në procesin e homogjenizimit.¹⁰⁴

Përfaqësuesit e bashkësive fetare ndajnë pak a shumë të njëjtin mendim në lidhje me zhvillimet gjatë periudhës 1989-1999. Sipas Myftiut Naim Tërri, marrëdhëniet ndër-fetare në mesin e shqiptarëve të Kosovës kanë qenë të shkëlqyeshme si gjatë periudhës së rezistencës paqësore ashtu edhe gjatë luftës së armatosur. Këto marrëdhënie kanë qenë në harmoni të plotë me objektivat e shpallura të platformës paqësore të shqiptarëve dhe kanë evoluar në pajtim me rrethanat gjatë periudhës së rezistencës së armatosur. Tërri shpjegon se Bashkësia Islame e Kosovës dhe Kisha Katolike kanë koordinuar qëndrimet e tyre së bashku për të mirën e vendit dhe të shtetit. Ai e konsideron një qëndrim të tillë si të kuptueshëm, pasi që pavarësisht feve të ndryshme, shqiptarët në Kosovë i përkasin të njëjtit komb/popull. Në rrethana të tilla, të gjithë shqiptarët ishin mbledhur rreth një qëllimi më të lartë dhe të përbashkët, i cili në mënyrë të qartë ka mënjeluar dallimet fetare.¹⁰⁵ Në anën tjetër, për Don Shan Zefin, Kreu i Ipeshkvisë së Kosovës, vitet 1989-1999 përfaqësojnë një periudhë të artë të bashkimit të shqiptarëve etnikë në Kosovë si në aspektin kombëtar ashtu edhe atë fetar. Zefi beson se gjatë kësaj periudhe, bashkimi, toleranca dhe humanizmi në mesin e shqiptarëve kishte arritur nivelin më të lartë të mundshëm. Një periudhë e tillë, edhe pse e vështirë dhe e tmerrshme, ishte në të njëjtën kohë edhe një periudhë e krenarisë dhe forcës së vetëdijes kombëtare në mesin e të gjithë shqiptarëve pavarësisht përkatësisë së tyre fetare.¹⁰⁶ Dhe në fund, Femi Cakolli, Pastor i Kishës Protestante, gjithashtu beson se periudha e viteve 1989 dhe 1999 paraqet një nga periudhat më të shquara të historisë së shqiptarëve të Kosovës. Ai vë në dukje se procesi i homogjenizimit kombëtar ishte mundësuar vetëm në sajë të një angazhimi të përkushtuar dhe të koordinuar të intelektualëve të njohur (Gazmend Zajmi, Anton Çetta), politikanëve (Ibrahim Rugova, Fehmi Agani) dhe udhëheqësve fetarë nga të gjitha fetë (Nik Prelaj dhe Rexhep Boja). Sipas Cakollit, është mbresëlënëse se si shqiptarët gjatë kësaj periudhe arritën të përballonin me sukses masat represive të regjimit serb, pavarësisht mungesës së institucioneve përkatëse, policisë apo fondeve. Për më tepër, ata arritën të minimizojnë propagandën serbe, e cila u përpoq të portretizojë shqiptarët si fundamentalistë myslimanë, duke promovuar identitetin e tyre evropian dhe duke u mbledhur rreth simboleve dhe figurave katolike.¹⁰⁷

¹⁰⁴ Intervistë me Albin Kurti, ish Kryetar i Partisë Vetëvendosje dhe anëtar i Kuvendit të Kosovës, 04 prill 2016.

¹⁰⁵ Intervistë me Dr. Naim Tërri, Kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 24 mars 2016.

¹⁰⁶ Intervistë me Dr. Don Shan Zefi, Ipeshkvi i Kishës Katolike në Kosovë, Prizren, 31 mars 2016.

¹⁰⁷ Intervistë me Dr. Femi Cakollin, Pastor i Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës, Prishtinë, 17 mars 2016.

Përfaqësuesit e intervistuar nga fusha e akademisë kanë përforcuar edhe më tepër argumentin se periudha në mes të viteve 1989 dhe 1999 paraqet një periudhë të artë të homogjenizimit kombëtar dhe bashkëpunimit ndër-fetar në mesin e shqiptarëve të Kosovës. Sipas Xhabir Hamitit¹⁰⁸, kjo periudhë karakterizohet me marrëdhënie të shkëlqyera ndër-fetare në mesin e shqiptarëve, që ishte një reagim ndaj politikave të hegjemonisë së autoriteteve të Serbisë dhe Kishës Ortodokse, e cila mbështeste në mënyrë të plotë politikat e tilla diskriminuuese. Përgjatë këtyre viteve të okupimit klasik të Kosovës nga regjimi serb, shqiptarët kanë treguar unitetin e tyre kombëtar si asnjëherë më parë. Ata i kanë treguar bashkësisë ndërkombëtare se pavarësisht prejardhjes së tyre fetare, ata ishin të gjithë të bashkuar kundër okupimit të Serbisë. Hamiti thekson se uniteti i udhëheqësve fetarë myslimanë dhe katolikë, si gjatë periudhës së rezistencës paqësore ashtu edhe gjatë konfliktit të armatosur, paraqet një shembull të jashtëzakonshëm të bashkëpunimit ndër-fetar. Këta udhëheqës fetarë meritojnë njohjen më të lartë për kontributin e tyre kolosal për interesin e përbashkët kombëtar. Në anën tjetër, Anton Berishaj gjithashtu thekson se ndryshe nga vendet e tjera në rajon, në Kosovë, komunikimi ndër-fetar mes myslimanëve dhe katolikëve shqiptarë ka qenë tradicionalisht shumë i mirë. Vitet e krizave dhe rrezikut të përbashkët nga sundimi serb kanë kontribuar në afrimin e tyre edhe më të madh sidomos gjatë periudhës së viteve 1989-1999. Gjatë këtyre viteve, figurat e njohura të Kishës Katolike, si At Nikë Prella dhe At Lush Gjergji, kanë qenë thellë të përfshirë në aktivitete të ndryshme të shqiptarëve në interes të qëllimeve të tyre të përbashkëta. Përveç kësaj, sipas Berishajt, udhëheqësit myslimanë dhe katolikë në Kosovë kanë bashkëpunuar tradicionalisht me qëllim të kapërcimit të çështjeve që eventualisht kanë pasur mundësi të kontribuojnë në përkeqësimin e marrëdhënieve ndër-fetare.¹⁰⁹

Sipas kësaj që është paraqitur më lart, është e qartë se gjatë kësaj periudhe shqiptarët e Kosovës në përpjekjet e tyre për liri kishin arritur një nivel të paparë të homogjenizimit të tyre kombëtar, fetar dhe shoqëror. Të përballur me një kundërshtar, të cilin e perceptonin si gjenocidal, shqiptarët të udhëhequr nga LDK-ja zgjodhën rezistencën paqësore si mundësinë e tyre për mbijetesë kombëtare. Ndërsa feja gjatë gjithë kësaj periudhe ishte marginalizuar nga elitat politike dhe intelektuale, drejtuesit e bashkësive fetare të Kosovës kanë bashkëpunuar në mënyrë aktive me këto elita dhe struktura të tjera përkatëse me qëllim të avancimit të statusit të Kosovës dhe të shqiptarëve. Siç do të tregohet në kapitullin vijues, pas luftës, në vend të homogjenizimit të të gjitha shtresave të shoqërisë, Kosova do të përjetojë një fragmentim shoqëror dhe rritje të religjiozitetit.

¹⁰⁸ Intervistë me Dr. Xhabir Hamitin, Profesor pranë Universitetit të Shkencave Islame të Kosovës, Prishtinë, 10 mars 2016.

¹⁰⁹ Intervistë me Anton Berishajn, Profesor në Universitetin e Prishtinës, Prishtinë, 10 shkurt 2016.

III.2. 1999-2008: Administrata Ndërkombëtare, fragmentimi shoqëror dhe rritja e fetarizimit

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, më 10 qershor 1999 me anë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurisë të OKB-së u themelua Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara (UNMIK), i cili kishte për qëllim administrimin e Kosovës pa paragjykuar statusin e saj të jashtëm.¹¹⁰ Për herë të parë në historinë e saj, duke zëvendësuar rolin e shtetit, OKB-së i ishte dhënë një mandat i paprecedent, si në shtrirjen e saj ashtu edhe në kompleksitetin strukturor. Rezoluta 1244 për themelimin e UNMIK-t, i kishte dhënë këtij Misioni mandatin që: të kryente funksionet themelore civile administrative, të përkrahte krijimin e një autonomie dhe vetëqeverisje përmbytësore në Kosovë, të ndihmonte një proces politik me qëllim të përcaktimit të statutit të ardhshëm të Kosovës, të koordinonte ndihmat humanitare dhe ndihmat në raste të fatkeqësive të të gjitha organizatave ndërkombëtare, të përkrahte rindërtimin e infrastrukturës kyçe dhe rindërtimin tjetër ekonomik, të ruante ligjin dhe rendin, të mbronte të drejtat e njeriut dhe të garantote kthimin e shpejtë dhe të papenguar të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë.¹¹¹ Thënë shkurt, për sa i përket shtrirjes dhe ambicies, mandati i UNMIK-ut ishte thujtë i paprecedent për sa i përket standardeve të mëparshme të operacioneve të OKB-së. Jo vetëm që i ishte dhënë autoriteti për të marrë përsipër përgjegjësinë e plotë të administrimit të përkohshëm mbi territorin e Kosovës, UNMIK-ut i ishte caktuar edhe një rol kryesor politik për zgjidhjen e konfliktit.¹¹²

Në anën tjetër sfidat e menjëhershme në Kosovë ishin të shumta. Mijëra fshatra shqiptare ishin djegur apo granatuar dhe rreth 40 për qind e të gjitha shtëpive të banimit në Kosovë ishin dëmtuar rëndë ose shkatërruar plotësisht deri në fund të luftës.¹¹³ Kishte më shumë se një milion refugjatë dhe persona të zhvendosur të cilët ishin në nevojë të madhe për shtëpi apo strehim të përkohshëm para se të fillonte dimri. Nevoja për ndihmë humanitare dhe emergjente ishte shumë e madhe pasi që më shumë se 900,000 njerëz kishin nevojë për ushqim të rregullt dhe mbrojtje prej përhapjeve të mundshme të sëmundjeve. Në mes të një situatë të tillë të përgjithshme kaotike dhe të tmerrshme, pas dhjetë vjet vonese në krahasim me vendet e tjera ish-komuniste, një proces tjetër kishte filluar të zhvillohej në Kosovë. Realisht, ringjallja e religjiozitetit në vendet post-komuniste të Evropës, përfaqëson një proces të pritur pas rënies së

¹¹⁰ "Admnsitrimi dhe Qeverisja në Kosovë: Mësimet e mësuara dhe ato që mbeten për t'u mësuar," Prishtinë-Gjenevë: Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave, qershor 2005, f. 1.

¹¹¹ Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara, Rezoluta 1244, 1999.

¹¹² Yannis, Alexandros, "The UN as Government in Kosovo," *Global Governance* 10, 2004, f. 67.

¹¹³ "UNHCR Shelter Verification: Agency Coverage," UNHCR GIS Unit, Pristina, Kosovo, 9 November 1999.

komunizmit. Duke qenë i shtypur nga regjimi i mëparshëm, religjioni në vendet ish-komuniste në fund e gjeti një mënyrë për të bërë veten të dukshëm, duke zënë vendin e tij në kontekstin e ri të zhvillimit social. Edhe pse erdhi me vonesë si rezultat i periudhës dhjetë vjeçare të luftës për çlirim, pas luftës kjo ringjallje e religjiozitetit kishte filluar edhe në Kosovë.

Duke qenë se shumica e shqiptarëve të Kosovës janë myslimanë, është e kuptueshme se gjatë kësaj periudhe islami ka qenë religjioni që ka shfaqur rigjallërimin më të madh. Në mënyrë që të kuptohet procesi i rilindjes së islamit në Kosovë, në këtë pikë është e rëndësishme që të analizohet mënyra se si ishte organizuar sfera fetare myslimane në ish-Jugosllavi dhe pasojat që ky lloj organizimi ka pasur mbi shqiptarët myslimanë të Kosovës. Fillimisht, duhet të përmendet se natyra tolerante e Islamit të shqiptarëve të Kosovës i atribuohet kryesisht ndikimeve të ndryshme, siç janë trashëgimia Osmane e tolerancës fetare, tradita e fortë Sufi si dhe respektimi i Shkollës së Ligjit Hanefi.¹¹⁴ Islami kishte arritur në Ballkan në mes të shekujve XV dhe XVII, kur shumë *tarikate* Sufi ishin shpërndarë nëpër territoret e sapo pushtuara të Perandorisë Osmane. Islami Sufi përfaqësohej nga një numër i tarikateve (vëllazëri fetare) dhe ndonëse shumica e mësimeve të rendit Sufi bien në kuadër të sferës Suni, ata kanë arritur të ruajnë shumë besime dhe praktika jo tradicionale.¹¹⁵ Rendi Sufi me praktikën “jo-ortodokse” shpeshherë ka krijuar ura doktrinale në mes të Krishterimit dhe islamit me anë të adaptimit të besimeve lokale brenda teologjisë së rikrijuar. Praktikën e këtilla ishin thellësisht lokale dhe kanë qenë të hapura ndaj ndikimeve të praktikave të krishtera dhe zakoneve të ndryshme popullore. Rrjedhimisht, edhe shqiptarët, krahasuar me vendet e rajonit, tradicionalisht e kanë praktikuar Islamin në një mënyrë krejtësisht unike, me praktika të cilat kanë përfshirë sinteza nga forma të ndryshme të traditave lokale shpirtërore. Traditat e tilla përgjatë kohës kanë evoluar në rituale komplekse, ku mes tjerash shpeshherë myslimanët dhe të krishterët kanë ndarë edhe të njëjtat vende të shenjta.¹¹⁶

Është e qartë se Jugosllavia socialiste ka trashëguar një popullatë heterogjene myslimane e cila ka qenë e përfshirë në praktika të ndryshme dhe të shumëllojshme fetare. Rrjedhimisht, qëllimi kryesor i autoriteteve jugosllave ishte që në mënyrë efektive të vë nën kontroll jetën shpirtërore të të gjithë popullsisë myslimane në kuadër të një institucioni të vetëm duke eliminuar pluralizmin e saj. Prandaj, sfera fetare myslimane u vu nën menaxhimin dhe kontrollin e një autoriteti të vetëm fetar - Komunitetit Islamik të

¹¹⁴ Hanefizmi ka qenë historikisht një sistem ligjor islamik predominues gjatë Perandorisë Osmane që në mesin e të tjerave ka lejuar marrjen e zakoneve të shquara popullore në praktikën fetare; shih Iseni, 2009, f. 7.

¹¹⁵ Merdjanova, 2013, f. 6.

¹¹⁶ Blumi, Isa, “Islami Politik në mesin e shqiptarëve: A po vijnë talebanët në Ballkan?,” *Seri Hulumtimesth* nga KIPRED, Numër 2, Prishtinë, 2005, f. 2.

Jugosllavisë me seli në Sarajevë.¹¹⁷ Sipas Blumit, praktikat e rendit Sufi nëpër tërë Kosovën së bashku me tolerancën e tyre fetare ishin caku i Islamit të financuar nga shteti jugosllav. Si pasojë, akti i parë i Bashkësisë Islame të Jugosllavisë ishte ndalimi i të gjitha institucioneve të pa-sanksionuara myslimane në përpjekjen për të vendosur kontrollin e plotë dhe të pa kundërshtuar ndaj praktikave fetare në tërë vendin. Si rezultat i kësaj në vitin 1952 ishin ndaluar të gjitha aktivitetet e rendit Sufi, duke i mbyllur *teqet* e tyre tradicionale. Paralelisht, imamët e trajnuar nga Bashkësia Islame Jugosllave u përpoqën të largojnë shqiptarët nga *teqet sufiste* që ishin të pavarura dhe të lokalizuara, duke predikuar një doktrinë fetare me anë të së cilës këmbëngulej për një "unitet" në mesin e myslimanëve dhe shpërbërjen e besnikërisë etnike.¹¹⁸

Në anën tjetër, Iseni pretendon se këto politika represive, të cilat kryesisht kishin për cak popullatën jo-sllave dhe jo-suni, ishin të lidhura edhe me proceset agresive të sekularizimit dhe modernizimit. Proceset e tilla, së bashku me centralizimin e sferës fetare islame, në përgjithësi kanë kontribuar në një marginalizim radikal të fesë dhe në veçanti të klerit fetar mysliman.¹¹⁹ Për më tepër, emancipimi i shpejtë dhe sekularizimi i popullsisë ka kontribuar në shpërndarjen e ateizmit jo vetëm në mesin e elitës politike dhe intelektuale, por edhe në pjesën dërmuese të popullatës urbane. Rrjedhimisht, Islami ishte reduktuar vetëm në ceremoni private siç ishin praktikat e adhurimit, festat vjetore fetare dhe ceremonitë martesore dhe mortore.¹²⁰ Megjithatë, myslimanët shqiptarë të Kosovës që jetonin në vendet rurale i kanë rezistuar në mënyrë të fuqishme përpjekjeve të Jugosllavisë për centralizim, dhe prandaj edhe përkundër represionit, rendi Sufi ka mbijetuar me sukses. Përgjatë tërë kësaj periudhe, rendi Sufi në zonat rurale të Kosovës në mënyrë aktive ka adresuar përpjekjet e Sarajevës për centralizim, duke tërhequr në të njëjtën kohë edhe shumë besimtarë nga zonat urbane.¹²¹

Pas ndryshimeve të favorshme kushtetuese që ndodhën në vitin 1974, këto rrjete të fshehta Sufi (Dervishët) krijuan një shoqatë të rendit Sufi (Bashkësia e Radhëve Dervishe Islame Alije - BRDIA), e cila drejtohej nga Sheiku Xhemali Shehu i *teqesë* Rufai me seli në Prizren. Edhe pse menjëherë ishin përgojuar nga udhëheqësit islamikë në Sarajevë, BRDIA shpejt arriti të bëhet një forcë kulturore në jetën publike të Kosovës pasi që institucionet e saj kanë tërhequr një numër të madh të myslimanëve shqiptarë. Si pasojë, diku 126 teqe Sufi nëpër tërë Kosovën, që përfaqësonin 50,000 dervishë, iu

¹¹⁷ Iseni, 2009, f. 8.

¹¹⁸ Blumi, Isa. "Religion and Politics among Albanians of Southeastern Europe," in *Religion and Politics in Central and Southeastern Europe: Challenges since 1989*, ed. Sabrina F. Ramet, New York: Palgrave, 2014, f. 290.

¹¹⁹ Iseni, 2009, f. 8.

¹²⁰ Mehmeti, Jeton, "Faith and Politics in Kosovo: The Status of Religious Communities in a Secular Country," in *The Revival of Islam in the Balkans: From Identity to Religiosity*, ed. Arolda Elbasani and Olivier Roy, New York: Palgrave Macmillan, 2015, f. 68.

¹²¹ Blumi, "Religion and Politics among Albanians of Southeastern Europe," 2014, f. 291.

bashkuan BRDIA-s në vitin 1984, ndërsa në vitin 1998 anëtarësia e saj u rrit në 100,000 anëtarë.¹²² Një ringjallje e tillë e Sufizmit popullor mes viteve 1970 dhe 1980, sipas Duijzings ishte “një shembull i antagonizmit klasik në mes të islamit tradicional dhe rendit Sufi jo-traditional.” Përveç kësaj, ky antagonizëm përmbante edhe një dimension kombëtar – dimension i cili lidhet me armiqtë në mes të *sheikëve* shqiptare dhe Bashkësisë Islame të Jugosllavisë që dominohej nga muslimanët boshnjakë.¹²³ Për më tepër, ndërtimi i Sufizmit popullor si një formë e veçantë e Islamit shqiptar ka kontribuar edhe në përmirësimin e përgjithshëm të identitetit kombëtar shqiptar në Kosovë. Rrjedhimisht një proces i tillë ka përfshirë atë që Merdjanova e quan “një strategji e dyfishtë e diferencimit etnik-fetar përballë institucioneve politike të dominuar nga njëra anë nga serbët ortodoksë, dhe në anën tjetër nga muslimanët boshnjakë, që flisnin gjuhën serbo-kroate.”¹²⁴

Nuk është për t'u habitur atëherë, që pikërisht rendi Sufi i cili për shekuj kishte përfaqësuar themelin e shoqërisë shqiptare të Kosovës, të ishte shënjestra kryesore e regjimit të Millosheviqit gjatë luftës në Kosovë. Natyrisht, regjimi nationalist serb ishte i etur që të eliminonte njëherë e përgjithmonë bashkësinë sufiste në Kosovë, e cila luajti një rol vendimtar në ruajtjen e rezistencës së shoqërisë rurale të Kosovës ndaj hegjemonisë së Beogradit. Prandaj, xhamitë dhe medresetë e tyre të vjetra shekullore ishin shkatërruar, ndërsa *shehët* Sufi ishin eliminuar në mënyrë të pamëshirshme.¹²⁵ Duhet të përmendet se gjatë luftës së viteve 1998-1999 ndikimi i sheikëve Sufi dhe teqeve të tyre në shoqërinë rurale ka qenë shumë i rëndësishëm për qëndrimin “anti-islamik” të shqiptarëve. Në të vërtetë, pavarësisht nga vrasjet, masakrat dhe shkatërrimin e madh (sidomos të objekteve fetare muslimane) përgjatë tërë konfliktit, duket se menjëherë pas përfundimit të luftës feja kishte mbetur relativisht e marginalizuar në mesin e shqiptarëve të Kosovës. Një sondazh i autorizuar nga Forcat e Kosovës (KFOR) dhe i kryer nga organizata Gallup ka konstatuar se shqiptarët e Kosovës ishin fetarë në masë të moderuar, me vetëm 5.8 për qind të shqiptarëve të Kosovës të cilët ndiqnin rregullisht ceremonitë fetare si faljen e të premtës (xhumanë) apo meshën e të dielës (për katolikët). Rreth 12.2 për qind e të tjerëve janë përgjigjur se

¹²² Duhet të përmendet se BRDIA në vitin 1977 ishte njohur nga autoritet jugosllave si një bashkësi e pavarur fetare, për kundër kundërshtimeve nga lidërsi i islamit në Sarajevë; shih Blumi, Isa, "Albanians' Islam[s]," in *Handbook for European Islam*, ed. Jocelyne Caesari, New York: Oxford University Press, 2014, pf. 485-486.

¹²³ Duijzings, 2000, f. 107.

¹²⁴ Merdjanova, 2013, f. 44.

¹²⁵ Sipas Blumit, udhëheqësit e rendit sufi ishin shënjestra kryesore e forcave serbe që nga fillimi i ofensivës në korrik të vitit 1998. Si rezultat, udhëheqësi shumë i rëndësishëm i komunitetit Dervish dhe shehu i Teqesë Helveti në Rahovec, Sheh Mujedini, ishte vrarë nga policia serbe gjatë kohës sa ishte duke u falur; shih Blumi, "Religion and Politics among Albanians of Southeastern Europe," 2014, f. 292.

kanë ndjekur ceremoni të tilla disa herë në muaj, ndërsa 28.9 për qind e të tjerëve kanë praktikuar ceremonitë e tilla vetëm disa herë në vit.¹²⁶

Megjithatë, ashtu siç do të shihet më poshtë, edhe pse me vonesë për shkak të periudhës dhjetë vjeçare të luftës për çlirim, Kosova shumë shpejtë do të përjetojë një rizgjim shpirtëror, në veçanti të Islamit, njëjtë sikurse kishte ndodhur edhe me shumë shtete të tjera post-komuniste. Shkaqet për një ringjallje të tillë të religjiozitetit në Kosovë kanë qenë të brendshme por edhe të jashtme. Përbrenda, rilindja e religjionit ishte një proces i pritshëm për shkak se vendi kishte kaluar shumë dekada nën komunizmin ateist. Rënia e komunizmit ka shkaktuar në mënyrë të pashmangshme një proces të transformimit radikal dhe përcaktimit të ri të vendit të religjionit në të gjitha vendet ish-komuniste, përfshirë edhe Ballkanin. Prania si e Islamit ashtu edhe e Krishterimit u bë e dukshme dhe e theksuar në të gjitha sferat publike, duke filluar nga jeta personale e deri tek shoqëria në përgjithësi, përfshirë këtu edhe jetën politikën. Në të njëjtën kohë, bashkësitë fetare përfituan mundësi të reja për revitalizim fetar dhe kulturor si dhe për mobilizim politik.¹²⁷ Në nivelin personal, shumë njerëz nga vendet e Ballkanit, duke qenë të përballur me krizën e rëndë politike, konfliktin si dhe pasigurinë e përhershme shoqërore dhe ekonomike, vendosën të kthehen kah religjioni.¹²⁸

Në Kosovë, procesi i rizgimit fetar pas vitit 1999 erdhi si rezultat i shumë faktorëve të brendshëm ndërveprues. Pasojat e luftës krijuan kushte të shumëfishta të cilat ndërvepronin në vitet e para pas 1999, gjë që krijoi një bazë të frytshme për rritjen e religjionit në shoqëri. Fillimisht, çorientimi shoqëror, varfëria e lartë, ekonomia e dobët dhe zbrazëtia politike e kishin bërë Kosovën një tokë pjellore për ringjalljen e religjionit.¹²⁹ Menjëherë pas luftës, gjendja në Kosovë ishte kaotike, ndërsa administrata publike pothuajse nuk ekzistonte fare. E tërë shoqëria kosovare u ekspozua në mënyrë të shpejtë me ide nga më të ndryshmet, si nga ato më liberale deri tek ato më konservative. Popullsia e Kosovës e shkatërruar nga lufta u ekspozua ndaj organizatave të ndryshme ndërkombëtare me bazë fetare, të cilat pas luftës u shfaqën si kërpudha nëpër tërë vendin. Nën maskën e ndihmës humanitare, organizata të tilla kanë shfrytëzuar pa mëshirë varfërinë dhe kushtet e skajshme sociale të shqiptarëve të Kosovës, sidomos në zonat rurale, duke ndërprerë në mënyrë serioze hegjemoninë kulturore të këtyre komuniteteve.¹³⁰ Për më tepër, UNMIK-u dhe bashkësia ndërkombëtare në përgjithësi ishin tepër të zënë me çështje humanitare dhe ndër-

¹²⁶ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, "Religjioni në Kosovë," *ICG Balkans Report* N° 105, Prishtinë/Bruksel, 31 Janar 2001, f. 2.

¹²⁷ Merdjanova, 2013, f. xiv.

¹²⁸ Blumi, "Albanians' Islam[s]," 2014, f. 493.

¹²⁹ Kursani, Shpend, "Raport për shkaqet dhe pasojat e përfshirjes së qytetarëve të Kosovës si luftëtarë të huaj në Siri dhe Irak," Qendra Kosovare për Studimet e Sigurisë, prill 2015, f. 59.

¹³⁰ Blumi, 2005, f. 2.

etnike, dhe prandaj i kushtuan fare pak ose aspak vëmendje veprimtarive të organizatave të ndryshme humanitare, të cilat ishin me bazë fetare. Njëjtë, duke qenë se nuk kishte asnjë strukturë të besueshme inteligjente apo kontrollim të transaksioneve financiare, në këtë periudhë ka qenë e vështirë të ndiqen aktivitetet e organizatave të tilla.

Për më tepër, gjatë kësaj periudhe, ndryshimet demokratike mundësuan zhvillimin e lidhjeve të reja në mes të Kosovës dhe pjesës tjetër të botës myslimane, duke favorizuar ripërtëritjen e veprimtarive të ndryshme fetare. Publikuesve të ndryshëm iu dha mundësia për përkthimin, shtypjen dhe shpërndarjen e literaturës fetare islame nëpër tërë Kosovën. U hapën xhamia dhe shkolla të reja fetare, lëvizje të ndryshme për re-islamizim filluan të veprojnë nëpër tërë Kosovën, ndërsa studentët e Kosovës filluan me të madhe të ndjekin studimet e tyre në universitete të ndryshme islame në botën Myslimane.¹³¹ Të gjithë këta faktorë pa dyshim kanë kontribuar në rizgjimin e islamit dhe në përhapjen masive të tij në mesin e shqiptarëve të Kosovës. Më e rëndësishmja, modeli i Islamit të Shqiptarëve të Kosovës, një model unik tradicional që më parë ishte i padiskutueshëm, dalëngadalë filloi të ndryshojë pas luftës.

Në anën tjetër, me rënien e komunizmit, Bashkësia Islame e Kosovës gjithashtu filloi të rindërtojë institucionet e veta dhe infrastrukturën shoqërore. Para luftës, diku 560 xhami ishin të regjistruara në Bashkësinë Islame të Kosovës. Bashkësia Islame e Kosovës gjithashtu e administronte edhe Medresenë "Alaudin", e cila qysh prej hapjes së saj në vitin 1951 ka shërbyer si një shkollë e mesme profesionale, duke nxjerrë diku 2,000 nxënës të diplomuar. Në vitin 1992 u hap edhe Fakulteti i Shkencave Islame, i cili gradualisht u shndërrua në një qendër të rëndësishme të jetës religjioze myslimane.¹³²

Gjatë luftës, shumë objekte Islame, përfshirë edhe bibliotekat dhe arkivat islame ishin shkatërruar nga forcat serbe. Në mes tjerash, ishin shkatërruar edhe 218 xhami, shtëpitë e 302 imamëve, ndërsa 16 imamë ishin vrarë dhe 15 ishin të zhdukur apo të burgosur. Objektet e Sufive dhe shkollat islame, duke përfshirë edhe të gjitha arkivat dhe bibliotekat e tyre ishin vënë në shënjestër. Teqeja Bektashiane në Gjakovë, që është më e madhja dhe më e vjetra në Kosovë, ishte djegur së bashku me 2.000 libra të rrallë dhe 250 dorëshkrime nga biblioteka e saj.¹³³

Pas luftës, Bashkësia Islame e Kosovës bëri disa përpjekje për të përmirësuar rolin e saj në jetën politike dhe shoqërore në vend. Ndër tjera, u përpoq që të rris praninë e islamit në hapësirën publike dhe jetës shoqërore të pasluftës në Kosovë me anë të

¹³¹ Bougarel, Xavier, "The New Balkan Islam," *Regional Issues*, ISIM Newsletter, No.6, 2000, f. 32.

¹³² Merdjanova, 2013, f. 44.

¹³³ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, "Religjioni në Kosovë," 2001, f. 14.

revitalizimit dhe zgjerimit të rrjetit të xhamive dhe organizatave të tjera religjioze. Rrjedhimisht, prej vitit 1999 BIK-u, me anë të kanaleve të ndryshme të financimit, ka rindërtuar 113 xhami të dëmtuara nga lufta dhe ka ndërtuar edhe 175 xhami të tjera të reja.¹³⁴ Aktualisht, bashkësia Islame vepron nëpërmjet infrastrukturës së vet të pavarur organizative dhe administrative në pajtim me kushtetutën e vet. Kuvendi i saj, i cili përbëhet nga 27 deputetë, zgjedh kreun e BIK-ut, i cili shërben gjithashtu edhe si myfti. Nëpërmjet sistemit të vet hierarkik, i cili përbëhet nga 26 këshilla lokale, BIK-u menaxhon të gjitha detyrat religjioze në Kosovë, përfshirë edhe mbikëqyrjen e përafërsisht 660 xhamive. Për më tepër, BIK-u ka departamentet e ndara për publikime, gra, rini dhe donacione të bamirësisë.¹³⁵

Pas luftës, Fakulteti i Shkencave Islame ka vazhduar të promovojë një islam tradicional dhe ka arritur të tërheq studentë shqiptarë nga Kosova dhe pjesë të tjera të Ballkanit. Edhe pse statusi ligjor i bashkësive fetare nuk është i rregulluar mirë në Kosovë, diplomat e këtij fakulteti pranohen dhe njihen nga Ministria e Arsimit të Kosovës. Megjithatë, në aspektin e programit mësimor, me përjashtim të gjuhës arabe dhe disa lëndëve të filozofisë islame, nga ky fakultet ofrohen vetëm lëndë nga disiplinat tradicionale islame dhe recitime të Kuranit. Një realitet i tillë e ka bërë këtë fakultet një ndër fakultetet më pak të hapura ndaj lëndëve jo-fetare në krahasim me të gjitha fakultetet e shkencave islame në Ballkan.¹³⁶ Është mjaft interesante se, kurrikula e tij nuk përmban asnjë lëndë në lidhje me historinë kombëtare të shqiptarëve. Nëse gjatë viteve të 1990ta, fakulteti ka promovuar një islam tradicional me një theks të veçantë në përkatësinë kombëtare shqiptare, ai gradualisht e ka marginalizuar kombësinë në favor të vlerave fetare.¹³⁷ Për më tepër, mungesa e ndonjë lënde që lidhet me historinë e popullit shqipëtar paraqet një pjesë të mohimit të vazhdueshëm nga ana e Bashkësisë Islame të Kosovës në lidhje me të kaluarën, veçanërisht të kaluarës së krishterë. Është pikërisht mohimi i tillë i së kaluarës që refuzon të njohë rrënjët historike shqiptare të krishtera që shpesh ndez jo-tolerancën ndër-fetare dhe radikalizmin.

Nga jashtë, ringjallja e Islamit në Kosovë është ndikuar kryesisht nga Arabia Saudite dhe shtetet e tjera të Gjirit Persik, nga njëra anë, dhe Turqia, në anën tjetër. Siç është shpjeguar tashmë, pas luftës, organizata të shumta dhe të ndryshme ndërkombëtare me bazë fetare janë përhapur në vend, të fshehura nën maskën e shpërndarjes së ndihmave humanitare. Prej tyre më "aktivet" kanë qenë grupet e ndryshme arabe të bamirësisë, sidomos ato që vinin nga Arabia Saudite. Organizatat e Arabisë Saudite të cilat vepronin nën ombrellën e Komitetit të Përbashkët Saudit për Ndihmë Kosovës dhe Çeçenisë (KPNKÇ) nuk ishin të interesuara në rindërtimin e praktikave vendore "jo-

¹³⁴ Blumi, "Albanians' Islam[s]," 2014, f. 504.

¹³⁵ Mehmeti, 2015, f. 77.

¹³⁶ Blumi, "Albanians' Islam[s]," 2014, f. 502.

¹³⁷ "Planprogrami i Studimeve Islame," Fakulteti i Shkencave Islame, Prishtinë, 2016.

tradicionale" të Islamit në Kosovë. Përkundrazi, ato promovuan një islam universal në një formë të *salafizmit (vahabizmit)* agresiv. Qëllimi i tyre parësor ishte kontrollimi i jetës shpirtërore të popullsisë, politizimi i islamit dhe inkurajimi i mos-tolerancës ndaj sekularizmit dhe pluralitetit fetar në Kosovë. Me pak fjalë, qëllimi i tyre ishte të bëhej transformimi i lidhjes tradicionale-kulturore të shqiptarëve ndaj religjionit, duke futur një Islam politik dhe konservator. Nuk është për t'u çuditur atëherë, që rendet tradicionale heterodokse sufiste në komunitetet rurale ishin një nga shënjestrat kryesore të këtyre organizatave. Një islam i tillë "i ri" kishte për qëllim të zhdukte trashëgiminë e gjatë gjatë shekullorë osmane, duke braktisur praktikën pluraliste dhe liberale të Islamit shqiptar. Për më tepër, ai u përpoq të dobësonte ndjenjën kombëtare shqiptare të bazuar në gjuhën dhe qëndrimin pro-perëndimor, i cili ishte dominues në Kosovë, duke fuqizuar solidaritetin mysliman në mesin e shqiptarëve.¹³⁸

Rrjedhimisht, ata i dedikuan të gjitha paratë e tyre në themelimin e xhamive dhe shkollave, të cilat kishin për qëllim promovimin e një islami më tepër universal se sa lokal. Gjatë restaurimit, këto organizata shkatërruan xhamitë me arkitekturë osmane në mënyrë që të rindërtonin xhamitë sipas stilit të tyre arab. Vlerësohet se agjencitë e ndihmave me bazë fetare nga Lindja e Mesme kanë investuar rreth 800 milion dollarë në Kosovë dhe atë kryesisht në zonat rurale.¹³⁹ Këto organizata jo vetëm që e kanë monopolizuar sigurimin e artikujve ushqimorë dhe shëndetësor për popullatën e varfër shqiptare të Kosovës, por gjithashtu kanë ofruar edhe mësim fetar për fëmijët e Kosovës. Fondacioni Bamirës Islamik (IEF) i cili vepron nën ombrellën e KPNKÇ-së ka pranuar se ka mbështetur ndërtimin e më shumë se 30 shkollave të specializuara kuranike në zonat rurale të Kosovës prej vitit 1999.¹⁴⁰ Duke pasur burime të mëdha financiare në dispozicion, këto organizata të Arabisë Saudite kanë inkurajuar gjithashtu edhe trajnimin e imamëve të rinj shqiptarë në frymën neo-salafiste në universitet saudite, dhe atë kryesisht në Medinë. Për më tepër, ata kanë përkthyer në gjuhën shqipe libra fetarë që nga përmbajtja janë më të afërta me versionin e tyre të islamit dhe i kanë shpërndarë ato falas në gjithë vendin. Është e qartë se një investim i tillë substancial ka pasur për qëllim që të ndryshojë perceptimin e islamit në mesin e bashkësisë myslimane të shqiptarëve të Kosovës, ndërsa në të njëjtën kohë është bërë përpjekje që të merren nën kontroll edhe institucionet islame në vend.¹⁴¹ Për fat të keq, edhe pse Bashkësia Islame e Kosovës ishte e vetëdijshme se një ndihmë e tillë kishte prapavijë ideologjike dhe politike, ajo e pati të vështirë të garante me ndikimin e këtyre fondeve dhe bamirësive të mëdha trans-nacionale islame me potencë të jashtëzakonshme financiare.¹⁴²

¹³⁸ Iseni, 2009, f. 10.

¹³⁹ Blumi, "Albanians' Islam[s]," 2014, f. 488.

¹⁴⁰ Blumi, 2005, f. 15.

¹⁴¹ Iseni, 2009, f. 10.

¹⁴² Merdjanova, 2013, f. 68.

Megjithatë, këto aktivitete agresive dhe radikale të shfaqura publikisht nuk kanë kaluar pa u vënë re në Kosovë. Paralajmërimet e para në lidhje me infiltrimin e aktiviteteve fundamentaliste në Kosovë kanë ardhur qysh në fillim të muajit dhjetor të vitit 1999 nga Agjencia e Lajmeve “Kosovapress” e cila ishte e themeluar nga UÇK-ja. Në një deklaratë shumë kritike agjensioni kishte tërhequr vërejtjen se “Për më shumë se një shekull, vendet e civilizuar e kanë ndarë religjionin nga shteti... [Megjithatë,] tani ne jemi duke parë përpjekje jo vetëm në Kosovë, por kudo ku jetojnë shqiptarët, që të prezantohet feja në shkollat publike ... Organizata të huaja islamike po mbajnë kurse plotësuese për fëmijët, duke u fshehur prapa programeve për ofrimin e ndihmave... Është koha që xhamitë shqiptare të ndahen nga lidhjet arabe...”¹⁴³ Në mënyrë të ngjashme, edhe kreu i Bashkësisë Islame të Kosovës, Rexhep Boja, i ishte përgjigjur me zemërim sjelljes së agjencive saudite ultra-ortodokse, duke vënë në dukje se “Shqiptarët kanë qenë myslimanë për më shumë se 500 vjet dhe ata nuk kanë nevojë për të huajt [arabët] për t’ju treguar atyre se cilat janë mënyrat e duhura për të praktikuar Islamin.”¹⁴⁴ Aktivitetet radikale publike të organizatave saudite në masë të madhe u dënuan nga elitat politike sekulare të shqiptarëve të Kosovës, komunitetet fetare si dhe nga mediat dhe intelektualët e Kosovës. Numri i madh i xhamive të ndërtuara me paratë e organizatave ndërkombëtare islamike shihej nga politikanët e Kosovës dhe qytetarët si i dëmshëm ndaj vizionit të tyre për një identitet modern shqiptar që është kryesisht “evropian” dhe “perëndimor”.

Në veçanti pas sulmeve të 11 shtatorit 2001 në SHBA, rritja e jashtëzakonshme e diskursit "anti-islamik" në Evropë dhe SHBA pati një ndikim të dukshëm edhe mbi shqiptarët e Kosovës. Prandaj, çdo veprim që vinte nga rrjete të jashtme radikale të Arabisë Saudite u shikua nga ana e elitës politike dhe intelektuale kosovare si një sulm i drejtpërdrejtë në vizionin e tyre politik pro-evropian dhe pro-perëndimor.¹⁴⁵ Sikurse në vendet e tjera të Ballkanit, edhe Kosova u angazhua në mënyrë aktive në dëbimin e individëve dhe mbylljen e organizatave të dyshuara të cilat promovonin radikalizmin islamik dhe të cilat ishin konsideruar se përbënin një kërcënim për sigurinë kombëtare të vendit.¹⁴⁶ Si rezultat, këto veprimtari të grupeve saudite, të cilat në fillim ishin shumë publike, u shndërruan në aktivitete të fshehta. Duke pasur parasysh faktin se ishin ekspozuar ndaj kritikave të mëdha nga të gjitha segmentet e shoqërisë kosovare, ata adoptuan një qasje shumë më të kujdesshme dhe në heshtje i zhvendosën veprimtaritë e tyre në pjesët e varfra rurale të Kosovës. Në vend se të synonin tërë shoqërinë kosovare, ata sikur u zhdukën nga radari i elitës dhe u fokusuan kryesisht tek një

¹⁴³ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, “Religjioni në Kosovë,” 2001, f. 6.

¹⁴⁴ Deliso, Christopher, *The Coming Balkan Caliphate: The Threat of Radical Islam to Europe and the West*, Westport and London: Praeger Security International, 2007, f. 55.

¹⁴⁵ Blumi, "Albanians' Islam[s]," 2014, f. 509.

¹⁴⁶ Merdjanova, 2013, f. 70.

segment i shoqërisë kosovare që përfshinte të papunët, të varfrit dhe marginalizuarit.¹⁴⁷ Sido që të jetë, ashtu siç do të shohim në kapitullin vijues, këto rrjete të Vahabizimit, do të rishfaqen shumë shpejtë dhe në mënyrë më agresive në skenën e Kosovës, pasi fillimisht t'i kishin përforcuar themelet e tyre, duke krijuar një rol të heshtur në mesin e popullatës rurale të Kosovës, e cila ishte tjetërsuar në aspektin politik, ekonomik dhe atë social.

Turqia, në anën tjetër, gjithnjë ka shërbyer si një model për myslimanët që jetonin në Ballkan. Deri në fund të shekullit XIX, Perandoria Osmane për më shumë se katër shekuj kishte sunduar mbi këtë rajon, padyshim duke i dhënë formë edhe terrenit fetar. Qysh atëherë, për shkak të afërsisë gjeografike, lidhjeve historike si dhe afiniteteve fetare dhe kulturore, Turqia ka qenë tradicionalisht në gjendje të ushtrijë ndikimin e saj të fortë mbi myslimanët lokalë të Ballkanit. Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, qasja e Turqisë te këto popullësi myslimane u bë më e lehtë se kurrë më parë.¹⁴⁸ Megjithatë, deri në fund të viteve të 90-ta prania e Turqisë në rajon ka qenë kryesisht e fokusuar në domenin e politikave zyrtare, të cilat kufizoheshin në masë të madhe nga një opinion sekular dhe kemalist fetar të Republikës së Turqisë. Politika zyrtare e jashtme ka qenë kryesisht e pozicionuar në kontekstin e organizatave ndërkombëtare, ndërsa përfaqësuesit diplomatikë të vendit kanë ndër-vepruar vetëm me agjencitë shtetërore apo organizatat kombëtare turke, të cilat veprimtaritë e tyre i ushtronin kryesisht në një platformë nacionaliste pan-turke. Rritja e ndikimit fetar të Turqisë në rajon korrespondon në mënyrë të drejtpërdrejtë me zhvillimet e brendshme politike dhe ideologjike, të cilat kanë rezultuar në një paradigmë të re të politikës së jashtme. Veçanërisht në këtë drejtim është i rëndësishëm përcaktimi i ri vlerave të Islamit si pikë kyçe referimi në identitetin kombëtar turk.¹⁴⁹

Fillimisht ka qenë Turgut Özal, ish Kryeministër dhe President, i cili kishte iniciuar një ndryshim duke u larguar nga izolimi kemalist drejt një qasjeje më historike dhe më pro-osmane. Ismail Cem, Ministri i Punëve të Jashtme të Turqisë në fund të viteve të 1990ta dhe në fillim të viteve të 2000ta, shkoi një hap më tutje në qasjen e tij, duke insistuar se “nëse Turqia dëshiron të bëhet një vend i rëndësishëm në botë, së pari duhet të përballet me të kaluarën e saj, si një fuqi perandorake duke u angazhuar me vendet e afërta fqinje.”¹⁵⁰ Rrjedhimisht, trashëgimia osmane, më parë e injoruar dhe për më tepër edhe e refuzuar nga elita politike sekulare kemaliste, u artikulua rishtas duke u kthyer

¹⁴⁷ Shiko: Blumi, "Religjioni dhe Politika në mesin e shqiptarëve të Evropës Juglindore," 2014, f. 294.

¹⁴⁸ Merdjanova, 2013, f. 76.

¹⁴⁹ Öktem, Kerem, "New Islamic actors after the Wahhabi intermezzo: Turkey's return to the Muslim Balkans," studim i prezantuar në Konferencën "After the Wahhabi Mirage: Islam, Politics, and International Networks in the Balkans," Qendra për Studime Evropiane, Universiteti i Oxfordit, qershor 2010, f. 22.

¹⁵⁰ Öktem, 2010, f. 23.

në një mjet komunikimi për rivlerësimin e historisë së rajonit. Perandoria Osmane u ri-konceptualizua në një model i një entiteti pluralist multi-etnik dhe multi-fetar. Një imazh i tillë më pas u vu në lëvizje nëpërmjet diskurseve publike vendore dhe rajonale për t'i shërbyer nevojave të reja politike.¹⁵¹ Kur Partia Islame e Drejtësisë dhe Zhvillim erdhi në pushtet në vitin 2002, ajo shumë shpejt zgjeroi ndikimin e saj edhe në gjithë rajonin. Në të njëjtën kohë Perandoria Osmane, trashëgimitë dhe partnerët fetarë në bashkësitë myslimane, u pranuan si legjitime. Përmes një bashkëpunimi të afërt me rrjetet fetare dhe organizata bamirëse nga Turqia, Ministri i Punëve të Jashtme Ahmet Davutoğlu prezantoi një politikë të re, e cila arriti të depërtojë në mikro-nivelin e organizatave të bashkësive dhe nivelet bazike të politikës.¹⁵² Si rezultat i kësaj, gjatë dekadës së fundit Turqia është bërë "akteri me ndikimin më të lartë mysliman në Evropën Juglindore, si në aspektin e politikës së jashtme, ashtu edhe në atë të politikës së ulët formale të rrjeteve dhe vëllazërive fetare."¹⁵³

Kosova tradicionalisht ka pasur lidhje të afërta me Turqinë, në veçanti në nivelin familjar dhe atë individual. Ashtu siç është përmendur më herët, dhjetëra mijëra shqiptarë myslimanë janë shpërngulur në Turqi, duke u bërë pjesë e emigrimit të dhunshëm si gjatë kohës së Mbretërisë Jugosllave ashtu edhe gjatë asaj socialiste. Prej atëherë, shumica e shqiptarëve të Kosovës kanë mbajtur kontakte të ngushta me anëtarët e tyre të familjes të cilët jetojnë në Turqi. Pas rënies së komunizmit, roli i Turqisë në tërë Ballkanin është përhapur në masë të madhe, si nëpërmjet agjencive formale të qeverisë ashtu edhe nëpërmjet rrjeteve islamike turke. Në të njëjtën mënyrë, qysh prej vitit 1999, Kosova ka themeluar një marrëdhënie shumë të mirë me Turqinë, duke bërë përpjekje që të ruaj një model të islamit të ngjashëm me atë të Turqisë sekulare. Duhet të përmendet se kanë ekzistuar katër fusha të rëndësishme të veçantë nëpërmjet të cilave Turqia ka vendosur ndikimin e saj politik dhe fetar në Kosovë dhe tërë rajonin e Ballkanit: (1) Agjencia për Zhvillim e Turqisë (*TIKA*); (2) Kryesia për Çështje Fetare e Turqisë (*Diyanet*); (3) rrjetet politike dhe intelektuale rreth Ahmet Davutoğlu; dhe (4) organizatat me bazë islamike, siç janë Lëvizja Gülen dhe Vëllazëria Myslimane.¹⁵⁴

E themeluar nën Presidencën e Turgut Özal, si një instrument i politikës së jashtme proaktive, TIKA qysh prej fillimit ka mbështetur projekte të ndryshme në Ballkan të cilat ndikuan në rritjen e bashkëpunimit kulturor. Në Kosovë ajo ka bërë restaurimin e disa xhamive dhe monumenteve të cilat ndërlihen me sundimin osman e të cilat ishin shkatërruar gjatë kohës së luftës.¹⁵⁵ Për më tepër, ajo ka mbështetur më shumë se 400

¹⁵¹ Merdjanova, 2013, f. 77.

¹⁵² Öktem, 2010, f. 23.

¹⁵³ Merdjanova, 2013, f. 76.

¹⁵⁴ Fazlic, Hasim, "Islam in the successor states of Former Yugoslavia - Religious changes in the post-communist Balkans from 1989-2009," PhD Thesis, University of Birmingham, 2011, f. 170.

¹⁵⁵ Merdjanova, 2013, f. 78.

projekte në fushën e shëndetësisë, bujqësisë dhe arsimit. Mes tjerash, spitalet dhe klinikat e drejtuara nga turqit dhe të sponsoruara nga TIKa kanë ofruar shërbime me çmime të arsyeshme për qytetarët e Kosovës.¹⁵⁶ Në anën tjetër, Kryesia e Çështjeve Fetare përfaqëson organin qeverisës përgjegjës për punët fetare të popullsisë me shumicë myslimane, me mandatin “për të kryer të gjitha punët fetare në lidhje me besimin, adhurimin dhe parimet e moralit, për të informuar shoqërinë në lidhje me religjionin dhe për të administruar vendet e adhurimit”¹⁵⁷ Duke pasur rreth 80,000 të punësuar dhe një buxhet të lartë, *Diyanet* është organizata më e madhe dhe më e centralizuar religjioze myslimane në botë. Përveç që ka mbështetur rikonstruktimin e xhamive në Kosovë, si një udhëheqëse simbolike e bashkësive islame në Ballkan, *Diyanet* kryesisht ka mbështetur infrastrukturën dhe ndërtimin e kapaciteteve të bashkësive zyrtare islame. Përveç organizmit të seminareve dhe kurseve për zyrtarët dhe stafin mësimdhënës pranë institucioneve fetare, *Diyanet* gjithashtu bënë organizimin dhe është nikoqire e Këshillit Euro-Aziatik dhe Këshillit Ballkanik.¹⁵⁸

Megjithatë, trashëgimia më e rëndësishme e ndikimit turk ndërlidhet me aktivitetet edukativo-arsimore. Ndër tjera, veprimtaritë e tilla kanë përfshirë bursa studimi për teologjinë islame pranë universiteteve turke, mbështetjen financiare të shkollave lokale fetare si dhe përkthimin dhe shpërndarjen e literaturës fetare.¹⁵⁹ Shuma e përgjithshme e ndihmave turke për kombet që më parë kanë qenë nën sundimin e Perandorisë Osmane është rritur në mënyrë të vazhdueshme prej 85 milion dollarë amerikanë në vitin 2002 në 967 milion dollarë amerikanë në vitin 2010, duke arritur shumën e përgjithshme të ndihmave për këtë periudhë në 5 miliardë dollarë amerikanë.¹⁶⁰ Vetëm në shtetet trashëgimtare të ish-Jugosllavisë, *Diyanet* çdo vit ka dhënë bursa të plota për afërsisht 400 studentë për të studiuar lëndët fetare në Turqi. Ndërkaq, numri i përgjithshëm i bursave të tilla për të gjithë rajonin, duke përfshirë Bullgarinë, Rumaninë, Shqipërinë dhe Greqinë është më i madh se 1000.¹⁶¹ Në Kosovë numri i bursave të tilla ka qenë 195, ndërsa me anë të “Projektit të Madh Studentor” të Minsitrisë së Arsimit, edhe rreth 100 studentë të tjerë çdo vit pranohen që të studiojnë në universitet e Turqisë.¹⁶² Përveç kësaj, një numër i caktuar i institucioneve arsimore, të iniciuara dhe mbështetura bujarisht nga rrjetet neo-sufiste turke, janë vendosur në Ballkan. Forca shtytëse prapa rrjeteve të të gjithë këtyre biznesmenëve-intelektualëve erdhi nga

¹⁵⁶ Philips, David, “Turkey’s Islamist Agenda in Kosovo,” *The World Post*, 29 December 2015; http://www.huffingtonpost.com/david-l-phillips/turkeys-islamist-agenda-i_b_8891634.html (20.05.2016).

¹⁵⁷ Për më shumë detaje në lidhje me mandatin dhe aktivitetet e *Diyanet-it* shiko: <http://www.diyamet.gov.tr> (20.05.2016).

¹⁵⁸ Fazlic, 2011, f. 172.

¹⁵⁹ Duhet përmendur se botimet e Fondacionit Diyanet kryesisht përfshijnë manuale hyrëse mbi doktrinën dhe praktikën, të adaptura kryesisht për fëmijët, të prodhuara në cilësi të lartë islame, të ilustruara shumë mirë dhe të përkthyer dhe të rishikuara nga studiues të shquar fetarë; shih Öktem, 2010, f. 33.

¹⁶⁰ Për më shumë detaje shih Merdjanova, 2013, pf. 78-79.

¹⁶¹ Fazlic, 2011, f. 172.

¹⁶² Öktem, 2010, f. 33.

lëvizjet neo-sufiste të Turqisë “Suleymanc dhe Nurcu”. Ata kanë themeluar disa kolegje sekulare në të cilat mijëra studentë nga i tërë Ballkani kanë mundësi të ndjekin programet e tyre arsimore. Mirëpo, duhet theksuar se aktivitetet e tyre përfshijnë edhe mësimin fetar, me anë të leximit dhe recitimit të Kuranit. Padyshim, organizata më aktive në rajon ka qenë Lëvizja Gülen – si një rrjet global i shkollave fillore dhe të mesme, universiteteve, organizatave bamirëse, stacioneve radio-televizive, gazetave, grupeve lobuese dhe iniciativave afariste – të frymëzuara nga mësimet e Fethullah Gülenit, një teolog dhe veprimtar turk.¹⁶³

Situata e transformuar gjeopolitike dhe rritja e shqetësimeve të sigurisë pas ngjarjeve të 11 Shtatorit, e kanë lehtësuar edhe më tepër përhapjen e ndikimit të aktorëve islamikë turk në rajon. Nga njëra anë, rrjedha e fondeve dhe aktorëve nga bota arabe në rajonin e Ballkanit ka rënë për shkak të kontrollimit të intensifikuar të aktiviteteve islame nga ana e shteteve përkatëse. Nga ana tjetër, vendet perëndimore, veçanërisht SHBA-të, e kanë parë Islamin “e moderuar” të Turqisë në Ballkan si një kundërpeshë ndaj ndikimeve të mundshme “radikale” të vendeve arabe.¹⁶⁴ Për më tepër, qasja turke në Ballkan ka qenë shumë më ndryshe nga ajo e organizatave vahabiste. Organizatat nga Arabia Saudite dhe vendet e tjera të Gjirit Persik kanë kundërshtuar institucionet vendore islame dhe praktikat tradicionale, duke imponuar një islam të huaj në Ballkan. Në anën tjetër, organizatat turke, në veçanti agjencitë qeveritare, i kanë mbështetur bashkësitë ekzistuese islame dhe kanë fuqizuar infrastrukturën e tyre me anë të disa iniciativave. Prandaj, Turqia kohët e fundit është shikuar jo vetëm si “një komb sekular mysliman”, por edhe si “një lojtar i moderuar islamik”, që mund të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të Islamit të moderuar në rajon.¹⁶⁵ Duke marrë parasysh lidhjet e përbashkëta historike fetare dhe kulturore, aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë të Turqisë në Ballkan janë mirëpritur si nga bashkësia ndërkombëtare ashtu edhe nga popullata vendore. Në anën tjetër, angazhimi i tyre i gjerë dhe lidhjet e tyre të përforcuara në mes të Turqisë dhe Bashkësive Islame të Ballkanit, kanë kultivuar një identifikim më të ngushtë ndërmjet “Islamit Turk “dhe” Islamit Ballkanik”.¹⁶⁶ Prej vitit 1999 ndikimet e tilla kanë qenë shumë të dukshme në Kosovë dhe kanë kontribuar në masë të madhe në islamizimin e gjerë të Kosovës.

Politikanët, udhëheqësit e bashkësive fetare dhe përfaqësuesit e akademisë, të cilët janë intervistuar si pjesë e këtij hulumtimi, janë pajtuar në thelb me fenomenin e ringjalljes së religjionit, dhe në veçanti islamit, edhe pse për një gjë të tillë ata paraqesin shpjegime të ndryshme në lidhje me faktorët që kanë kontribuar në këtë proces. Për shembull, Agim Çeku pohon se periudha 1999-2008 karakterizohet nga prezenca

¹⁶³ Fazlic, 2011, f. 171.

¹⁶⁴ Merdjanova, 2013, f. 77.

¹⁶⁵ Fazlic, 2011, f. 168.

¹⁶⁶ Merdjanova, 2013, f. 80.

jashtëzakonisht e madhe e administratës ndërkombëtare, në krye me UNMIK-un. Çeku thotë se përbrenda vendit ishin krijuar tensione në mes të dy krahëve të kundërta – krahut paqësor dhe atij të luftës. Një realitet i tillë ka bërë të mundur depërtimin e organizatave nga Lindja, të cilat nën petkun e ndihmave humanitare kanë promovuar agjendat politike në Kosovë. Agjenda kryesore e këtyre organizatave ka qenë imponimi i një islami, i cili ishte ndryshe nga islami tradicional i Kosovës. Për të arritur këtë qëllim, së bashku me aktivitetet humanitare, OJQ-të arabe kanë imponuar elemente fetare si xhamitë, shkollat fetare dhe veshjen e ferexhesë (*hixhabi*). Çeku beson se paralelisht me të gjitha këto aktivitete, këto organizata kanë rekrutuar në mënyrë aktive qytetarët e Kosovës për të promovuar qëllimet e tyre. Mungesa e institucioneve të duhura menjëherë pas luftës, sipas Çekut është një nga arsyet kryesore që ka kontribuar në favor të këtij fenomeni. Nga njëra anë, Kosova nuk kishte institucionet e veta, ndërsa në anën tjetër, UNMIK-u dhe organizatat tjera ndërkombëtare i kanë nënvlerësuar aktivitetet e këtyre organizatave me bazë fetare. Si rezultat i kësaj, gjërat në fillim kanë dalë thjeshtë nga kontrolli. Edhe pse Bashkësia Islame e Kosovës ka paralajmëruar dhe ka apeluar kundër aktiviteteve të OJQ-ve të tilla, nuk ka mundur të arrijë shumë për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe mungesës së kompetencave ligjore. Në të njëjtën kohë, Çeku vlerëson se fakti që sektori i sigurisë së Kosovës ka qenë i dobët poashtu ka kontribuar ndaj një realiteti të tillë.¹⁶⁷ Nga ana tjetër, edhe Albin Kurti pohon se ringjallja e fesë në Kosovë pas luftës është rezultat i faktorëve të ndryshëm. Së pari, ai vë në dukje se gjatë luftës 218 xhami u dogjën dhe u shkatërruan nga forcat serbe. Kjo ishte pjesë e propagandës së Beogradit për të bindur komunitetin ndërkombëtar se nuk ishin vrarë shqiptarët, por myslimanët radikalë. Megjithatë, sipas Kurtit, për herë të parë shqiptarët filluan të mendojnë se ata nuk ishin në shënjestër vetëm si shqiptarë, por edhe si myslimanë. Për Kurtin, ishte normale të kuptohej se veprimet e tilla do të shkaktonin një reagim pas luftës – sepse nëse 218 xhami ishin shkatërruar, të paktën dyfishi i tyre do të rindërtohej. Sipas Kurtit, një faktor i dytë që ka kontribuar në rritjen e religjiozitetit në Kosovë ndërlidhet me administratën ndërkombëtare në Kosovën e pasluftës. Një administratë e tillë erdhi në vend me politika neo-liberale të cilat promovuan materializmin e jetës, individualizmin e jetës, kaosin dhe anarkinë. Si një lloj reaksioni, e për më tepër edhe si një lloj kompensimi, Kurti pretendon se disa qytetarë të Kosovës në mënyrë paradoksale i janë kthyer religjionit dhe kanë filluar të falen. Në fund, Kurti vë në pah se gjithashtu edhe kushtet sociale, siç janë papunësia, padrejtësia dhe korrupsioni, kanë kontribuar në ringjalljen e religjionit në Kosovë. Për më tepër, Kurti beson se humbja e moralit dhe vlerave profesionale, siç janë dija dhe profesionalizmi, kanë ndikuar që Kosovarët të lëvizin drejt vlerave shpirtërore dhe fetare.¹⁶⁸ Në të njëjtën mënyrë edhe Ramush Haradinaj beson se nëse gjatë

¹⁶⁷ Intervistë me Agim Çekun, ish Kryeministër i Republikës së Kosovës, ish ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe anëtar i Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 07 prill 2016.

¹⁶⁸ Intervistë me Albin Kurtin.

Jugosllavisë socialiste religjioni ka ekzistuar vetëm në margjinat e shoqërisë, pas rënies së komunizmit, religjioni është kthyer në Kosovë, si pjesë e identitetit ashtu sikurse ka ndodhur me të gjitha vendet ish-komuniste. Pas vitit 1999, religjioni sipas Haradinajt ka shërbyer si një ngushëllues primar për të zbutur dhimbjet e kosovarëve të përvuajtur gjatë luftës. Gjatë kësaj periudhe, mënyra se si është praktikuar religjioni ishte ndikuar nga trendet globale të shpërndara me anë të internetit dhe lëvizjeve të ndryshme islame që kishin depërtuar në Kosovë.¹⁶⁹

Naim Tërri beson se Bashkësia Islame e Kosovës ka vazhduar bashkëpunimin dhe koordinimin me bashkësitë e tjera fetare, ne veçanti me atë katolike, edhe gjatë periudhës së administratës ndërkombëtare. Edhe për kundër dëmtimeve të infrastrukturës së tyre gjatë kohës së luftës, Tërri deklaroi se BIK-u ka vazhduar të kontribuojë në të mirë të vendit dhe qytetarëve të saj. Megjithatë, përpos mundësive të reja për bashkësitë fetare, periudha e pas luftës sipas Tërri ka sjellë me vete edhe sfida të reja për vendin. Organizata të ndryshme fetare dhe OJQ të cilat kishin ardhur nën ombrellën e organizatave të ndihmave humanitare, ishin përfshirë në shpërndarjen e propagandës fetare si myslimane ashtu edhe të krishterë. Megjithatë, Tërri është i bindur se një propagandë e tillë nuk ka ndikuar në marrëdhëniet e tyre me bashkësinë katolike, dhe se BIK-u i ka vazhduar bashkëpunimin e vet me Ipsihekinë në mënyrë që të mbrohet rinia kosovare nga ndikimet e tilla.¹⁷⁰ Sipas Don Shan Zefit, në anën tjetër, gjatë kësaj periudhe identiteti kombëtar dhe homogjenizimi në mesin e shqiptarëve të Kosovës ka filluar të zbehet gradualisht në krahasim me periudhën 1989-1999. Një gjë e tillë është bërë më tepër e dukshme sidomos disa vite pas përfundimit të luftës, kur edhe filloi të zbehet i tërë entuziazmi në lidhje me çlirimin dhe përmirësimin e kushteve të jetës. Edhe për kundër kësaj, ai pretendon se marrëdhëniet në mesin e bashkësive të ndryshme fetare janë të mira edhe pse niveli i bashkëpunimit mes tyre është zvogëluar gjatë kësaj periudhe. Prapë se prapë, Zefi beson se Bashkësia Islame e Kosovës është dashur të reagojë më fuqishëm kundrejt shenjave të caktuara të radikalizimit në mesin e myslimanëve të Kosovës.¹⁷¹ Pak a shumë njëjtë mendon edhe Driton Krasniqi, i cili vë në pah se gjatë periudhës 1999-2008 Kosova është bërë dëshmitare e shenjave të para të radikalizimit fetar. Teksa sipas tij, shenjat e para të radikalizimit të tillë kanë qenë të dukshme edhe para luftës, kufijtë e hapur dhe poroz të Kosovës pas luftës kanë mundësuar shpërndarjen e misionarëve të shumtë të cilët kanë investuar shuma të mëdha të parave me qëllim të rizgjimit fetar. Gjatë kësaj periudhe, Krasniqi deklaroi se

¹⁶⁹ Intervistë me Ramush Haradinajn, ish Kryeministër i Republikës së Kosovës, Kryetar i Partisë AAK dhe anëtar i Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, mars 2016.

¹⁷⁰ Intervistë me Naim Tërri.

¹⁷¹ Intervistë me Dr. Don Shan Zefin.

afërsisht 400 xhami të reja janë ndërtuar dhe shumë bursa studimi për universitetet e Lindjes janë dhënë.¹⁷²

Xhabir Hamiti pajtohet se pas luftës, Kosova ishte vërshuar nga organizata të ndryshme humanitare, të cilat nën petkun e mbështetjes ndaj qytetarëve të Kosovës janë përfshirë në aktivitete dhe propagandë intensive fetare. Këto organizata kanë hyrë në një konkurrencë të ashpër për të dominuar mbi qytetarët e varfër të Kosovës. Hamiti thotë se UNMIK-u nuk bëri asgjë për të parandaluar këtë realitet, dhe madje edhe i ka regjistruar dhe zyrtarizuar këto organizata pa ndonjë kriter apo shqyrtim të tyre paraprak.¹⁷³ Në anën tjetër, Anton Berishaj, potencon se pas luftës të vitit 1999, qytetarët e Kosovës i ishin ekspozuar një “mbidoze” të Oksidentalizimit, siç janë muzika, kultura, veshmbathjet, ushqimi, etj. Nëse kësaj doze i shtohet edhe “ndjenja” se kosovarët ishin “çliruar” nga Perëndimi, atëherë orientimi ndaj religjionit, si një formë e reagimit, është i kuptueshëm. Berishaj deklaron se pasi që këta individë nuk ishin në gjendje të krijonin një reagim të mirëfilltë ndaj SHBA-ve dhe perëndimit, ata u kthyen nga Lindja. Berishaj beson se një reagim i tillë, mes tjerash, ka pasur për qëllim t'i tregojë perëndimorëve se ne si popull kemi ekzistuar edhe para vitit 1999. Një fenomen i tillë është dëshmuar kryesisht në mesin e kosovarëve të cilët nuk kanë qenë të gatshëm të pranonin animin perëndimor të shoqërisë kosovare dhe si reagim janë kthyer kah lindja. Për më tepër, Berishaj është i bindur se portretizimi i ligë i islamit nuk është diçka për të cilin Islami ka nevojë, por përkundrazi ekzistojnë disa qarqe të tjera të cilave ju konvenon një portretizimi i tillë. Për më tepër, sipas Berishajt, lëvizjet e fundit në botën myslimane siç janë organizatat radikale dhe "Pranvera Arabe" nuk kanë sjellë asgjë të mirë në Islam.¹⁷⁴

Është e qartë se kombinimi i faktorëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm, të cilët kanë ndër-vepruar së bashku pas vitit 1999, ka luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e religjiozitetit përgjatë tërë Kosovës, në veçanti atij Islam. Si rezultat i kësaj, pas luftës rëndësia e religjionit është rritur vazhdimisht në mesin e shqiptarëve të Kosovës. Për shembull, përqindja e njerëzve të cilët kanë deklaruar se feja luan një rol të rëndësishëm në jetën e tyre është rritur nga 67.9 për qind në vitin 2006, në 89.5 për qind në vitin 2009. Në mënyrë të ngjashme, përqindja e njerëzve që ndjekin shërbesat fetare në Kosovë është rritur nga 28 për qind në vitin 2006, në 44.2 për qind në vitin 2009.¹⁷⁵ Shenjat e tilla janë bërë gjithashtu mjaft të dukshme edhe publikisht, meqë objekte fetare janë shfaqur sikurse kërpudhat përgjatë tërë vendit gjatë viteve të fundit. Më shumë se 200 xhami të reja janë ndërtuar në Kosovë që nga viti 1999, ndërsa në

¹⁷² Intervistë me Driton Krasniqin, Kryetar i Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës, Prishtinë, 19.04.2016.

¹⁷³ Intervistë me Dr. Xhabir Hamitin.

¹⁷⁴ Intervistë me Dr. Anton Berishajn.

¹⁷⁵ Blumi, "Albanians' Islam[s]," 2014, f. 493.

Prishtinë numri i tyre pothuajse është dyfishuar, nga 13 xhami në vitin 2000, në 25 në vitin 2016.¹⁷⁶ Përderisa ringjallja e fesë është një proces i dëshmuar në përgjithësi në të gjitha vendet ish-komuniste, në kapitullin vijues do të tregohet se si disa nga faktorët tashmë të përmendur të brendshëm dhe të jashtëm kanë kontribuar në rritjen e radikalizmit fetar dhe në zhvendosjen e identitetit në Kosovë.

III.3. Prej vitit 2008 deri më sot: Pavarësia dhe shfaqja e ekstremizmit fetar

Pas 15 raundeve të vështira të negociatave në mes të Kosovës dhe Serbisë, në maj të vitit 2007 presidenti Ahtisari shpali propozimin e tij në lidhje me statusin e ardhshëm të Kosovës.¹⁷⁷ Pasi që ky propozim u kundërshtua ashpër si nga Serbia po ashtu edhe nga Rusia, autoritetet kosovare u përgatitën për të bërë një deklaratë të pavarësisë si pjesë e procesit të koordinuar ngushtë me komunitetin ndërkombëtar. Rrjedhimisht, më 17 shkurt 2008 Kuvendi i Kosovës e adoptoi deklaratën e pavarësisë “në përputhje të plotë me rekomandimet e të dërguarit të posaçëm të OKB-së Martti Ahtisaari.” Kjo deklaratë e shpallte Kosovën një shtet demokratik, sekular dhe republikë multi-etnike dhe i pranonte plotësisht obligimet e Kosovës sipas planit të Ahtisarit. Kështu, ndër aktet e para të Kosovës së pavarur ishte pranimi i Misionit të BE-së për sundimin e ligjit (të njohur si EULEX) për të siguruar mbështetje dhe mbikëqyrje në fushën juridike dhe të sigurisë, si dhe i Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar i cili do të mbikëqyrte implementimin e planit të Ahtisarit dhe do të vepronte si Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë. Që të dy, si EULEX ashtu edhe Përfaqësuesi Special edhe pse zotëronin një sferë të madhe të pushtetit ekzekutiv, megjithatë asnjëri nuk e kishte nivelin e autoritetit që UNMIKU-u dhe shefi i saj e gëzonin më parë.¹⁷⁸

Periodha që nga shpallja e pavarësisë është jashtëzakonisht e rëndësishme për temën që është objekt i studimit sepse ajo përfshinë disa faktorë të ndërveprues të një rëndësie së veçantë. Së pari, pavarësia e Kosovës nënkuptonte që elita politike kosovare, në veçanti qeveria të kishte rritje të autoritetit si dhe të përgjegjësisë në lidhje me të gjitha çështjet e rëndësishme në vend. Së dyti, shpallja e pavarësisë formalizoi nisjen e procesit të krijimit të identitetit të ri kosovar për shqiptarët e Kosovës. Një proces i tillë, nga njëra anë kishte tendencë ta dobësonte identitetin historik tradicional

¹⁷⁶ “Në Kosovë janë 750 xhami, BIK-u thotë se veç 2 i ka jashtë mbikëqyrjes,” Koha Ditore, 23 maj 2016; <http://koha.net/?id=27&l=114757> (23.05.2016).

¹⁷⁷ Organizata e Kombeve të Bashkuara, “Report of the Special Envoy of the Secretary-General on Kosovo’s Future Status,” S/2007/168, 26 mars 2007.

¹⁷⁸ Tansey, Oisín, “Kosovo: Independence and Tutelage,” *Journal of Democracy*, Vol. 20, No. 2, April 2009, f. 159.

shqiptar të shqiptarëve të Kosovës, përderisa në anën tjetër, siç do të tregojmë më poshtë, ofroi hapësirë shtesë manovrimi për forcimin e identitetit (mysliman) fetar. Së treti, shpallja e pavarësisë së Kosovës coincidoi me zgjerimin global të rrjeteve radikale islamike, të ashtuquajturën Pranverë Arabe dhe krijimin e të ashtuquajturit Shtetit Islamik të Irakut dhe Sirisë (ISIS). Këta faktorë së bashku kanë krijuar një realitet që ka rezultuar në radikalizimin dhe ekstremizmin e shtresave të caktuara të shqiptarëve myslimanë në Kosovë.

Një studim i bërë nga KIPRED-i në lidhje me Islamin politik, qysh në fillim të vitit 2005 paralajmëroi për shenjat e para të radikalizimit të shqiptarëve myslimanë në pjesët rurale të Kosovës. Sipas këtij studimi, organizata të ndryshme ndërkombëtare me baza fetare kanë ushtruar veprimtari në vend nën maskën e ndihmës humanitare dhe janë përpjekur për përhapjen e vlerave sociale dhe fetare të cilat nuk kanë qenë pjesë e traditës në Kosovë. KIPRED-i pohon se argumenti kryesor pse Kosovarët i kishin pranuar këto organizata të huaja myslimane dhe besimet e tyre ka qenë dështimi i komunitetit ndërkombëtar për të siguruar strehim, ushqim dhe arsimim për popullsinë lokale të vendeve rurale në Kosovë. Studimi paralajmëroi se aktivitetet e këtyre organizatave të lidhura me forcat politike që nuk kanë të bëjnë me interesat lokale shumë shpejtë mund të krijojnë një identitet kosovar i cili vështirë mund të kontrollohet nga forcat politike me bazë në Prishtinë ose në rajon. Për më tepër, studimi me të drejtë parashikoi që një luftë eventuale kudo në 'botën islamike' në dhjetë vitet e ardhshme mund të sfidojë seriozisht besnikërinë e shqiptarëve myslimanë në Kosovë.¹⁷⁹ Fatkeqësisht, institucionet e sapo krijuara në Kosovë dhe elita politike e saj manifestuan një neglizhencë të ngjashme përkundrejt radikalizmit Islam sikurse edhe faktorët ndërkombëtarë në kohën kur ky studim u përpilua.

Duke pasur në mendje karakterin sekular të nacionalizmit shqiptar të përshkruar më parë, nuk ishte befasi që Neni 8 i Kushtetutës së Kosovës, i miratuar me 15 qershor 2008, e përcakton Kosovën si një shtet sekular dhe neutral në çështjet e besimeve fetare. Në anën tjetër Neni 24 parandalon çdo diskriminim në baza fetare, gjersa Neni 38 garanton lirinë e besimit, ndërgjegjes dhe fesë. Megjithatë, paragrafi 4 i të njëjtit nen paralajmëron që "liria e manifestimit fetar, besimeve dhe ndërgjegjes mund të kufizohet nga ligji nëse është e nevojshme mbrojtja e sigurisë dhe rendit publik, ose e shëndetit dhe të drejtave të personit tjetër." Në mënyrë të ngjashme, Neni 40 thekson se "liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në rastet kur është e nevojshme të parandalohet inkurajimi dhe provokimi i dhunës dhe armiqësisë në baza (...) fetare."¹⁸⁰ Në mënyrë të qartë, Kushtetuta në njërin anë e përcakton Kosovën si një shtet sekular neutral ndaj fesë, gjersa në anën tjetër garanton lirinë e besimit dhe fesë si dhe lirinë e shprehjes.

¹⁷⁹ Për më shumë detaje shih Blumi, 2005, pf. 13-14.

¹⁸⁰ "Kushtetuta e Kosovës," Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 15 qershor 2008.

Megjithatë, siç e theksuam më lartë, Kushtetuta parashikon kufizime për të gjitha këto liri në rastet kur rrezikohet siguria dhe rendi publik ose kur është e nevojshme të parandalohet inkurajimi dhe provokimi i dhunës dhe armiqësisë në baza fetare. Prandaj, institucionet e sapo formuara të Kosovës ishin të detyruara të reagojnë në çdo shfaqje publike të “gjuhës së urrejtjes” e cila inkurajon apo provokon dhunë apo armiqësi në baza fetare. Sidoqoftë, institucionet e reja kosovare dhe partitë politike, duke qenë shumë të zëna me fushatën e njohjes së pavarësisë së shtetit të sapo krijuar, për mjaftë kohë e kanë nënvlerësuar dhe injoruar shfaqjen e ekstremizmit fetar në vend.

Shenjat e para publike të radikalizmit u bënë të dukshme në qershor të vitit 2010, në protestat kundër vendimit të Ministrisë së Arsimit për ndalimin e shamisë në shkollat publike fillore dhe të mesme të Kosovës. Protestat tërhoqën një vëmendje të konsiderueshme të mediave si lokale, ashtu edhe ndërkombëtare, gjersa protestuesit kërcënuan se do përdornin dhunë si dhe do i bllokoinin rrugët.¹⁸¹ Shenja të ngjashme të indinjatës së myslimanëve u shfaqën edhe pas hapjes zyrtare të katedrales së re katolike në Prishtinë të pagëzuar me emrin e Nëna Terezës më 5 shtator 2010. Edhe pse katedralja u lavdërua nga presidenti Sejdiu si një simbol i tolerancës fetare shqiptare, pas pak ditësh muret e saj u mbuluan me grafitë dhe fletushka degraduese. Grafitë të tilla denigruese u shkruan gjithashtu edhe në disa mure të objekteve të ndryshme në Prishtinë.¹⁸² Pas kësaj, nëpër rrugë filluan protestat e organizuara nga lëvizja e sapo krijuar “Bashkohu” për të kërkuar një lokacion për një xhami në qendër të Prishtinës. Edhe pse organizatorët mohuan akuzat se protesta ishte kundër katedrales, ata u ankuan se katolikët, përkundër faktit se janë një minoritet i vogël në Kosovë, kur bëhet fjalë për marrjen e lejeve për objekte fetare janë më të privilegjuar se sa shumica myslimane.¹⁸³

Më vonë, gjatë fushatës elektorale të zgjedhjeve të para parlamentare në Kosovën e pavarur, të cilat u mbajtën në dhjetor të vitit 2010, Partia e Drejtësisë (PD),¹⁸⁴ promovoi vlerat e shariatit, ndërsa koalicioni Aleanca Kosova e Re (AKR) anëtare e së cilës ishte Partia e Drejtësisë, premtoi se do lejonte mësimin fetar dhe përdorimin e shamisë (*hixhabin*) nëpër shkollat publike.¹⁸⁵ Pasi që AKR-ja iu bashkua koalicionit qeveritar, Partia e Drejtësisë propozoi dy amendamente në Kushtetutën e Kosovës që kishin të

¹⁸¹ Bytyci, Fatos, “Ndalimi i shamisë shqetëson muslimanët e devotshëm në Kosovë,” *Reuters*, 24 qershor 2010; <http://in.reuters.com/article/idINIndia-49612120100624> (04.06.2016).

¹⁸² Erebara, Gjergj, “Katedralja e Re në Kosovë ngjallë zemërim tek muslimanët,” *Balkan Insight*, 04 October 2010; <http://www.balkaninsight.com/en/article/albanians-vie-for-religious-sites> (05.06.2016)

¹⁸³ Blumi, “Albanians’ Islam[s],” 2014, f. 505.

¹⁸⁴ Partia e Drejtësisë u themelua në 2004, fillimisht u prezantua si parti konservative, jo si parti fetare. Sidoqoftë, që nga kjo fushatë zgjedhore ajo u konsiderua si parti fetare islamike.

¹⁸⁵ Berishaj, Anton, “Religjioni dhe Politika në Kosovë” në editorialet e Gorana Ognjenović dhe Jasna Jozelić *Politicization of Religion, the Power of State, Nation, and Faith: The Case of Former Yugoslavia and its Successor States*, New York: Palgrave Macmillan, 2014, f. 208.

bëjnë me shkollimin para universitar. Edhe pse zyrtarisht amendamenti i parë kishte për qëllim ndalimin e diskriminimit të myslimanëve nëpër shkolla, në fakt ai ishte menduar t'i favorizonte vajzat të cilat që mbanin shami. Amendamenti i dytë ishte në lidhje me futjen e mësimit fetar nëpër shkollat publike të Kosovës. Duhet theksuar se këto ndryshime gjithashtu ishin të mbështetura edhe nga Bashkësia Islame e Kosovës. Në gusht të vitit 2011, Kuvendi i Kosovës i refuzoi këto dy amendamente, megjithatë, veçanërisht të dytin, me një diferencë shumë të vogël të votave prej 43 ndaj 39.¹⁸⁶ Një diferencë e tillë e ngushtë e rezultatit të votave, ishte një tregues i qartë i simpatisë së individëve parlamentarë nga një gamë e gjerë e partive ndaj praktikave jo-sekulariste dhe grupeve shoqërore me bazë fetare. Përsëri, vendimi i Kuvendit u prit me protesta të ashpra në rrugët e Prishtinës të organizuara nga Partia e Drejtësisë, Bashkësia Islame e Kosovës dhe disa OJQ myslimane me baza fetare. Gjersa BIK-u kishte deklaruar se nuk i mbështet protestat në rrugë, megjithatë kishte insistuar në të drejtat e besimtarëve mysliman për shkollim, punësim dhe ndarje të lokacionit për xhaminë qendrore përfaqësuese në qytet.¹⁸⁷

Në fakt, Bashkësia Islame e Kosovës që nga pavarësia në mënyrë të vazhdueshme është akuzuar për kontributin që i ka dhënë radikalizimit të islamit në Kosovë. Pasi që konsiderohej si një institucion që duhej të mbronte islamin tradicional, që nga përfundimi i luftës në vitin 1999, BIK-u ka qenë në shënjestër të aktivistëve të huaj radikalë. Siç është shpjeguar më lartë, përpjekjet e tilla në fillim u kufizuan nga Myftiu i BIK-ut Rexhep Boja, i cili dëshironte të mbante jashtë institucionit të tij organizatat me bazë fetare nga Arabia Saudite. Sidoqoftë, pas zëvendësimit të tij në vitin 2003, duket që kontrolli mbi BIK-un ka qenë një betejë e vazhdueshme në mes të imamëve myslimanë të moderuar dhe atyre radikalë. Si rezultat, brenda BIK-ut janë krijuar dy grupe kryesore opozitare – ai radikal dhe ai më tradicional. Grupi i imamëve me interpretim radikal të Islamit udhëhiqet nga disa figura të shquara brenda Bashkësisë siç janë Dr. Shefqet Krasniqi, Fadil Sogojeva dhe Mazllam Mazllami. Në anën tjetër, grupi më tradicional i cili në mënyrë të hapur ka vënë në pikëpyetje motivet e grupeve humanitare me baza fetare dhe praktikën fetare të huaja të importuara në Kosovë përfshinë Xhabir Hamitin, Mullah Osmanin, Idriz Bilallin dhe Avni Sinanin.¹⁸⁸ Duhet përmendur fakti se pa një status ligjor dhe pa një llogari bankare, buxheti vjetor i BIK-ut i vlerësuar nga 5.5 deri 6

¹⁸⁶ Schwartz, Stephen, "Kosovo Bans Islamic Headscarf and Religious Instruction in Public Schools," (Kosova ndalon shaminë islame dhe udhëzimin fetar në shkolla publike) *The Weekly Standard*, 07 shtator 2011; <http://www.weeklystandard.com/kosovo-bans-islamic-headscarf-and-religious-instruction-in-public-schools/article/592759> (04.06.2016).

¹⁸⁷ Shehu, Bekim, "Besimtarët myslimanë në Kosovë vazhdojnë protestat për përfshirjen e lëndës së fesë në arsim dhe për ndërtimin e një xhamie të madhe," *Deutsche Welle*, 08 September 2011; <http://www.dw.com/sq/besimtar%C3%ABt-mysliman%C3%AB-n%C3%AB-kosov%C3%AB-vazhdojn%C3%AB-protestat-p%C3%ABr-p%C3%ABr-fshirjen-e-l%C3%ABnd%C3%ABs-s%C3%AB-fes%C3%AB-n%C3%AB-arsim-dhe-p%C3%ABr-nd%C3%ABrtimin-e-nj%C3%AB-xhamie-t%C3%AB-madhe/a-15371935> (06.06.2016).

¹⁸⁸ Blumi, "Albanians' Islam[s]," 2014, f. 497.

milion euro, ka kaluar nëpër xhepat personal apo llogarite bankare personale të individëve brenda bashkësisë. Si pasojë, që të dyja si buxheti, po ashtu edhe aktivitetet, kanë qenë të përshtatshme për manipulim dhe abuzim. Për më tepër, mungesa e transparencës dhe përgjegjësisë financiare ka rezultuar që disa imam të pranojnë fonde të pakontrolluara nga shtetet e Gjirit për të ndërtuar xhamitë e tyre.¹⁸⁹ Praktika të tilla, në mënyrë të qartë e kanë mundësuar depërtimin e organizatave vahabiste brenda BIK-ut dhe si rezultat radikalizimin e tij nga brenda. Imamët më të moderuar në disa raste kanë kritikuar Muftiun Naim Tërnavë për lidhjet e tij me organizatat radikale dhe tolerancën e tij ndaj ndikimit të huaj. Për shembull, imami Osman Musliu e ka kritikuar Tërnavën për mos rezistencë ndaj vahabizmit, bile për më tepër duke paralajmëruar që imamët vahabistë shumë shpejtë do të marrin kontrollin mbi shumicën e xhamive në Kosovë.¹⁹⁰ Fakti që disa imamë më radikalë brenda BIK-ut janë arrestuar për nxitje të urrejtjes ndërfetare dhe rekrutim për terrorizëm, tregon se të paktën disa individë brenda BIK-ut kanë qenë të përfshirë në përhapjen e islamit radikal në vend.

Ndërkohë, aktivitetet e fshehta të organizatave të ndryshme vahabiste në pjesët rurale të Kosovës që me vite kishin vepruar larg skenës publike të Kosovës filluan të japin rezultatet e pritura. Teqet tradicionale sufiste në pjesët rurale të Kosovës, pas vitit 1999 gradualisht u zëvendësuan me xhami dhe shkolla të cilat vazhduan përhapjen e vlerave islame paraprakisht të huaja për popullatën myslimane në Kosovë. Gjatë një periudhe kohore që nga pavarësia, organizata të huaja myslimane me baza fetare, kanë arritur të ndërtojnë një bazë të gjerë të përfaqësuesve lokalë, që ju mundëson realizimin e agjendës së tyre edhe pa qenë fizikisht të pranishëm në Kosovë. Imamët vendorë, të cilët janë shkolluar nëpër vendet prej nga e kanë origjinën këto organizata, kanë qenë aktorët kryesorë të rrjetave të tilla. Pas kthimit, ata kanë arritur të krijojnë një lëvizje të pasuesve besnikë, si dhe të shfrytëzojnë xhami të caktuara për mësimet e tyre radikale. Nga ana tjetër, këta imamë mbi të gjitha u bënë edhe politikisht aktiv, duke u lidhur me partitë myslimane të Kosovës dhe duke krijuar fraksione në bashkësinë islame të Kosovës.¹⁹¹ Pastaj, shumë shpejt, këto rrjete u përfshinë në akte të frikësimit fizik ndaj klerikëve të moderuar të arsimuar në vend si dhe ndaj grupeve më të paprivileguara siç janë gratë. Për shembull, në vitin 2008, disa burra të maskuar e kanë rrahur Xhabir Hamitin, profesor të studimeve islame në Prishtinë, për shkak të kritikave të tij të vazhdueshme ndaj vahabistëve. Në po të njëjtën mënyrë, në janar të vitit 2009, një grup ndjekësish të disa imamëve më radikal në mënyrë brutale e rrahën imamin Osman Musliu përpara xhamisë në një fshat në qendër të Kosovës, pasi kishte kritikuar Naim

¹⁸⁹ Kursani, 2015, f. 98.

¹⁹⁰ Blumi, "Albanians' Islam[s]," 2014, f. 497.

¹⁹¹ Basha, Dimal, "Globalization and the Rise of Salafism in Kosovo. How Gulf Countries Spearheaded a Transnational Advocacy Network that is Challenging a New Democracy," The New School University, Master of Arts Thesis, 2013, f. 65. (*Teza e Masterit: "Globalizmi dhe ngritja e Selafizmit në Kosovë. Si shtetet e Gjirit Persik udhëheqin një rrjet avokimi transnacional, i cili po sfidon demokracinë e re"*)

Tërnavën, kryetarin e Bashkësisë Islame të Kosovës, për mos kundërshtim të vahabistëve.¹⁹² Gjithashtu, në vitin 2014 një imam tjetër i moderuar, Zuhdi Hajzeraj i xhamisë Fahtali në Pejë, i cili kishte bërë disa deklarata kritikuese për islamin fundamentalist, kishte pranuar disa kërcënime për vdekje dhe madje thuhet se është bërë një përpjekje për ta goditur me makinë.¹⁹³ Në të njëjtën kohë, këta imamë të radikalizuar u bënë gjithashtu shumë aktiv publikisht, duke sfiduar hapur ligjet sekulare dhe duke folur kundër myslimanëve të moderuar si dhe kundër individëve të religjioneve të tjera. Nëse gjatë viteve 1989-1999 figurat historike shqiptare të shquara botërore si Skënderbeu dhe Nëna Terezë shfaqeshin si pjesë e krenarisë kombëtare, pas vitit 2008 ato publikisht u përçmuan dhe u sulmuan.¹⁹⁴ Në janar të vitit 2014, një statujë e Nënë Terezës në jug të Mitrovicës u rrëzua dy herë përtokë brenda një periudhe 24 orëshe. Pas këtij incidenti, i ashtuquajtur "Forum Rinor Mysliman" deklaroi se ishin të "kënaqur" dhe se po "luteshin që të gjitha statujat e saj të rrëzoheshin."¹⁹⁵

Këto procese të brendshme kanë koïnciduar me faktorë të jashtëm, siç është rritja e vazhdueshme e trendeve globale të së ashtuquajturit Islam Transnacional. Shpërndarja e formave të tilla universale dhe de-kulturuese të islamit fillimisht u bë përmes aktiviteteve humanitare dhe propaganduese të organizatave të ndryshme të Lindjes së Mesme. Mirëpo, lëvizjet islamike transnacionale, dinamikat migruese dhe rrjetet brenda diasporës, pelegrinazhi si dhe lidhjet edukative dhe kulturore kanë luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm. Si rezultat, ne kemi parë një shfaqje të rrjeteve islamike transnacionale, kryesisht të ndikuara nga organizatat siç janë Vëllazëria Muslimane, Al Qaeda dhe së fundi ISIS, të cilat ishin përfshirë në përhapjen e një ideologjie të caktuar fetare në të gjithë globin. Ngjashëm, edhe në Ballkan, këto trende kanë kontribuar në shkëmbimin e ideve dhe praktikave në mes të numrit në rritje të myslimanëve me bindje të njëjta (koreligjionist) në mbarë botën myslimane. Sërish, imigrantët myslimanë nga Ballkani në Evropën Perëndimore dhe studentët e institucioneve arsimore myslimane në vende të ndryshme myslimane, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përçimin e islamit transnacional në vendet e tyre të origjinës. Pa dyshim, ndihma e huaj islamike, siç u shpjegua më herët, ka qenë burim shtesë i rëndësishëm i ndikimit transnacional, veçanërisht pas luftërave në Ballkan.¹⁹⁶ Në këtë kontekst, islami transnacional vepron në një tension të vazhdueshëm me besnikëritë ekzistuese kombëtare dhe etnike. Në nivelin ideologjik, ky islam ka shtyrë myslimanët vendor të Ballkanit, si edhe të Kosovës, të zëvendësojnë besnikërinë etnike dhe kombëtare me islamin universal. Nga aspekt

¹⁹² Shih Blumi, "Albanians' Islam[s]," 2014, pf. 496-497.

¹⁹³ Më vonë, Hajzeraj i atribuon rritjen e ekstremizmit fetar në Kosovë financimit nga fundamentalistët e vendeve Arabe; shiko "Raporti Ndërkombëtar i lirisë fetare në Kosovë për vitin 2014" Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, Zyra për Demokraci, Të Drejtave të Njeriut dhe Punës, 2014, f. 8.

¹⁹⁴ Berishaj, 2014, f. 204.

¹⁹⁵ "Raporti Ndërkombëtar i lirisë fetare në Kosovë për vitin 2014," f. 10.

¹⁹⁶ Për më shumë detaje shiko Merdjanova, 2013, pf. 51-59.

akoma më radikal, me anë të tij janë indoktrinuar gjeneratat e reja të xhihadistëve në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për t'ju bashkuar radhëve të islamistëve ekstremistë.¹⁹⁷

Islami transnacional u ndihmua edhe më shumë nga e ashtuquajtura “Pranverë Arabe” – kryengritjet demokratike të cilat evoluuan në mënyrë të pavarur dhe u përhapen në të gjithë botën arabe në vitin 2011. Kjo lëvizje së pari filloi në Tunizi në muajin dhjetor të vitit 2010, por shumë shpejt u përhap edhe në Egjipt, Libi, Siri, Jemen, Behrein, Arabi Saudite dhe Jordan. Këto trazira rezultuan në ndryshimin e regjimeve autoritative në Tunizi, Egjipt dhe Jemen dhe poashtu shkaktuan një ndërhyrje ushtarake të NATO-s që e rrëzoi udhëheqësin libian nga pushteti.¹⁹⁸ Mirëpo, këto ndryshime gjithashtu krijuan një vakum pushteti dhe një kaos që mundësoi ringjalljen e islamit dhe shfaqjen e sekteve të ndryshme, shpeshherë radikale, të grupeve islamike nëpër të gjitha këto vende. Si rezultat, një realitet i ri u krijua, i cili siç thotë Bradley, i mundësoi islamistëve të “rrembejnë” këto revolta në Lindjen e Mesme.¹⁹⁹ Në anën tjetër, trazirat e ngjashme të cilat filluan në Siri, në vend që të rrëzonin regjimin diktatorial të Bashar al-Assad, u transformuan në një luftë të plotë civile e cila akoma po vazhdon që nga viti 2011. Për më tepër, kjo çoi në krijimin e të ashtuquajturit ISIS – një grup Salafist xhihadist militant që ndjek një doktrinë fundamentaliste Islamike, ate Vahabi të Islamit Sunit. ISIS-i e konsideron veten të jetë “Kalifati Islamik” (një perandori teologjike) dhe aktualisht kontrollon pjesët më të mëdha të Irakut perëndimor dhe Sirisë lindore. Gjatë vitit 2013 ISIS ka arritur t'i konsolidojë dhe fuqizojë si strukturat ashtu edhe kapacitetet e tij. Prandaj, poashtu është intensifikuar edhe rekrutimi i tij, meqenëse luftëtarët e ISIS-it dhe rekrutuesit e tij vazhdimisht ju bëjnë thirrje të gjithë myslimanëve në të gjithë botën për t'ju bashkuar kauzës së tyre të drejtë.²⁰⁰ Thirrje të tilla për shumë kohë u injoruan nga qeveria, partitë politike dhe shoqëria e gjerë në Kosovë. Siç do ta shihet më poshtë, ky realitet do të fillojë të ndryshojë vetëm atëherë kur një numër i madh i myslimanëve shqiptarë të Kosovës filloi t'i bashkohet ISIS-it si luftëtarë të huaj.

Në të vërtetë, qëndrimi i institucioneve të Kosovës dhe elitës së saj politike sa i përket islamit në përgjithësi dhe radikalizmit të tij në veçanti, ka qenë i paqartë dhe i dykuptimtë. Nga njëra anë, politikanët e Kosovës kanë qenë të kujdesshëm që të distancojnë vetëveten nga Islami, si pjesë e vizionit të tyre politik pro-evropian dhe pro-perëndimor. Kushtetuta, si dhe pjesa tjetër e legjislacionit është përpiluar mbi baza sekulare dhe bashkëpunim të ngushtë me partnerët perëndimorë. Institucionet, ashtu

¹⁹⁷ Për një shpjegim më të detajuar për rrjetet e islamit transnacional shiko Gul, Imtiaz, “Rrjetet Islamike Transnacionale,” Shqyrtim Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Vol. 92 No. 880, Dhjetor 2010, . 899-923.

¹⁹⁸ Toby Dodge eds., “After the Arab Spring: Power Shift in the Middle East?,” IDEAS Report, London School of Economics, May 2012, f. 64.

2. ¹⁹⁹ Për një shpjegim më të detajuar në lidhje me këtë temë shiko Bradley, John R., *After the Arab Spring: How Islamists Hijacked The Middle East Revolts*, St. Martin's Press, 2012.

²⁰⁰ Kursani, 2015, f. 18.

siç është shpjeguar edhe më herët, janë zotuar dhe përkushtuar që të sanksionojnë çdo thirrje radikale për lejimin e mësimit fetar dhe mbajtjen e shamive në shkollat publike. Mirëpo, në anën tjetër, si institucionet ashtu edhe partitë polikë nuk kanë arritur që të reagojnë ndaj shfaqjeve publike gjithnjë në rritje të radikalizmit islam edhe përkundër detyrimit ligjor për ta bërë këtë. Hoxhallarët radikalë myslimanë dhe individë të tjerë kanë përdorur gjuhën e urrejtjes ndërfetare në fjalimet tyre publike, duke filluar nga debatet televizive deri te gazetat e shtypit dhe rrjetet e tjera sociale. Hoxhallarët si Shefqet Krasniqi, Irfan Salihu dhe Zekeria Qazimi, në mënyrë të vazhdueshme kanë përdorur gjuhë denigruese kundër anëtarëve të bashkësive të tjera fetare, myslimanëve të moderuar, grave, dhe për më tepër edhe kundër heronjve kombëtar shqiptarë dhe individëve të mirënjohur.²⁰¹ Megjithatë, institucionet me vite kanë mbetur të heshtura dhe nuk kanë reaguar ndaj gjuhës së tillë të urrejtjes, gjuhë kjo që në mënyrë të hapur e ka nxitur urrejtjen kombëtare, fetare ose etnike. Ngjashëm, institucionet e kanë licencuar kanal televiziv "Peace TV", i cili drejtohet nga predikuesi i njohur i Islamit radikal Zakir Naik. Ky kanal televiziv transmeton program ditor 12-orësh në gjuhën shqipe, duke përfshirë intervista me figura myslimane nga Kosova të ndikuara nga një vebabizëm tejet të ashpër. Sipas Irfan Al-Alawit, drejtor ndërkombëtar i Qendrës për Pluralizmin Islam dhe drejtor ekzekutiv i Fondacionit për Hulumtime të Trashëgimisë Islame, "Peace TV" është i njohur në tërë botën për interpretimet e linjës së ashpër të islamit dhe ofendimet e drejtpërdrejta që i bëhen anëtarëve të bashkësive të tjera fetare dhe myslimanëve të moderuar. Edhe pse Al-Alawi ka paralajmëtar se ardhja e tyre në Kosovë paraqet një instrument shtesë për islamistët radikalë dhe financuesit e tyre, kryesisht nga Arabia Saudite dhe shtetet e tjera të Gjirit Persik, për të krijuar një pikëmbështetje në mesin e myslimanëve indigjenë të Evropës në Ballkan,²⁰² institucionet e Kosovës nuk kanë ndërmarrë asnjë hap në këtë drejtim. Neglizhenca e tillë dhe politika e mosndëshkimit nga ana e institucioneve të Kosovës ndaj individëve dhe organizatave që nxisin urrejtje të tillë fetare dhe etnike, padyshim që ka kontribuar edhe më tej në inkurajimin e radikalizmit islamik në vend.

Edhe pse të gjitha partitë kryesore politike janë sekulare, ato në përgjithësi kanë dështuar në adresimin e shenjave gjithnjë në rritje të radikalizimit në mesin e

²⁰¹ Për shembull, Shefqet Krasniqi, imami i Xhamisë së Madhe të qytetit, ka bërë ndër të tjera komente me gjuhë urrejtjeje kundër Nënë Terezës, duke deklaruar se pavarësisht se ajo konsiderohet si personalitet i shquar shqiptar në historinë e kohëve të fundit, ajo ishte në "mes të ferrit të thellë," për shkak se ajo nuk ishte myslimane. Për më tepër, Krasniqi pohoi se pavarësisht beqarisë së saj murgesha shqiptare "mund të ketë pasur të gjithë burrat që ajo donte." Irfan Salihu i njohur në Kosovë për pikëpamjet e tij të ashpra dhe konservatore, në anën tjetër, kishte mbajtur një fjalim në xhaminë e tij në Prizren, në të cilën ai kishte akuzuar gratë kosovare shqiptare duke i quajtur ato "prostituta" duke u bërë thirrje burrave të tyre që t'i braktisin ato.

²⁰² Al-Alawi, Irfan, "Extremists Establish Foothold in the Balkans," *Gatestone Institute*, 24 September 2012); <http://www.gatestoneinstitute.org/3360/kosovo-peace-tv> (06.06.2016).

shqiptarëve myslimanë të Kosovës. Me përjashtim të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e cila në mënyrë të hapur ka denoncuar fjalimet e tilla publike, partitë e tjera politike kanë qëndruar mjaft të heshtura në këtë drejtim. Në të vërtetë, kreu i AAK-së Ramush Haradinaj dhe zyrtarët e tjerë të partisë së tij shpesh e kanë ngritur zërin e tyre kundër radikalizmit islamik.²⁰³ Fatkeqësisht, shumica e partive të tjera politike kanë koketuar me grupet e tilla radikale me qëllim të sigurimit të mbështetjes elektorale. Përndryshe, do të ishte vështirë e shpjegueshme se si Partia e Drejtësisë me një mbështetje modeste elektorale ka arritur dy herë radhazi të bëhet pjesë e koalicionit qeverisës. Madje, edhe më interesante do të ishte pyetja se përse PDK-ja si partia më e fuqishme në Kosovë ka vendosur të hyjë në koalicion para-elektoral me një parti politike kaq të vogël e cila haptas e propagon Islamin në Kosovë.²⁰⁴ Për më tepër, si partner kryesor në të tri qeveritë e koalicionit të Kosovës që nga pavarësia, PDK-ja sigurisht që mbanë përgjegjësinë më të madhe për neglizhencën e institucioneve të Kosovës ndaj individëve dhe organizatave që nxisin urrejtjen fetare dhe etnike. Partia Vetëvendosje (VV), nga ana tjetër, në vitin 2011 e ka filluar animin e saj drejt islamit politik, kur deputetët e saj vendosën të mbështesin futjen e mësimin fetar dhe shamisë në shkollat publike të propozuar nga Partia e Drejtësisë.²⁰⁵ Një qëndrim i tillë u bë edhe më i qartë kur partia në fjalë nuk pranoi ta mbështesë deputeten e vet femër - Alma Lamën - kundër kërcënimeve dhe frikësimit nga imamët dhe individët radikalë. Menjëherë pas kësaj, Lama ishte ndarë nga VV-ja duke deklaruar haptazi se ndikimi i vahabistëve dhe Vëllazërisë Myslimane paraqet vetëvrasje politike për Kosovën.²⁰⁶ Së fundi, edhe LDK-ja - si një parti e moderuar dhe sekulare, e cila gjithmonë e ka përkrahur tolerancën fetare - ka filluar të shfaqë shenja të koketimit me elementet e islamit politik në Kosovë. Gjegjësisht, gjatë fushatës elektorale të zgjedhjeve të fundit lokale të mbajtura në nëntor të vitit 2013, Lutfi Haziri, nënkryetar i LDK-së dhe kandidat për kryetar të Gjilanit, e ka deklaruar haptas mbështetjen e tij për lejimin mbajtjes së veshjeve fetare për vajzat nëpër shkollat publike. Për më tepër, menjëherë pasi u bë kryetar, Haziri hyri në

²⁰³ Për shembull deputetët e AAK-së kanë qenë më të zëshmit kundër përfshirjes së mësimin fetar dhe mbajtjes së shamive në shkollat publike. Shih Schwartz, 2011.

²⁰⁴ Partia e Drejtësisë në zgjedhjet e para parlamentare në vitin 2004 fitoi numër të vogël të votave prej 1 për qind dhe vetëm 1 nga 120 ulëseve. Në zgjedhjet e ardhshme në vitin 2010, si pjesë e koalicionit të "Aleancës Kosova e Re", numri i saj i deputetëve ishte rritur në tre. Në zgjedhjet e fundit në vitin 2014 si pjesë e koalicionit parazgjedhor me PDK-në ata përsëri fituan vetëm një vend. Megjithatë, pavarësisht këtyre rezultateve modeste, PD ka arritur të jetë pjesë e qeverisë që nga viti 2010, duke mbajtur një post ministror dhe poste të tjera ekzekutive

²⁰⁵ Duhet të përmendet se edhe pse VV në parim e mbështet këtë propozim, e ka kushtëzuar atë me debate shtesë për planprogramin e mësimin fetar, duke insistuar se duhet të fokusohet në historinë e religjionit dhe jo në praktikimin e tij; shih Berishaj, 2014, f. 209.

²⁰⁶ Lama pastaj është ofenduar nga ish partiakët e saj dhe për më tepër ka marrë kërcënime me vdekje nga radikalët myslimanë. Për më shumë detaje shiko Schwartz, Stephen, "Radical Islam's Intimidation in Kosova: The Attempt to Destroy Alma Lama, Gatestone Institute, 5 mars 2014; <http://www.islamicpluralism.org/2360/radical-islam-intimidation-in-kosova> (08.06.2016).

koalicion me Partinë e Drejtësisë, duke iu dhënë atyre postin e Drejtorit Komunal të Shëndetësisë, si dhe disa poste të tjera të komisioneve brenda Kuvendit Komunal.²⁰⁷

Radikalizimi i shqiptarëve myslimanë të Kosovës për herë të parë e ka kapur vëmendjen e institucioneve të Kosovës dhe publikut të gjerë, kur ishte përhapur lajmi për vdekjen e parë të një shqiptari nga Kosova si luftëtar i huaj në Siri.²⁰⁸ Alarmi veçse ishte rritur kur më 29 korrik 2014 Lavdrim Muhaxheri kishte postuar fotografitë e tij duke i prerë kokën një ushtari sirian dhe duke u bërë thirrje myslimanëve të Kosovës t'i bashkoheshin luftës në Siri kundër regjimit të Bashar al-Asaadit dhe "të pafeve" të tjerë.²⁰⁹ Kur u raportua se Kosova ka numrin më të madh në botë të luftëtarëve të huaj për kokë banori, institucionet e Kosovës që deri atëherë ishin në gjumë, padyshim se u detyruan të vepronin.²¹⁰ Rrjedhimisht, në gusht të vitit 2014 policia kontrollloi 60 vende në tërë Kosovën dhe arrestoi 40 shtetas të Kosovës nën dyshimin se kishin marrë pjesë në akte të terrorizmit në Irak dhe Siri. Sipas raporteve të ndryshme, arrestimet janë kryer në përputhje me Kodin Penal të Kosovës me qëllim të mbrojtjes së rendit kushtetues dhe sigurisë në vend.²¹¹ Deri në janar të vitit 2015, rreth 80 persona janë arrestuar nën akuza të ngjashme, duke përfshirë edhe një numër të hoxhallarëve me ndikim radikal.²¹²

Si një reagim ndaj numrit relativisht të lartë të luftëtarëve të huaj nga Kosova, në mars të vitit 2015, Kuvendi i Kosovës miratoi "Ligjin për Ndalimin e Bashkimit në Konfliktet të Armatosura Jashtë Territorit të Vendit", i cili e konsideron si vepër penale veprën e cilitdo person që "organizon, rekruton, udhëheqë apo trajnon personat ose grupe të personave me qëllim të bashkimit apo pjesëmarrjes në ushtrinë ose policinë e huaj jashtë territorit të Republikës së Kosovës." Lidhur me inkurajimin për t'u bashkuar, ose për të marrë pjesë në konfliktet e huaja, Ligji përcakton se angazhimi në konfliktet e

²⁰⁷ Shiko për shembull "Lutfi Haziri: Unë kryetar, vajzat me shamia në shkollë," *Portalb*, 08 nëntor 2013; <http://portalb.mk/21659-lutfi-haziri-une-kryetar-vajzat-me-shamia-ne-shkollë/> (08.06.2016). Also see "Edhe Partia e Drejtësisë merr një drejtorat, Labinotë Demi në krye të shëndetësisë," *RajoniPress*, Agjencia Rajonale e Lajmeve, 30 janar 2014; <http://rajonipress.com/shfletto-artikujt.php?id=19044> (08.06.2016).

²⁰⁸ Luftëtar i parë i huaj nga Kosova vritet në konfliktin e fundit në Siri ishte Naman Demolli nga Prishtina; shih Kursani, 2015, pf. 17-18.

3. ²⁰⁹ Është raportuar se Lavdrim Muhaxheri kishte punuar për Bashkësisë Islame të Kosovës në Kaçanik dhe për më tepër ka deklaruar se ka ushtruar kontrollin e tij për emërimin e imamit të Xhamisë Qendrore në Kaçanik. Për më shumë detaje shih: Schwartz, Stephen "ISIS and the Kosovar Albanians," *The Huffington Post*, 12 October 2014; http://www.huffingtonpost.com/stephen-schwartz/isis-and-the-kosovar-alba_b_5670061.html (08.06.2016).

²¹⁰ Sipas burimeve të policisë, numri i përgjithshëm i kosovarëve që luftojnë jashtë vendit ka arritur në 232 në janar 2015, prej të cilëve ekzistojnë informata se 34 janë vrarë; shih Kursani, 2015, f. 24.

²¹¹ Ibid.

²¹² Kursani, 2015, f. 29.

huaja mund të dënohet me burgim nga 5 deri në 15 vjet.²¹³ Më vonë, në shtator të vitit 2015, Zyra e Kryeministrit të Kosovës gjithashtu përgatiti një “Strategji për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit i cili shpije drejt Terrorizmit për periudhën 2015-2020, si dhe Planin e Veprimit për zbatimin e asaj strategjie.²¹⁴ Duket se masat e tilla kanë dhënë rezultate konkrete pasi që vetëm 16 kosovarë të tjerë kanë shkuar në Siri gjatë periudhës janar-mars 2015 dhe asnjë gjatë vitit 2016.²¹⁵ Megjithatë, një dokumentari i Gazetës Express i quajtur “Kampet e Zeza” i ka dërguar një mesazh të qartë institucioneve të Kosovës dhe shoqërisë së gjerë në lidhje me kompleksitetin dhe seriozitetin e Islamit radikal në vend. Dokumentari zbuloi se ISIS dhe Al Nusra kanë trajnuar rekrutë të ardhshëm në dy kampe në afërsi të qytetit të vogël të Vitisë. Ky dokumentar ka shpalosur se shumë kosovarë janë trajnuar në këto objekte para se të bashkoheshin me ISIS-in në Siri dhe Irak.²¹⁶ Njëkohësisht, janë ngritur edhe pyetje në lidhje me atë se si këto kampe kanë mbetur pa u vënë re në një Kosovë kaq të vogël me pak më shumë se 10.000 kilometra katrorë dhe për më tepër vetëm disa kilometra larg nga kampi i madh ushtarak amerikan Bondstill.

Vetëm dy javë më vonë, një artikull i quajtur “Si u shndërrua Kosova në tokë pjellore për ISIS-in” i shkruar nga gazeta e respektuar amerikane “The New York Times” kishte ndezur edhe më tej atmosferën veçse të nxehtë në Kosovë. Edhe pse ky artikull sipas të gjitha gjasave u shfaq me një vonesë të caktuar krahasuar me realitetin në Kosovë, ai iu kujtoi fuqishëm autoriteteve të Kosovës si dhe bashkësisë ndërkombëtare se kanë një rrugë të gjatë përpara në luftën kundër ekstremizmit dhe radikalizmit fetar në Kosovë. Sipas New York Times, gjatë një periudhe hulumtimi dy vjeçare, policia kishte identifikuar 314 kosovarë – përfshirë dy vetëvrasës me bombë, 44 gra dhe 28 fëmijë – të cilët iu kishin bashkuar ISIS-it si luftëtarë të huaj. Hetimet zbuluan se kosovarët ishin radikalizuar dhe më vonë ishin rekrutuar nga një grup i hoxhallarëve ekstremistë dhe shoqatat e fshehta të financuara nga Arabia Saudite dhe shtetet e tjera arabe të Gjirit Persik. Financimi i këtyre aktiviteteve e kishte shfrytëzuar një rrjet të fshehtë të donacioneve, që përfshinte shoqatat e bamirësisë, individët privatë si dhe ministritë e qeverisë. Artikulli, ndër tjera, e citon Fatos Makollin, Drejtor të Policisë së Kosovës kundër Terrorizmit, i cili pretendon se klerikët dhe grupet ekstremiste kanë "promovuar Islamin politik", duke shpenzuar shuma të mëdha parash në programe të ndryshme që

213 “Ligji për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit” Kuvendi i Republikës së Kosovës, Prishtinë 15 mars 2015

214 “Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizmit i cili shpije drejt Terrorizmit për periudhën 2015-2020” Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Shtator 2015.

4. ²¹⁵ Duhet të përmendet se një numër i caktuar i kosovarëve të zënë nga autoritetet në përpjekjet e tyre për t’ju bashkuar luftës në Siri; shih Kursani, 2015, f. 26. Shih gjithashtu “Sivjet asnjë kosovar nuk i është bashkuar ISIS-it,” *Kohantet*, 28 April 2016; <http://koha.net/?id=27&l=110663> (08.06.2016).

5. ²¹⁶ “Videoja e plotë e dokumentarit “Kampet e Zeza,”” *Gazeta Express*, 08 maj 2016; <http://www.gazetaexpress.com/lajme/videoja-e-plote-e-dokumentarit-kampet-e-zeza-zonaexpress-197806/> (08.06.2016).

për shënjestër kishin kryesisht të rinjtë dhe të pambrojturit.²¹⁷ Përfundimisht, “Raporti kundër Terrorizimit për vitin 2015” i cili sapo është publikuar nga Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e ka konfirmuar gjithashtu kërcënimin në rritje e sipër nga ekstremizmi i dhunshëm islamik në Kosovë, i financuar kryesisht nga organizatat e huaja që predikojnë ideologji ekstremiste. Raporti ka theksuar gjithashtu se mungesa e kapaciteteve dhe buxhetit të mjaftueshëm paraqesin sfidat kryesore për luftën e qeverisë së Kosovës kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe ka kërkuar angazhimin e ngjeshur të SHBA-ve në mbështetje të qeverisë.²¹⁸ Natyrisht çështja e ekstremizmit fetar në Kosovë paraqet një problem serioz dhe i cili nuk është fare i lehtë që të zgjidhet. Çrrenjosja e tij e suksesshme pa dyshim do të kërkojë një angazhim të gjatë dhe veprim të koordinuar të të gjithë aktorëve relevant qeveritarë dhe joqeveritarë në Kosovë.

Nga aspekti i religjionit dhe zhvendosjes së identitetit të shqiptarëve të Kosovës, krijimi i identitetit të ri kosovar paraqet një pasojë tjetër të rëndësishme të pavarësisë së Kosovës. Shqiptarët e Kosovës të cilët ndër shekuj kanë kultivuar një identitet të fortë kombëtar shqiptar, pas pavarësisë janë përballur me një realitet paksa konfuz. Pas përfundimit të projektit politik të tyre për një Kosovë të pavarur, ata papritur u ballfaqan me lojalitete divergjente. Nga njëra anë, duke qenë një shtet i pavarur, Kosova u përballë me sfidën e farkimit të një identiteti kombëtar sekular i cili do të mund t’i tejkalonte ndarjet etnike dhe fetare. Si rezultat, simbolet e shtetit të ri, si flamuri dhe himni kombëtar iu shmangën çdo simboli kombëtar shqiptar nga e kaluara. Mirëpo, nga ana tjetër, një rikonfigurim i tillë i Kosovës ka pasur në mënyrë të pashmangshme një ndikim denacionalizues mbi shqiptarët e Kosovës. Fatkeqësisht, në vend se identiteti shtetëror dhe ai shqiptar të trajtoheshin si komplementar, debatet politike në Kosovë shpeshherë i kanë portretizuar ato si ekskluzive. Një gjë e tillë pastaj e ka dobësuar identitetin historik tradicional shqiptar të shqiptarëve të Kosovës, sidomos në mesin e të rinjve të Kosovës. Vakumi ideologjik i krijuar i ka dhënë hapësirë manovrimi shtesë forcimit të identitetit fetar (musliman) në kurriz të identitetit etnik, dhe radikalizimit eventual të një numri të caktuar të myslimanëve shqiptarë të Kosovës. Institucionet e Kosovës dhe partitë kryesore politike nuk kanë arritur ta vënë në binar komplementaritetin e identitetit kosovar me atë shqiptar dhe fetar të shqiptarëve të Kosovës. Si pasojë, lojaliteti i shqiptarëve të Kosovës në periudhën pas pavarësisë dalëngadalë është duke u zhvendosur nga shqiptaria dhe shteti i Kosovës në një identitet fetar me karakter ekskluziv etno-religjioz, shpesh madje edhe me primesa të Islamit radikal.²¹⁹

²¹⁷ Gal, Carlotta, “How Kosovo Was Turned Into Fertile Ground for ISIS,” The New York Times, 21 maj 2016.

²¹⁸ “Raporti kundër Terrorizimit për vitin 2015” nga Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Publikim i Zyrës Kundër Terrorizimit dhe Luftimit të Ekstremizimit të Dhunshëm, qershor 2016.

²¹⁹ Këto argumente do të mbështeten me anë të analizës së sondazheve të opinionit publik si më poshtë.

Agim Çeku beson se shenjat e radikalizmit mund të ndiqen qysh prej aktiviteteve të hershme të organizatave me bazë fetare nga Arabia Saudite dhe vendet e Gjirit Persik të cilat e ekspozuan popullatën myslimane të Kosovës me një koncept të ri të Islamit që ishte në kundërshtim me konceptin tradicional. Sot, Kosova si shtet ka marrë përgjegjësitë e veta pasi që është bërë e qartë se radikalizmi fetar paraqet një kërcënim serioz. Një radikalizim i tillë është i huaj për Islamin tradicional të Kosovës dhe si i tillë është i papranueshëm për realitetin tonë. Për më tepër, ai paraqet një kërcënim për sigurinë e Kosovës dhe zbeh perspektivat e saj për të ardhmen. Sipas Çekut, për fat të keq, për shkak të neglizhencës së institucioneve shtetërore, radikalizmi i tillë ka arritur të përhapet në shumë pjesë të Kosovës. Çeku gjithashtu shpjegon se ndërsa para pavarësisë, xhamitë në të gjithë Kosovën kanë qenë kryesisht të zbrazëta, sot ato janë më se të mbipopulluara. Ky fenomen është akoma edhe më shqetësues pasi që këto grupe radikale kryesisht i kanë në shënjestër të rinjtë e Kosovës. Që nga viti 2010 Kosova i është bashkuar koalicionit kundër ekstremizmit dhe radikalizmit fetar dhe ka nisur marrjen e masave për trajtimin e fenomeneve të tilla brenda kufijve të saj. Këto masa janë intensifikuar, sidomos pasi numri i vullnetarëve të Kosovës që lufton për kauzën fetare jashtë vendit është rritur në masë të ndjeshme.²²⁰

Për sa i përket zhvendosjes eventuale në mes të identitetit fetar dhe atij kombëtar, Çeku beson se sot një numër i madh i qytetarëve të Kosovës e identifikojnë vetën e tyre së pari me përkatësinë fetare dhe pastaj me atë kombëtare. Megjithatë, ai deklaron se feja në Kosovë ka më pak rëndësi krahasuar me Serbinë dhe Kroacinë, në veçanti kur bëhet fjalë për vendimmarrjen. Ai është i bindur gjithashtu se religjioziteti i shtuar ende nuk e ka rrezikuar identitetin etnik shqiptar, pasi që Kosova vazhdon të jetë e njohur si një vend me shumicë shqiptare dhe jo me shumicë myslimane. Megjithatë, Çeku këmbëngul se institucionet e Kosovës duhet të reagojnë ndaj çdo veprimtarie radikale që rrezikon karakterin sekular të shtetit. Në të kaluarën, institucionet kanë ndjekur dhe kanë hetuar me kujdes aktivitetet e këtyre grupeve radikale, por nuk kanë arritur të reagojnë me kohë. Sipas Çekut, një nga arsytet se përse institucionet kanë mbetur pasive është meqë ato nuk kanë dashur të krijojnë një imazh negativ për Kosovën përballë partnerëve perëndimorë.²²¹

Për sa i përket faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të cilët kanë kontribuar në futjen e agjendave fetare publike, përfshirë këtu edhe radikalizmin, Çeku beson se faktorët e brendshëm kyçë kanë qenë neglizhenca dhe pasiviteti i institucioneve ndërkombëtare pas përfundimit të luftës në vitin 1999 dhe mungesa e kapaciteteve të duhura për të trajtuar sfidat e tilla. Në anën tjetër, për Çekun organizatat e huaja fetare me agjendat e

²²⁰ Intervistë me Agim Çekun

²²¹ Ibid.

tyre politike paraqesin faktorin kryesor të jashtëm që ka kontribuar në shfaqjen e radikalizmit në Kosovë. Megjithatë, ai gjithashtu beson se zhvillimet globale, sidomos konflikti i hapur mes radikalizmit fetar dhe vlerave perëndimore, kanë kontribuar ndaj këtij fenomeni. Në përgjithësi, Çeku është i bindur se në shfaqjen e radikalizmit në Kosovë më shumë kanë kontribuar faktorët e jashtëm se sa ata të brendshëm. Duke qenë se Islami në Kosovë ka qenë tradicionalisht më shumë evropian se sa lindor, vendet arabe kanë infiltruar disa elemente radikale për të dobësuar lidhjet e Kosovës me SHBA-të dhe Evropën Perëndimore. Sipas Çekut, mes tjerash, kjo edhe është arsyeja se pse disa vende arabe akoma nuk e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur.²²²

Në anën tjetër, Albin Kurti beson se për sa i përket religjioziteti periudha pas pavarësisë paraqet një vazhdim të thjeshtë të realitetit para vitit 2008. Megjithatë, ajo që është thelbësore, sipas tij, është se pas shpalljes së pavarësisë, partitë politike qeveritare e kishin shpallur projektin e çështjes kombëtare si të përfunduar. Mirëpo, entuziazmi i menjëhershëm i qytetarëve pas pavarësisë shumë shpejt u zëvendësua me një realitet të tmerrshëm të varfërisë, nepotizmit dhe korrupsionit. Logjikisht, nëse kauza kombëtare është një punë e kryer, ndërsa qytetarët nuk gëzojnë lirinë dhe vështirë se mund ta ushqejnë vetëveten - feja na paraqitet si një zgjedhje alternative. Një realitet i tillë është plotësuar mëtutje edhe me proceset globale, të cilat në mënyrë të pashmangshme e kanë ndikuar edhe Kosovën. Në njërin anë, intervenimi i NATO-s në Kosovë, që është shikuar nga kosovarët si një "intervenim hyjnor" me dimensione biblike, e ka rritur besimin në mesin e kosovarëve. Kjo nuk do të thotë se një gjë e tillë e ka rritur menjëherë religjiozitetin, pasi që ekziston një dallim në mes të besimit dhe të religjionit. Në anën tjetër, pas 11 shtatorit 2001, SHBA-të e bënë Kosovën pjesë të projektit të tyre global për të siguruar mbështetjen e vendeve me popullsi shumicë myslimane. Ngjashëm si me Turqinë, si pjesë e doktrinës së Bushit, Kosova u etiketua si një vend "i njerëzve myslimanë të cilët duan të jetojnë në paqe." Kurti beson se një diferencim i tillë në mes të myslimanëve "të mirë" të cilët duan të jetojnë në paqe, dhe myslimanëve "të këqij" të cilët duan të jetojnë në luftë, ka kontribuar në ringjalljen e përgjithshme globale të Islamit. Për më tepër, një gjë e tillë ka kontribuar edhe në krijimin e ndasive në mesin e myslimanëve të Kosovës, duke i ndarë në myslimanë "të butë" kundër myslimanëve "të fortë", myslimanë "të vërtetë" kundër myslimanëve "jo të vërtetë", si dhe myslimanë "të moderuar" kundër myslimanëve "radikalë".²²³

Megjithatë, Kurti nuk beson se religjioziteti i shtuar në shoqërinë kosovare ka pasur ndonjë ndikim në identitetin kombëtar/etnik, por përkundrazi ai pretendon se ka ndodhur diçka pararendëse. Identiteti kombëtar është dobësuar nga politika, dhe pastaj qytetarët

²²² Ibid.

²²³ Intervistë me Albin Kurtin

janë kthyer kah religjioni. Prandaj, nuk është se përforcimi i identitetit fetar e ka dëmtuar atë kombëtar, përkundrazi identiteti kombëtar është dobësuar duke e shpallur të përfunduar projektin kombëtar, dhe pastaj individë të caktuar i janë kthyer fesë për kompensim të nevojave shpirtërore dhe emocionale. Sipas Kurtit, tendencat e tilla si dhe tendenca për të "kosovarizuar" shqiptarët e Kosovës, në vend të krijimit të një identiteti kosovar, e kanë dobësuar identitetin shqiptar dhe kanë krijuar një hapësirë manovrimi për ndikime të tjera. Në anën tjetër, Kurti beson se dështimi i institucioneve të Kosovës për të reaguar kundër deklaratave të liderëve fetarë, të cilët mbjellin urrejtje fetare, është rezultat i asaj që ai e quan marrëveshje gjentëlmene në mes të Shërbimit të Inteligjencës së Kosovës (SHIK) dhe Bondstillit. Nga njëra anë, SHIK-u do t'i ofrojë informacion të vlefshëm amerikanëve në mënyrë që të arrestojnë në aeroport 2-3 radikalë nga Pakistani. Nga ana tjetër, amerikanët do t'i mbështesin ata në luftën e tyre kundër partive opozitare, më parë LDK-në dhe në ditët e sotme VV-në. Individët brenda SHIK-ut janë të interesuar që të ketë paksa radikalizim të kufizuar në Kosovë, në mënyrë që të jenë në gjendje ta dëshmojnë veten para amerikanëve. Megjithatë, Kurti beson se këta individë janë duke luajtur me zjarrin, pasi po nuk pati radikalizëm atëherë kontratat e tyre nuk do të vazhdojnë. Rrjedhimisht, tani sikurse edhe atëherë, ata kohë pas kohe i bëjnë publike informatat lidhur me grupet radikale në Kosovë. Për sa i përket edukimit fetar, Kurti konfirmon se VV është kundër. Megjithatë, VV mbështet të mësuarit në lidhje me fetë e ndryshme, por vetëm në shkollat e mesme dhe jo edhe në shkollat fillore, pra mbi moshën 16 vjeçare. Në këtë rast të rinjtë do të mësonin për historinë e fesë, sidomos për dimensionet shoqërore, kulturore dhe filozofike të saj. Përveç kësaj, Kurti këmbëngul se mësimi i tillë nuk duhet të kryhet nga hoxhallarët dhe priftërinjtë, por nga historianët dhe teologët. Njëkohësisht, sipas tij ky mësim nuk duhet të jetë me përqendrim të fort, por duhet të përfshijë edhe fetë e tjera si Budizmin, Konfucianizmin, etj., si besimi poashtu të rëndësishme.²²⁴

Për sa i përket faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të cilët kanë kontribuar në futjen e agjendave fetare publike, përfshirë këtu edhe radikalizmin, Kurti pretendon se neo-liberalizmi, si një formë e tranzicionit radikal prej socializmit në kapitalizëm, në Kosovë në vend të kapitalizmit e ka sjellë feudalizmin. Feudalizmi pastaj, sipas tij, është një sistem në të cilin lulëzojnë religjionet e ndryshme. Për më tepër, Kurti insiston se edhe pse kosovarët kanë telefona mobilë dhe qasje në internet, format aktuale të fafesisë dhe nepotizmit nga zyrtarët qeveritarë e kanë kthyer Kosovën në Mesjetë. Dhe Mesjeta, në kundërshtim me modernizmin, që identifikohet me shkencën, kombin, shtetin dhe sekularizimin, karakterizohet me fenë. Në anën tjetër, Kurti gjithashtu beson se islami është duke ndryshuar në tërë botën dhe për këtë arsye Kosova nuk mund të jetë një përjashtim. Natyrisht, globalizimi ka një ndikim të madh në mbarë botën, dhe në rastin tonë ajo ndikon më shumë në Kosovë sesa anasjelltas. Në ditët e sotme, hoxhallarët

²²⁴ Ibid.

kosovarë kanë përfunduar studimet e tyre në vende të ndryshme, duke filluar nga Egjipti dhe Turqia, Arabia Saudite dhe Iraku. Duke studiuar në vende të ndryshme, edhe mendjet e tyre janë transformuar, dhe pastaj një transformim të tillë ata e kanë përcjellur edhe tek nxënësit e tyre. Megjithatë, Kurti dyshon se feja mund të rrezikojnë identitetin etnik të shqiptarëve, pasi që ai pajtohet me rilindasin shqiptar Fan Noli se "shqiptarët janë paganë me tre fe." Arsyeet pse shqiptarët janë konvertuar aq shpesh nga një fe në një tjetër, është sepse ata nuk e marrin seriozisht fenë. Edhe sot Shqiptarët konvertohen, mirëpo sipas Kurtit, edhe kjo është pjesë e mos-seriozitetit ndaj fesë, kështuqë grupet aktuale fetare nuk duhet të konsiderohen si tejet të rrezikshme.²²⁵

Fatmir Sejdiu e konsideron fuqizimin e bashkësisë së krishterë në Kosovë si një parakusht kyç për harmoninë dhe tolerancën fetare. Prandaj, ai beson se institucionet shtetërore duhet të reagojnë me përgjegjësinë maksimale kundër të gjitha akteve publike që nxisin urrejtjen fetare. Përveç kësaj, shteti duhet të jetë një faktor i rëndësishëm në ndërtimin e profilit të qytetarëve të Kosovës në pajtim me traditën historike dhe në të njëjtën kohë edhe me trendet bashkëkohore. Sejdiu pohon se përderisa edhe vetë politikanët mund të jenë fetarë, ata nuk duhet të bëhen partnerë me elemente të rrejshme, të cilat nxisin bindje që janë në kundërshtim me shtetin sekular të Kosovës. Për më tepër, institucionet dhe partitë politike duhet t'u shmangen aleancave të fshehta me elementet radikale, të cilat promovojnë praktika fetare që janë të huaja për qytetarët e Kosovës.²²⁶

Për sa i përket përfshirjes së mësimit fetar në shkollat publike, Sejdiu pohon se edukata fetare duhet të prezantohet nga një kontekst tjetër, nga ai i lëndës së edukatës qytetare, duke promovuar filozofinë e paqes dhe vlerave njerëzore. Përndryshe, mësimet e tilla fetare mund të keqpërdoren për të promovuar disa agjenda të huaja, në veçanti kur mirret parasysh se cilat qarqe në Kosovë i kanë iniciuar dhe mbështetur idete e tilla. Nga ana tjetër, kur diskutohen faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që kanë kontribuar në shfaqjen e agjendave publike fetare, duke përfshirë radikalizmin, Sejdiu është i bindur se prania e çfarëdo faktori të jashtëm në Kosovë do të ishte e pamundur pa mbështetjen e brendshme. Në këtë drejtim, ai insiston se çdo shtet ka të drejtën sovraane që të kujdeset për sigurinë e vet dhe sigurinë e qytetarëve të saj. Prandaj, institucionet shtetërore, sidomos ato të sigurisë, duhet të veprojnë në mënyrë adekuate kundër çdo kërcënimi të radikalizmit. Informatat lidhur me rritjen e numrit të myslimanëve shqiptarë të Kosovës që kanë shkuar në Siri, si luftëtarë të huaj janë shqetësuese dhe duhet të merren seriozisht. Në fund, për sa i përket diskursit publik në lidhje me marrëdhënien në mes të përkatësisë fetare dhe përkatësisë etnike të shqiptarëve të Kosovës, Sejdiu konsideron se tani Kosova është përballë një nevoje të

²²⁵ Ibid.

²²⁶ Intervistë me Fatmir Sejdiun.

madhe për një qasje fetare, e cila do t'i bazonte rrënjët e vetë në praktikat tradicionale fetare. Praktikrat e tilla edhe pse ndër shekuj e kanë futur ndikimin e tyre fetar, asnjëherë nuk e kanë dëmtuar unitetin kombëtar në mesin e shqiptarëve. Në të kundërtën, Sejdiu ka frikë se qytetarët e Kosovës mund të bien pre e organizatave të huaja fetare, të cilat promovojnë praktika radikale fetare.²²⁷

Ngjashëm, sipas Ramush Haradinajt, qysh prej vitit 1999 praktikimi i fesë në Kosovë ka filluar të ndikohet nga tendencat globale nëpërmjet rrjeteve sociale dhe grupeve të ndryshme islamike që janë përhapur në vend. Këto trende janë intensifikuar edhe më tepër pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008 si rezultat edhe i mungesës së kornizës ligjore, por edhe neglizhencës së institucioneve të Kosovës. Një realitet i tillë e ka bërë Kosovën një tokë pjellore për aktivitetet e grupeve të ndryshme radikale. Mirëpo, Haradinaj beson se identiteti shqiptar është i ndërtuar në themele aq të forta, të cialt nuk mund të lëkunden nga ndikimet fetare. Ndërsa në sipërfaqe mund të duket se kjo gjë po ndryshon, këto ndryshime janë vetëm sezonale. Megjithatë, Haradinaj paralajmëron se duhet të tregohet kujdes ndaj grupeve radikale të Islamit, të cilat edhe pse nuk janë në gjendje të rrezikojnë thelbin e identitetit shqiptar, ato eventualisht mund ta shtrembërojnë atë. Shqiptarët tradicionalisht e kanë ushqyer një Islam shqiptar, i cili është më liberal, sa që edhe është quajtur evropian, dhe si i tillë ky Islam merret me vlera shpirtërore dhe ato të jetës dhe jo me Ligjin Islam – Sheriatin. Do të ishte për të ardhur keq nëse një formë e tillë e vlefshme e besimit zëvendësohet me një formë tjetër më radikale, sepse është pikërisht kjo formë e Islamit tolerant që i bën shqiptarët të veçantë, dhe një gjë e tillë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në identitetin tonë kombëtar. Në këtë kontekst, Haradinaj beson se partitë politike me karakter fetar janë të dëmshme për Kosovën, pasi që ato janë keqpërdorur nga grupet radikale Islame, duke përfshirë edhe Vëllazërinë Myslimane. Në mënyrë të ngjashme, ai është i bindur se nuk ka nevojë për futjen e edukatës fetare në shkollat publike të Kosovës, pasi kjo mund të keqpërdoret nga grupet radikale islame; në vend të kësaj religjioni mund të studiohet në kuadër të lëndës së edukatës qytetare.²²⁸

Për sa i përket faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të cilët kanë kontribuar në futjen e agjendave fetare publike, përfshirë edhe radikalizmin, Haradinaj shpjegon se edhe pse radikalizmi fetar Islamik e ka origjinën jashtë Kosovës, Kosova megjithatë paraqet interes për të. Kosova doli nga lufta me vështirësi ekonomike dhe pasiguri politike në lidhje me të ardhmen e saj, ndër të tjera për shkak të mosnjohjes nga pesë shtete anëtare të BE-së dhe Serbisë. Ky realitet ka prekur pjesë të caktuara të qytetarëve të Kosovës, pasi që proceset integruese dhe trajtimi i barabartë i Kosovës si shtet janë faktorë shumë të rëndësishëm për të luftuar radikalizmin Islamik. Për fat të keq, sipas

²²⁷ Ibid.

²²⁸ Intervistë me Ramush Haradinajn

Haradinajt në ditët e sotme Kosova, sikurse edhe pjesa tjetër e botës, përveç nevojës për t'u përballuar me radikalizmin Islamik, ajo është duke u përballur edhe me "luftëtarët Islamikë." Sa i përket faktorëve të brendshëm, Haradinaj beson se institucionet e Kosovës me neglizhencën e tyre kanë krijuar një politikë të mosndëshkimit ndaj udhëheqësve radikalë fetarë të cilët bëjnë deklaratata publike duke nxitur urrejtjen fetare. Politizimi i gjyqësorit dhe flirtimi i partive politike me grupe të tilla radikale, me qëllim të rritjes së bazës së tyre të mbështetjes, e kanë lehtësuar ekspozimin e tyre publik, i cili ka mbetur i pandëshkuar. Haradinaj është i bindur se dogmat lulëzojnë shumë me më shumë sukses në vende sikurse Kosova, e cila institucionet e veta i ka të dobëta dhe të korruptuara.²²⁹

Naim Tërri në anën tjetër beson se përkundër orientimit të duhur të bashkësive fetare dhe zotimit të tyre për të shpërndarë mësimet hyjnore, për të promovuar paqen, tolerancën dhe mirëkuptimin fetar, si dhe zotimit për të edukuar dhe fisnikëruar popullsinë, pas pavarësisë disa faktorë kanë kontribuar në paraqitjen e interpretimeve më të ngushta dhe më ekstreme të parimeve fetare. Ka disa faktorë që kanë çuar në interpretime të tilla që çojnë në ekstremizëm, duke filluar nga statusi i pa përkufizuar juridik i bashkësive fetare dhe infiltrimi i organizatave të huaja, deri te depërtimi i literaturës pa kriter përmes internetit dhe rrjeteve sociale. Për sa i përket rolit të bashkësive fetare në Kosovë në lidhje me identitetin shqiptar, Tërri thotë se komunitetet fetare kanë kontribuar në formimin dhe rritjen e identitetit të qytetarëve të Kosovës me parime hyjnore, humane dhe civilizuese. Në këtë mënyrë bashkësia fetare ka fisnikëruar qytetarët e Kosovës, duke i dhënë formë dhe duke e plotësuar identitetin e tyre. Nga ana tjetër, në lidhje me rolin e bashkësive fetare brenda një shteti sekular, Tërri konsideron se roli i bashkësive fetare në Kosovë është i rregulluar me Kushtetutë e cila edhepse garanton lirinë fetare, nuk e ka të zgjidhur statusin ligjor të bashkësive fetare.²³⁰

Sa i përket idesë së futjes së mësimet fetar në sistemin arsimor të Kosovës, Tërri potencon se BIK-u në disa raste e ka shpjeguar qëndrimin e vet në lidhje me këtë çështje. BIK-u është angazhuar për të futur mësimin fetar në shkollat publike të Kosovës për shkak se është e bindur se kjo gjë do të kontribuojë në edukimin e duhur të të rinjve të Kosovës, duke i larguar ata nga ndikimet e ideologjive të huaja. Për më tepër, një hap i tillë, sipas Tërri, do të sigurojë që fëmijët të marrin edukimin e duhur fetar, në frymën e tolerancës dhe të mirëkuptimit. Sa i përket diskutimit publik në lidhje me përkatësinë fetare dhe etnike të shqiptarëve në Kosovë, Tërri konsideron se diskursi i tillë politik është shpesh i paqartë, konfuz dhe nuk është i formuluar mirë. Ai e arsyeton këtë situatë me faktin se feja në Kosovë ende shikohet me premisat nga e

²²⁹ Ibid.

²³⁰ Intervistë me Naim Tërri.

kaluara, të cilat e trajtojnë fenë si diçka sekondare. Megjithatë, Tërnavë thotë se një qasje e tillë kohëve të fundit ka filluar të ndryshojë dhe shpreson se ka ardhur koha kur feja do të fillojë të trajtohet ashtu siç edhe e meriton. Ai pohon se nuk duhet ngatërruar fenë me etninë, por e sheh fenë si një element që e mbështet përkatësinë etnike dhe tërë popullsinë, duke siguruar që bashkësitë fetare dhe feja në përgjithësi të marrin rolin e tyre meritore në mesin e shoqërisë.²³¹

Sipas fjalëve të Don Shan Zefit, Kisha Katolike e Kosovës e ka mbështetur gjithmonë identitetin kombëtar të shqiptarëve sepse në çdo paraqitje publike përfaqësuesit e saj e kanë prezantuar veten si shqiptarë të fesë katolike. Në mënyrë të ngjashme, gjatë çdo predikimi në kisha dhe shkolla fetare theksohet se ne jemi shqiptarë dhe se i përkasim konfesionit katolik. Zefi gjithashtu konfirmon se marrëdhëniet në mes të bashkësisë së tyre fetare dhe BIK-ut kanë qenë tradicionalisht të mira dhe si të tilla edhe vazhdojnë të jenë. Ai gjithashtu pohon se vetëm pasi që BIK-u e ka kuptuar se format aktuale të radikalizmit Islamik, vëhabizmit dhe të terrorizmit janë të dëmshme për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndërfaqetare, ka filluar që përmes deklaratave zyrtare t'i dënojë aktet e tilla. Mirëpo, Zefi e pranon se edhe pse është i respektuar nga shumë myslimanë shqiptarë, sidomos nga intelektualët dhe studentët, ai shpesh ka qenë objekt i kërcënimeve nga Islamikët radikalë për shkak të përkatësisë së tij fetare. Për më tepër, Zefi deklaron se edhe gjatë sundimit serb ai ishte kërcënuar nga autoritetet serbe për shkak të angazhimit të tij në aktivitetet kombëtare shqiptare, ndërsa në ditët e sotme kërcënimet e tilla po ndodhin për shkak të përkatësisë së tij fetare.²³²

Sa i përket idesë së futjes së mësimi fetar në sistemin arsimor publik, Zefi ka potencuar se në parim Kisha Katolike nuk është kundër mësimi fetar në shkolla. Megjithatë, duke qenë të vetëdijshëm për problemet e shumta me të cilat vendi po përballet aktualisht, ai beson se tani për tani është më mirë, si për shtetin ashtu dhe për kombin, që mësimi fetar të mbetet brenda bashkësive fetare. Një arsyesim i tillë përforcohet më tepër me faktin se shqiptarët, në krahasim me shumicën e kombeve tjera, i përkasim tri feve të ndryshme. Prandaj, Zefi konstaton se në Kosovë, feja e ka vendin e vet, i cili është i ndarë nga shteti, dhe pasi që shkollat publike janë nën juridiksionin e shtetit, mësimi fetar duhet të zhvillohet vetëm brenda bashkësive fetare. Si një formë e kompromisit, Kisha Katolike sipas Zefit ka propozuar që mësimi fetar në shkolla të mësohet nga mësuesit laikë të historisë, dhe jo nga hoxhallarët apo priftërinjtë.²³³

Për sa i përket diskursit publik për marrëdhënien në mes të përkatësisë fetare dhe asaj etnike të shqiptarëve të Kosovës, Zefi konsideron se religjioni në Kosovë është duke u

²³¹ Ibid.

²³² Intervistë me Don Shan Zefin.

²³³ Ibid.

politizuar, kryesisht për përfitime politike dhe arsye financiare. Ai pohon se lakmia e shqiptarëve për para dhe pushtet i ka kontribuar radikalizmit në politikën e Kosovës. Për më tepër, sipas Zefit, për hir të përfitimeve politike dhe ruajtjes së pushtetit, partitë e mëdha politike hynë në koalicione joparimore, bile edhe me parti të atilla politike, të cilat do të duhej të ndalohen me kushtetutë. Këtu ndodh e kundërta sepse partitë e tilla islamike të cilat denigrojnë personalitetet më të shquara të kombit shqiptar tolerohen dhe institucionet mbesin të heshtura ndaj tyre. Zefi është i bindur se një neglizhencë dhe heshtje e tillë nga institucionet përgjegjëse është duke e dëmtuar jo vetëm shtetin e Kosovës, por edhe identitetin shqiptar. Në anën tjetër, sa i përket faktorëve të jashtëm që kanë kontribuar në radikalizmin Islamik në vend, Zefi thekson se ekzistojnë arsye të ndryshme gjeopolitike dhe gjeostrategjike, por janë edhe agjendat e fshehura Islame të vendeve si Arabia Saudite, Irani dhe Turqia. Në rastin e Turqisë, Zefi është i bindur se për sa kohë që vendi udhëhiqet nga partia aktuale politike Islamike që promovon më tepër fenë se sa çështjet e tjera, Kosova do të përjetojë ndikimin e rritur turk ndaj Islamit të saj tradicional.²³⁴

Në anën tjetër, njëjtë sikurse Kurti, edhe Femi Cakolli beson se arsyet se përse disa individë të caktuar të Kosovës i janë kthyer religjionit, ndërlidhen me zhgënjimin e tyre që lindi pas shpalljes së pavarësisë. Me fjalë të tjera, pas pritshmërive të mëdha, njerëzit e kuptuan se jo domosdoshmërisht pavarësia do të përmirësonte standardin e tyre të jetesës, se nuk do të sillte më shumë rrymë dhe se nuk do të zgjidhte problemet e tyre të papunësisë. Në një situatë të tillë të pakënaqësisë publike sociale dhe ekonomike, Cakolli shpjegon se është normale që njerëzit të kthehen kah feja. Megjithatë, problemi fillon kur këta individë manipulohen nga organizata të huaja radikale përmes promovimit të vlerave fetare që më parë kanë qenë të panjohura për kosovarët. Cakolli është i bindur se e tërë ikonografia, e cila është shfaqur gjatë protestave me anë të cilave ishte kërkuar futja e mësimin fetar dhe shamisë në shkollat publike, nuk ishte tipike për Kosovën, por më tepër një gjë e importuar nga jashtë. Aktivitetet e këtyre organizatave së bashku me zhgënjimin e mëtejshëm të qytetarëve për shkak të korrupsionit dhe krimin kanë ndikuar në radikalizimin e ngadalshëm të një numri të caktuar të myslimanëve shqiptarë të Kosovës. Si dëshmi për realitetin e tillë Cakolli përmend deklaratat publike denigruese dhe fyese që ishin dhënë kundër Skënderbeut, Nënës Terezë dhe katedrales së qytetit.

Për sa i përket rolit të bashkësive fetare të Kosovës, Cakolli potencon se përderisa është e qartë se çdo bashkësi është e interesuar në përhapjen e religjionit, Kisha Protestante beson se sekularizmi paraqet instrumentin e vetëm i cili do të garantonte barazinë e të gjitha bashkësive fetare. Ai gjithashtu beson se një shtet sekular duhet të jenë më i kujdesshëm në shfaqjen publike të simboleve fetare. Sipas Cakollit, në ditët e

²³⁴ Ibid.

sotme në kundërshtim me praktikat e një shteti sekular, individë të caktuar në emër të demokracisë dhe të drejtave të njeriut shfrytëzojnë hapësirat publike, si zyrat qeveritare, universitetet, shkollat, bibliotekat dhe konviktet për kryerjen e lutjeve (faljes). Praktika të tilla janë të mbështetura dhe inkurajuara nga organizata të ndryshme radikale Islamike, duke përfshirë edhe disa individë brenda vetë BIK-ut. Cakolli shpjegon se bashkësia e tij është kundër futjes së edukimit fetar në shkollat publike pasi që një gjë e tillë mund të keqpërdoret nga organizata dhe individë me agjenda radikale fetare. Përveç kësaj, ai pretendon se mësimet e tilla fetare vetëm se do të ndajnë fëmijët mbi bazat fetare, një realitet që do të ketë ndikim negativ sidomos tek fëmijët që i përkasin feve të pakicave. Cakolli beson se edhe pa arsim të tillë fetar toleranca fetare është përkeqësuar dukshëm, dhe se djali i tij tashmë ka marrë kërcënime me vdekje në shkollën e tij.²³⁵

Për sa i përket faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të cilët kanë kontribuar në futjen e agjendave fetare publike, përfshirë edhe radikalizmin, Cakolli thekson se Kosova nuk është një ishull i izoluar dhe për këtë arsye është e mjaft e ndjeshme ndaj ndikimeve të jashtme globale. Rrjetet transnacionale globale Islame kanë ndikuar edhe në Kosovë, duke i kontribuar edhe radikalizmit. Megjithatë, Cakolli thotë se në politikat e tilla agresive, ndër të tjera, ka ndikuar edhe konvertimi i një numri të madh të myslimanëve në krishterim nëpër tërë botën. Si reagim ndaj tendencave të tilla, rrjetet transnacionale të Islamit radikal kanë tendencë për të frikësuar myslimanët me anë të dhunës dhe kaosit siç edhe është dëshmuar kohët e fundit nga ISIS-i. Cakolli beson se partitë politike janë faktori më i rëndësishëm i brendshëm, i cili ka ndikuar në radikalizmin Islamik. Ai vë në pah se janë pikërisht partitë e mëdha politike që kanë kontribuar në shfaqjen e Islamit politik në Kosovë, duke koketuar vazhdimisht me grupet radikale me qëllim të përfitimeve politike. Si dëshmi, Cakolli përmend krijimin e Partisë Islamike të Drejtësisë dhe bashkëpunimin e PDK-së dhe partive të tjera politike me këtë entitet.²³⁶

Në fund Cakolli komenton edhe në lidhje me diskursin publik për sa i përket marrëdhënies në mes të përkatësisë fetare dhe asaj etnike të shqiptarëve të Kosovës. Sipas tij, shqiptarët e Kosovës çdo ditë e më tepër po bëhen më fetarë, dhe çdo herë e më pak shqiptarë. Cakolli deklaron se niveli i shqiptarisë është duke rënë shpejtë në Kosovë, dhe se madje edhe gjatë komunizmit shqiptarët kanë qenë më shqiptarë se sa që janë sot. Ai shpjegon se në Kosovë armiku i Islamit radikal nuk është krishterimi, por shteti sekular dhe nacionalizmi shqiptar. Prandaj, aktivitetet e radikaleve të Islamit janë të orientuara drejt dobësimit të këtyre dy elementeve. Qindra të rinj kosovarë janë duke studiuar në Turqi, Arabi Saudite dhe vende të tjera myslimane. Në Kosovë simbolet fetare janë më të dukshme se kurdo herë më parë. Përveç Facebook-ut dhe rrjeteve të tjera sociale, të rinjtë myslimanë shqiptarë ecin me krenari nëpër rrugët e qytetit me

²³⁵ Intervistë me Femi Cakollin

²³⁶ Ibid.

fanella të shtypura me mbishkrimin "Jam krenar që jam Mysliman". Sipas Cakollit ky është një reagim dhe provokim i hapur ndaj shprehjes së famshme kombëtare shqiptare "Jam krenar që jam Shqiptar", e që paraqet një dëshmi të qartë se Islami radikal në Kosovë është në konflikt të hapur me sekularizmin dhe nacionalizmin shqiptar.²³⁷

Xhabir Hamiti ka ofruar perspektivën e tij akademike, sipas së cilës menjëherë pas pavarësisë së shpallur në vitin 2008, Kosova kryesisht ishte e preokupuar me konfigurimin dhe strukturimin e shtetit të saj të ri dhe me avancimin ndërkombëtar të shtetësisë së saj. Duke qenë të preokupuar me shtetësinë dhe pozicionimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare, institucionet e Kosovës kishin neglizhuar fillimisht çështjen e propagandës fetare të ekstremizmit dhe radikalizmit të fuqishëm. Si rezultat, organizata të huaja fetare radikale në bashkëpunim me individë të caktuar brenda Kosovës kanë arritur që lirshëm t'i ushtrojnë veprimtaritë e tyre nëpër të gjithë vendin. Një neglizhencë dhe apati e tillë e autoriteteve shtetërore në drejtim të rritjes së gjuhës së urrejtjes fetare ka vazhduar deri në kohën kur vullnetarët kosovarë kanë filluar të marrin pjesë në luftërat e Sirisë dhe Irakut, si pjesë e ISIS-it dhe fraksioneve të tjera radikale islame. Një problem shtesë në këtë drejtim, sipas Hamitit, ishte pozita e parregulluar ligjore e bashkësive fetare në Kosovë dhe mungesa e mbështetjes ndaj imamëve më tradicionalë dhe të moderuar brenda BIK-ut nga ana e autoriteteve shtetërore. Këta dy faktorë ndër vite kanë krijuar hapësirë që individët dhe grupet e ndryshme të manipulojnë me qytetarët e Kosovës në emër të fesë. Përveç kësaj, duke qenë se shpesh qytetarët janë shtyrë drejt ekstremizmit, Hamiti beson se këto elemente radikale kanë kontribuar në një imazh mjaft negativ të Kosovës në raport me botën e qytetëruar.²³⁸

Për sa i përket rolit të bashkësive fetare në Kosovë në lidhje me identitetin shqiptar, Hamiti është i bindur se bashkësitë fetare janë të detyruara të mbajnë mësimet e tyre fetare në shërbim të vendit dhe të kombit, pasi në fund të fundit anëtarët e tyre përbehen nga bijtë dhe bijat e këtij vendi. Megjithatë, në qoftë se këto bashkësi punojnë në favor të agjendave të ndryshme të huaja, atëherë ato nuk mund të pretendojnë se janë duke e përfaqësuar as identitetin shqiptar dhe as Perëndinë, sepse edhe Perëndia i njeh kombet. Hamiti thekson se në të kaluarën përkatësia fetare asnjëherë nuk ju ka mohuar shqiptarëve identitetin e tyre kombëtar, përkundër shumë përpjekjeve gjatë historisë nga ana e të tjerëve për të arritur pikërisht këtë qëllim. Nga ana tjetër, kur bëhet fjalë për rolin e bashkësive fetare në një shtet sekular si Kosova, Hamiti, para së gjithash beson se bashkësitë fetare nuk janë një shtet brenda shtetit, por janë më shumë pjesë e shoqërisë, e cila e përbën shtetin. Prandaj, bashkësitë fetare nuk duhet të jenë pengesë për avancimin e Kosovës dhe vlerave të saj demokratike evropiane.

²³⁷ Ibid.

²³⁸ Intervistë me Xhabir Hamitin

Megjithatë, Kosova si shtet sekular duhet të garantojnë të drejtat dhe liritë fetare për të gjithë qytetarët e saj, dhe duhet të trajtojë të gjitha bashkësitë fetare në shoqëri në mënyrë të barabartë. Nga ana tjetër, bashkësitë fetare duhet të jenë në shërbim të besimtarëve dhe të qëndrojnë larg nga përfshirja politike brenda shtetit.

Hamiti gjithashtu ka shprehur mendimin e tij në lidhje me faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të cilët kanë kontribuar në futjen e agjendave fetare publike, përfshirë edhe radikalizmin. Sipas Hamitit, faktor të tillë kontribues mes tjerash janë: (a) situata kaotike e pas luftës në Kosovë; (b) situata e vështirë ekonomike dhe sociale; (c) jostabiliteti dhe brishtësia politike e vendit; (d) mungesa e vigjilencës së duhur e faktorëve vendimmarrës të shtetit ndaj lëvizjeve fetare me agjenda të huaja fetare dhe politike; (e) indiferenca dhe heshtja e komuniteteve tradicionale fetare kundër propagandës fetare me elemente radikale dhe ekstreme; (f) mungesa e rregullimit ligjor dhe ekzistenca e vakumit ligjor në lidhje me përgjegjësitë dhe të drejtat e bashkësive fetare në kuadër të shtetit; (g) neglizhenca dhe politika e dyerve të hapura ndaj shoqatave të shumta të huaja dhe organizatave me agjenda fetare dhe politike.²³⁹

Në fund, kur bie fjala për diskursin publik sa i përket marrëshënies mes përkatësisë fetare dhe asaj kombëtare të shqiptarëve të Kosovës, Hamiti konsideron se bashkësitë fetare dhe në veçanti BIK-u, si bashkësia më e madhe, duhet të jenë të zotuar ndaj qëndrueshmërisë, stabilitetit dhe zhvillimit të vendit dhe shoqërisë, dhe nuk duhet të zhvillojnë agjenda të cilat kanë për qëllim të dominojnë mbi anëtarët e bashkësive të tjera. Prandaj, të gjitha bashkësitë fetare duhet të kultivojnë elemente që u shërbejnë interesave të përbashkëta të kombit dhe të ardhmes së vendit të tyre. Hamiti është i bindur se identiteti ynë kombëtar dhe fetar është i frytshëm vetëm kur ne jemi të bashkuar si në kohë të mira ashtu edhe në kohë të këqija, dhe sa herë që paraqitet nevoja të mbrojmë shoqërinë dhe atdheun tonë. Në fund të fundit, ne jemi vëllezër të të njëjtit gjak, ne ndajmë të njëjtin komb dhe të njëjtën gjuhë, ndërsa përkatësia fetare është një zgjedhje e lirë dhe vlerë individuale e secilit prej nesh që duhet vlerësuar dhe respektuar. Prandaj, sipas Hamitit, thirrjet për t'iu kthyer identitetit fetar të së kaluarës nuk i shërbejnë as të tashmes sonë dhe as të ardhmes sonë.²⁴⁰

Edhe pse vetë është katolik, Anton Berishaj insiston se nuk ndihet i kërcënuar nga grupet e ndryshme radikale Islame në Kosovë pasi që ato paraqesin vetëm një grup minoritar të shoqërisë kosovare. Sipas perceptimit të tij të bazuar në analizën e tij, përqindja e popullsisë së Kosovës që ka prirje drejt radikalizmit nuk është më e madhe se 3 për qind, përqindje e cila sigurisht se nuk duhet të jetë shqetësuese. Megjithatë ai pranon se rritja e religjiozitetit dhe në veçanti e radikalizmit fetar mund të rrezikojë

²³⁹ Ibid.

²⁴⁰ Ibid.

marrëdhëniet e mira ndër-fetare mes shqiptarëve të Kosovës. Sa i përket zhvendosjes eventuale të identitetit të shqiptarëve të Kosovës nga ai kombëtar në fetar, Berishaj beson se së pari duhet të gjendet përgjigja për pyetjen se çfarë nënkupton identiteti shqiptar. Ai na përkujton se feja ishte pjesa e marginalizuar dhe e ngulfatur e identitetit të shqiptarëve. Rilindasit shqiptarë kanë promovuar një nocion sipas të cilit sa më shumë që je myslimanë apo i krishterë, aq më pak je shqiptar. Mirëpo, Berishaj konsideron se aktualisht pretendimet e tilla janë të parëndësishme dhe të panevojshme për shqiptarët.

Është e qartë se pas luftës në vitin 1999, një numër i faktorëve të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm ka kontribuar në rritjen e rolit të fesë në mesin e shqiptarëve të Kosovës. Si rezultat i kësaj, marrëdhëniet ndër-fetare janë zhvendosur nga homogjenizimi shoqëror dhe bashkëpunimi ndër-fetar gjatë viteve 1989-1999, me anë të fragmentimit dhe rritjes së religjiozitetit gjatë vitetve 1999-2008, në radikalizimin e një pjese të shoqërisë pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008. Për fat të keq, institucionet dhe në përgjithësi shoqëria e Kosovës për një kohë mjaft të gjatë i kanë lënë pas dore shenjat publike të radikalizimit të Islamit në vend. Vetëm kur shqiptarët myslimanë nga Kosova filluan në numër të madh t'i bashkohen ISIS-it në Siri dhe Irak si luftëtarë të huaj, institucionet e përgjumura kosovare filluan të veprojnë. Disa individë radikalë janë burgosur dhe dënuar, ndërkohë që janë miratuar edhe disa masa shtesë legislative. Mirëpo, siç është ilustruar edhe nga artikulli i fundit të publikuar nga New York Times dhe Raporti i Departamentit të Shtetit mbi Terrorizmin, situata është komplekse dhe aspak e kënaqshme. Sidomos meqë për shkak të kombinimit të faktorëve të ndryshëm të jashtëm dhe të brendshëm, lojaliteti i shqiptarëve të Kosovës që nga pavarësia dalëngadalë është zhvendosur nga Shqiptaria dhe shteti i Kosovës në një identitet fetar me karakter ekskluziv etno-religjioz, shpesh madje edhe me primesa të Islamit radikal.

IV. Analiza e hulumtimit të opinionit publik

Hulumtimi i opinionit publik në këtë projekt është bërë për t'i testuar gjetjet e hulumtimit kualitativ dhe për t'i komplementuar ato me të dhëna kuantitative, dhe atë përmes fitimit të një pasqyre fillestare të raporteve midis identitetit shqiptar dhe kosovar, identitetit shqiptar dhe atij fetar, si dhe të distancës socio-religjioze ndërmjet shqiptarëve të Kosovës. Hulumtimi i opinionit publik është realizuar nga kompania e kontraktuar nga KIPRED-i, UBO Consulting, gjatë muajve shkurt – mars 2016, me 1000 respondentë në të gjitha rajonet e Kosovës, dhe atë me 720 shqiptarë myslimanë (488 jo-praktikues dhe 232 praktikues) dhe 280 shqiptarë të krishterë (118 jo-praktikues dhe 162 praktikues). Mostra e respondentëve nuk është ndarë sipas proporcionit në popullatën shqiptare, nominalisht myslimane dhe të krishterë, me qëllim të fitimit të një pasqyre më të qartë për çështjet identitare brenda komunitetit të krishterë.

Me qëllim të identifikimit të raportit midis identitetit shqiptar dhe kosovar, përkatësisht atij etnik dhe shtetëror, respondentëve u është shtruar pyetja “Cila nga këto kategori e përshkruan më së miri se çfarë e ndjeni veten?” me opsionet e përgjigjeve vijuese: a) Shqiptar, pastaj kosovar; b) Kosovar, pastaj shqiptar; c) Shqiptar; dhe d) Kosovar. Në analizën e mëtutjeshme, me shprehjen identitet kumulativ shqiptar do të nënkuptojmë respondentët që janë identifikuar me përgjigjet a dhe c, ndërkaq, me identitet kumulativ kosovar ata që janë identifikuar me përgjigjet b dhe d.



Për të identifikuar raportin midis identitetit shqiptar dhe atij fetar, domethënë, nivelin e fetarizimit të identitetit etnik, respondentëve u është shtruar pyetja “Cila nga këto kategori e përshkruan më së miri se çfarë e ndjeni veten?” me opsionet e përgjigjeve vijuese: a) Mysliman/i krishterë, pastaj shqiptar; b) Shqiptar, pastaj mysliman/i krishterë; c) Mysliman/i krishterë; dhe d) Shqiptar. Në analizën e mëtutjeshme, me shprehjen identitet kumulativ fetar do t'i nënkuptojmë respondentët që janë identifikuar me përgjigjet a dhe c.

Ndërkaq, distanca socio-religjioze midis shqiptarëve myslimanë dhe të krishterë, është matur përmes aplikimit të shkallës së Bogardusit për distancës sociale, me ç'rast respondentëve u është shtruar pyetja vijuese “Deri ku shkon afërsia që ndjeni për shqiptarët e fesë tjetër”, me opsionet e përgjigjeve vijuese: a) do të pranoja të martohesha me ndonjë prej tyre; b) do të pranoja t'i kem shokë shumë të ngushtë; c) do të pranoja të punoj me ta në të njëjtën zyre; d) do të pranoja t'i kem fqinjë; e) do të pranoja vetëm të flas me ta; f) do të preferoja të mos i kem fqinjë; g) do të preferoja që në shtetin tim të mos jetë asnjë prej tyre. Në analizën e mëtutjeshme, me shprehjen distancë kumulative pozitive do t'i nënkuptojmë respondentët që janë identifikuar me

përgjigjet a, b, c dhe d – që reflektojnë distancën e Bogardusit nga 1 deri në 4, ndërsa me shprehjen distancë kumulative negative do t'i nënkuptojmë respondentët që janë identifikuar me përgjigjet e, f dhe g – që reflektojnë distancën prej 5 deri në 7, dhe me jotolerancë ekstreme do t'i nënkuptojmë respondentët që identifikohen me përgjigjen g. Rezultatet e hulumtimit tregojnë që me identitetin kumulativ shqiptar identifikohen 65.6% të respondentëve, dhe ky është për 22.4% më i lartë se identiteti kumulativ kosovar, me të cilin identifikohen 34.4% të respondentëve.




Për sa i përket nivelit të fetarizimit identitar, rezultatet tregojnë që ky është më i lartë te shqiptarët myslimanë se te ata të krishterë. Identiteti kumulativ fetar (ata që ndjehen së pari myslimanë, dhe pastaj shqiptar, si dhe ata që ndjehen vetëm myslimanë) te shqiptarët myslimanë e kanë 34.5% të respondentëve, ndërkaq, te shqiptarët e krishterë (ata që ndjehen së pari si të krishterë, dhe pastaj shqiptarë, si dhe ata që ndjehen vetëm të krishterë) e kanë 22.1% e respondentëve.




Po ashtu, vërehet edhe një trend mjaft negativ për sa i përket distancës socio-fetare, ku 5.8% e respondentëve pranojnë vetëm të flasin me shqiptarët e konfesionit tjetër, 4.8% e tyre preferojnë që të mos i kenë fqinjë, dhe 1.4% e tyre preferojnë që në Kosovë të mos jetë asnjë prej tyre. Pra, distancë kumulative fetare negative kanë 12% e

respondentëve, një fakt ky që vë në pah një jotolerancë të theksuar socio-fetare midis shqiptarëve të Kosovës.



Gjetjet e hulumtimit tregojnë që distanca socio-fetare e përgjithshme e shqiptarëve myslimanë (DS=3.13) është më e madhe se ajo e atyre katolikë (DS=2.51), si dhe atë që distanca socio-fetare e myslimanëve praktikues (DS=3.07) është më e vogël se ajo e jopraktikuesve (DS=3.12), nga njëra anë, dhe që, nga tjetra, distanca socio fetare e krishterëve praktikues (DS=2.58) është më e madhe se ajo e atyre jo-praktikues (DS=2.40). Po ashtu, distanca negative socio-fetare te shqiptarët e krishterë është shumë më e vogël se ajo te shqiptarët myslimanë, edhe përkundrejt faktit që ata në Kosovë janë pakicë. Te shqiptarët myslimanë, distancë socio-religjioze pozitive kanë 84.9%, ndërsa negative 15.1% të respondentëve, dhe jotolerancë ekstreme 1.7% e tyre, ndërsa tek shqiptarët e krishterë, distancë pozitive socio-religjioze kanë 95.7%, dhe negative 4.3% e respondentëve, ndërsa jotolerancë ekstreme 0.7% e tyre.





Këtu duhet theksuar faktin tejet interesant që te shqiptarët myslimanë praktikues, distanca socio-fetare pozitive është më e lartë, ndërsa distanca negative dhe jotoleranca ekstreme janë më të ulëta, se te shqiptarët myslimanë jopraktikues. Te shqiptarët myslimanë jo-praktikues distancë pozitive kanë 84.0%, dhe distancë negative 16.0% e respondentëve, ndërsa jotolerancë ekstreme kanë 9.6% e tyre. Ndërsa tek



shqiptarët myslimanë praktikues, distancë pozitive kanë 86.6%, negative 13.4% dhe jotolerance ekstreme 4.7% të respondentëve. Në anën tjetër, te shqiptarët e krishterë praktikues dhe jo-praktikues trendet janë përafërsisht të njëjta, dhe më pozitive se te shqiptarët myslimanë praktikues dhe jo-praktikues. Kështu, te shqiptarët e krishterë praktikues, distancë pozitive kanë 96.6%, negative 3.4% dhe intolerancë ekstreme 2.5% të respondentëve, ndërsa, te ata praktikues, distancë pozitive kanë 95.1%, negative 4.9% dhe intolerancë ekstreme 1.2% të respondentëve.

Hulumtimi i bërë e shpalos, po ashtu, edhe një ndërlidhje midis fetarizimit dhe identitetit kosovar në raport me rajonet e Kosovës dhe moshën e respondentëve.


Në raport me rajonet e tjera të Kosovës, shqiptarët myslimanë jo-praktikues të rajonit të Mitrovicës dhe Prizrenit kanë shkallën më të lartë të identitetit kumulativ kosovar, dhe atë 59.0% dhe 58.3% të respondentëve respektiv, dhe këta e kanë, po ashtu, edhe shkallën më të lartë të identitetit kumulativ fetar, dhe atë 44.8% dhe 36.1% të respondentëve respektiv, dhe pas tyre vjen rajoni i Gjilanit me 36.0% të respondentëve.




Trend i ngjajshëm vërehet edhe te shqiptarët myslimanë praktikues, ku identitetin më të lartë kumulativ kosovar e kanë rajoni i Mitrovicës dhe ai i Prizrenit, dhe atë 55.6% dhe 50.0% të respondentëve respektiv, ndërsa, identitetin kumulativ fetar më të lartë e kanë rajoni i Gjilanit me 74.1%, i Mitrovicës me 63.0%, dhe ata të Prizrenit dhe Pejës me 61.5% të respondentëve respektiv.



Nga ana tjetër, te shqiptarët e krishterë jo-praktikues, nivelin më të lartë të identitetit kumulativ kosovar e kanë rajoni i Gjilanit me 76.5% dhe ai i Gjakovës me 43.3% të respondentëve, ndërsa nivelin më të lartë të fetarizimit – të identitetit kumulativ fetar – e ka rajoni i Gjilanit me 35.3% të respondentëve.



Ndërkaq, te të krishterët praktikues, nivelin më të lartë të identitetit kumulativ kosovar e ka rajoni i Gjilanit me 81.5% të respondentëve, ndërsa nivelin më të lartë të fetarizimit – të identitetit kumulativ fetar, e ka rajoni i Gjakovës me 38.2% të respondentëve.



Për sa i përket moshës, si te jopraktikuesit, ashtu edhe te praktikuesit myslimanë, shkallën më të lartë të identitetit kumulativ kosovar e kanë grup-moshat nën 24 vjet, me 54.7%, gjegjësisht 47.0% të respondentëve, dhe ajo 25-34 vjet, me 41.0%, gjegjësisht 45.8% të respondentëve. Ndërkaq, nivelin më të lartë të fetarizimit - identiteti kumulativ fetar – te shqiptarët myslimanë jo-praktikues, e kanë grup-moshat 25-34 vjet me 33.6%, mbi 65 vjet me 33.3%, dhe nën 24 vjet me 29.5% të respondentëve, kurse te praktikuesit, grup-moshat nën 24 vjet me 50.3%, 35-44 vjet me 51.35, dhe 25-34 vjet me 49.2% të respondentëve. Këtu është interesant edhe fakti që intolerancën ekstreme më të lartë te shqiptarët myslimanë jo-praktikues e ka grup-mosha më e re se 24 vjet, me 4.1% të respondentëve, ndërkaq, te ata praktikues, grup-mosha 25-34 vjet me 3.4% të respondentëve.

Te shqiptarët e krishterë, nuk vërehet ndonjë ndërlidhje ndërmjet grup-moshave në raport me identitetin kosovar dhe nivelin e fetarizimit etnik. Identitetin më të lartë kumulativ kosovar të krishterët jo-praktikues e kanë grup-moshat 35 – 44 vjet, me 57.1%, dhe 45 -54 vjet me 55.6% të respondentëve , ndërkohë që te të krishterët praktikues, e ka grup-mosha 55-46 vjet me 57.1% të respondentëve. Nga ana tjetër, te shqiptarët e krishterë jo-praktikues, fetarizimin më të lartë (identitetin kumulativ fetar) e ka grup-mosha 55-64 vjet (40.0%), ndërkaj, te praktikuesit grup-mosha 35-44 vjet me 50.00%, dhe ajo 45-54 vjet me 38.1% të respondentëve. Nga ana tjetër, një gjetje shumë interesante është që te shqiptarët e krishterë jo-praktikues nuk ka intolerancë ekstreme, ndërkohë që te ata praktikues, grup-mosha me intolerancën ekstreme më të lartë është ajo 35-44 vjet, me 4.5% të respondentëve.

Një tjetër rezultat interesant i hulumtimit është ndërlidhja e viteve të shkollimit me nivelin e identitetit kumulativ fetar të shqiptarëve të Kosovës. Te myslimanët jo-praktikues, fetarizimi më i lartë (identiteti kumulativ fetar) vërehet te personat me 5-8 vjet shkollim me 41.8%, dhe te ata me 9-12 vjet shkollim me 27.7% të respondentëve. Ndërkaj, te myslimanët praktikues, fetarizimi më i lartë vërehet te personat me mbi 13 vjet shkollim me 54.2% të respondentëve. Nga ana tjetër, te shqiptarët e krishterë jo-praktikues, fetarizimi më i lartë vërehet te personat me 5-8 vjet shkollim me 20.0% të respondentëve, dhe te të krishterët praktikues te ata me 5-8 vjet shkollim me 52.4%, dhe me nën 4 vjet shkollim 50.0% të respondentëve.

Një gjetje shumë e rëndësishme e hulumtimit është ajo që rajoni i Prishtinës shfaqet si një që e ka distancën më të lartë negative, si te shqiptarët myslimanë, ashtu edhe te ata të krishterë, ndërsa ai i Gjakovës me intolerancën më të lartë ekstreme. Distancën socio-fetare më të lartë negative te shqiptarët myslimanë jopraktikues e ka rajoni i Mitrovicës me 43.3%, dhe ai i Prishtinës me 22.1% të respondentëve, ndërsa intolerancën ekstreme më të lartë e ka rajoni i Gjakovës me 3.8% të respondentëve. Te shqiptarët myslimanë praktikues, rajoni i Mitrovicës dhe ai i Gjilanit e kanë distancën socio-fetare më të lartë negative me 18.5 %, dhe pas tyre vjen ai i Prishtinës me 18.3% të respondentëve, ndërsa intolerancën ekstreme më të lartë e ka rajoni i Gjakovës me 4.3% të respondentëve. Te të krishterët jo-praktikues distancën socio-fetare negative më të lartë e ka rajoni i Prishtinës me 6.3%, dhe ai i Gjilanit 5.9% të respondentëve, ndërsa tek praktikuesit, distanca negative vërehet vetëm në rajonin e Gjakovës, dhe atë me 23.5% të respondentëve, si dhe me intolerancë ekstreme te 5.9% e tyre.

Për më tepër, rezultatet e hulumtimit tregojnë që standardi jetësor nuk është përcaktues për bashkëjetesën apo intolerancën fetare. Te shqiptarët myslimanë jopraktikues distancën socio-fetare negative më të lartë e kanë ata që realizojnë të ardhura mujore mbi 1201 €, me 24.25% të respondentëve, si dhe me intolerancë ekstreme te 3% e tyre,

mëpastaj vijnë ata me të ardhura 601-750 €, me 22.6% të respondentëve, dhe me intolerancë ekstreme të 3.2% e tyre, dhe ata që nuk kanë realizuar të ardhura fare me 22.2% të respondentëve, dhe me intolerancë ekstreme të 3.7% e tyre. Ndërkaq, të shqiptarët myslimanë praktikues, distancën socio-fetare negative më të lartë e kanë ata me të ardhura prej 901 – 1200 €, me 25% të respondentëve dhe me intolerancë ekstreme të 12.5% e tyre, mëpastaj vijnë ata me të ardhura mbi 1201 €, 301-450 €, 0-150 €, që të gjithë me 20% të respondentëve, dhe këta të fundit me intolerancë ekstreme të 10% e tyre. Në anën tjetër, të krishterët jopraktikues distancën socio-fetare negative më të lartë e kanë ata me të ardhura prej 301-450 € me 12.5% të respondentëve, ndërkaq, të praktikuesit distancën socio-fetare negative më të lartë e kanë ata që nuk kanë deklaruar të ardhura, me 31.8% të respondentëve dhe me intolerancë ekstreme të 4.5% e tyre.

Në fund, mund të konkludojmë që ky hulumtim i ka shpalosur disa fenomene tejet interesante, dhe ka hapur një numër çështjesh që do të mund të sqarohen vetëm me kërkime të mëtutjeshme. Në këtë aspekt, çështje prioritare që kërkojnë hulumtime të mëtutjeshme janë ndërlidhja e trendeve të fetarizimit me ato të identitetit kosovar, si në aspektin e moshës, nivelit të shkollimit, ashtu edhe në atë të rajoneve; harmonia apo përplasja midis identitetit shqiptar dhe atij kosovar; mungesa e ndërlidhjes së intolerancës socio-fetare me nivelin e standardit jetësor dhe me atë të shkollimit, si dhe arsyet e intolerancës socio-fetare midis shqiptarëve myslimanë dhe të krishterë në rajonet e Mitrovicës, Prishtinës, Gjilanit dhe Gjakovës.

V. Përfundime dhe Rekomandime

Kuptimi i zhvillimit të natyrës sekulare të identitetit kombëtar shqiptar paraqet pikën fillestare të analizimit të ndikimit të religjionit në ndërrimin e identitetit etnik të shqiptarëve të Kosovës, të cilët, gjatë shekullit të kaluar, vazhdimisht kanë kultivuar sekularizmin dhe bashkëjetesën fetare si një instrument i nacionalizmit vetëmbrojtës.

Procesi i Rilindjes Kombëtare filloi si një fenomen i elitari, gjegjësisht si një lëvizje lartë-poshtë kulturore. Përveç vonesës së tij, nacionalizmi shqiptar ka pasur edhe një veçori tjetër të veçantë krahasuar me popujt e tjerë të Ballkanit – ky nacionalizëm ishte sekular si në origjinë ashtu edhe në karakter. Disa faktorë të rëndësishëm dhe të ndërthurur në mes vete e kanë formësuar nacionalizmin shqiptar, dhe kanë kontribuar si në vonesën po ashtu edhe në sekularizmin e tij. Pikësëpari, në rastin e shqiptarëve, feja ishte më tepër një faktor përçarës se sa faktor uniteti. Në fakt, mos ekzistenca e një religjioni të përbashkët, ishte një element i rëndësishëm që pati ndikim domethënës në vonesën

dhe sekularizmin e nacionalizmit shqiptar. Gjerësa, në rastet e tjera të nacionalizmave të Ballkanit, religjioni si një faktor i unifikimit i popullatave, luajti një rol pozitiv në zhvillimin e nacionalizmit, në rastin e shqiptarëve padyshim ka pasur një rol përçarës. Pasi Perandoria Osmane dhe fqinjët e saj insistonin që të bënin ndarjen e shqiptarëve sipas linjave të tyre fetare, për rilindësit shqiptarë ishte vendimtare tejkalimi i ndasive fetare duke zgjedhur një identitet sekular nacional, i cili do të ishte i bazuar në “unifikimin kulturor dhe gjuhësor”. Prandaj, sekularizmi – fillimisht duke qenë së pari shqiptar, shoqëruar me bashkëjetesën fetare, u bë tipar kyç i nacionalizmit shqiptar.

Gjatë sundimit pothuajse 90 vjeçar të Jugosllavisë/Serbisë, nacionalizmi shqiptar në Kosovë vazhdoi të ishte sekular për nga natyra. Një realitet i tillë shtroi trasenë e një nacionalizmi të ri shqiptar në Kosovë, dhe i strukturoi referencat e tija kolektive si vetëmbrojtje e identitetit etnik, që i kundërvihej fetarizimit që përdorej si një instrument për asimilim. Procesi i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë dhe beteja për pavarësi gjatë periudhës 1989-1999 shënoi homogjenizmin më të fortë shoqëror të shqiptarëve të Kosovës. Tiparet kryesore të nacionalizmit shqiptar gjatë kësaj kohe u karakterizuan me një orientim pro-perëndimor dhe me një unifikim të përgjithshëm të shqiptarëve pavarësisht prej sfondit shoqëror apo fetare. Gjithashtu, në këtë periudhë, udhëheqësit e bashkësive fetare në Kosovë kanë bashkëpunuar në mënyrë aktive me elitën politike dhe strukturat e tjera relevante për të avancuar pozitën e shqiptarëve dhe të Kosovës.

Megjithatë, pas çlirimit dhe vendosjes së Administratës së Kombeve të Bashkuara, ngjashëm me vendet e tjera ish-komuniste, rigjallërimi i religjionit filloi edhe në Kosovë. Rrethanat e reja në mënyrë të pashmangshme kanë shkaktuar një proces të transformimit dhe ridefinimit të pozitës së religjionit. Prezenca e Islamit dhe Krishterimit u bënë të dukshme dhe të theksuara në të gjitha sferat publike, duke filluar nga jeta personale deri në shoqërinë e gjerë, përfshirë edhe politikën. Në të njëjtën kohë, bashkësitë fetare përfituan mundësi të reja për një rigjallërim fetar dhe kulturor, si dhe për mobilizim politik.

Në Kosovë, procesi i rigjallërimit fetar pas vitit 1999 ishte rezultat i bashkëveprimit të shumë faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Pasojat e luftës kishin krijuar rrethana të shumëta në vitet e para pas vitit 1999, duke ofruar një terren të frytshëm për fetarizimin e shoqërisë. Fillimisht vendi u ballafaqua me një dezorientim shoqëror, varfëri të lartë, ekonomi të dobët dhe dykuptimësi politike, të cilat e shndërruan Kosovën në tokë pjellore për rigjallërimin e religjionit. E tërë shoqëria kosovare shumë shpejt u ekspozua me një shumëllojshmëri të ideve konkurruese, të cilat në të njëjtën kohë ishin edhe më liberale dhe më konservative. Popullata e Kosovës e rrënuar nga lufta ju ekspozua organizata të ndryshme ndërkombëtare me bazë fetare dhe me agenda radikale, të cilat u përhapën në vend pas luftës. Nën maskën e ndihmës humanitare, këto

organizata kanë përdorur pa mëshirë varfërinë dhe kushtet shoqërore të kosovarëve, veçanërisht në hapësirat rurale, duke dëmtuar seriozisht traditat kulturore të këtyre komuniteteve. Veç kësaj, UNMIK-u, dhe bashkësia ndërkombëtare në përgjithësi, kanë përkushtuar pak ose aspak vëmendje ndaj aktiviteteve të këtyre “organizatave humanitare” me bazë fetare. Gjithashtu, duke qenë pa ndonjë strukturë të besueshme të inteligjencës, dhe pa kontroll të transaksioneve financiare, ishte shumë e vështirë që të përcilleshin aktivitetet e këtyre organizatave. Përveç kësaj, meqë statusi ligjor i bashkësive fetare kishte mbetur i pa definuar, ato kanë operuar pa ndonjë përgjegjësi publike për sa i përket organizimit dhe financimit të tyre. Për më tepër Fakulteti i Shkencave Islame edhe pse ka vazhduar të promovojë islamin tradicional, gjegjësisht “Shkollën Suni Hanefi”. për sa i përket plan-programit, me një përjashtim të gjuhës arabe dhe disa kurseve të filozofisë islame, ky fakultet ofron vetëm kurset e disiplinave tradicionale islame të interpretimit të Kuranit. Një realitet i tillë e ka bërë këtë institucion si fakultetin më së paku të hapur ndaj lëndëve jo-fetare në krahasim me fakultetet e tjera të shkencave islame në Ballkan, dhe i ka shkëputur studentët nga historia dhe traditat vendase.

Veç kësaj, gjatë kësaj periudhe, ndryshimet demokratike kanë mundësuar zhvillimin e lidhjeve të reja në mes të Kosovës dhe botës islame, duke favorizuar kështu përtëritjen e doktrinave të ndryshme religjioze. Rigjallërimi i islamit në Kosovë në njërën anë u ndikua nga organizatat e Arabisë Saudite dhe shtetet e Gjirit Persik, dhe Turqia në anën tjetër. Gjerësa, qëllimi primar i tyre ishte kontrollimi i jetës shpirtërore të popullatës, politizimi i islamit dhe inkurajimi i kundërshtimit të sekularizmit në Kosovë, qëllimi kryesor i shumicës së organizatave të Lindjes së Mesme ishte prezantimi dhe përforcimi i islamit radikal, i cili gjithashtu shkaktoi fërkime brenda Bashkësisë Islame të Kosovës. Për më tepër ata përpiqeshin të dobësojnë ndjenjën nacionale të shqiptarëve dhe qëndrimin të tyre pro-perëndimor që dominon në Kosovë, përmes forcimit të solidaritetit mysliman ndër shqiptar në llogari të identiteti etnik sekular . Si pasojë, çështja njëherë e pakontestuar rreth modelit të islamit në Kosovë, si model i veçantë tradicional, gradualisht filloi të ndryshojë, e me të edhe identiteti sekular etnik i shqiptarëve të Kosovës dhe bashkëjetesa e tyre fetare.

Periudha që nga Shpallja e Pavarësisë është e një rëndësie të jashtëzakonshme, pasi ajo karakterizohet me shfaqjen e disa faktorëve të posaçëm. Fillimisht, pavarësia e Kosovës nënkupton se elita politike kosovare, në veçanti qeveria, e kishte rritur autoritetin si dhe përgjegjësinë në lidhje me të gjitha çështjet e rëndësishme në vend. Së dyti, Shpallja e Pavarësisë formalizoi fillimin e një procesi të krijimit të një identiteti të ri kosovar për shqiptarët e Kosovës. Një proces i tillë krijoi një hapësirë shtesë për të manovruar dhe forcuar identitetin fetar (mysliman). Së treti, Shpallja e Pavarësisë së Kosovës koincidoi me ekspansionin global të rrjeteve radikale islamike, të

ashtuquajturave “Pranvera Arabe” dhe krijimin e të ashtuquajturit “Shtetit Islamik të Irakut dhe Sirisë “(ISIS). Këta faktorë së bashku kanë krijuar një realitet që ka rezultuar në radikalizmin dhe ekstremizmin e shtresave të caktuara të shqiptarëve myslimanë në Kosovë.

Qëndrimi i institucioneve të Kosovës dhe elitës së saj politike ndaj islamit politik në përgjithësi, dhe radikalizimit të tij në Kosovë, në veçanti, ka qenë i paqartë. Në njërin anë, politikanët e Kosovës kanë qenë të kujdesshëm që të distancojnë veten e tyre prej islamit politik, si pjesë e vizionit të tyre politik pro-evropian dhe pro-perëndimor. Poashtu, Kushtetuta, si dhe pjesa tjetër e legjislacionit është përpiluar mbi bazën sekulare dhe bashkëpunim të ngushtë me partnerët perëndimorë. Megjithatë, në anën tjetër, si institucionet ashtu edhe partitë politike nuk kanë arritur që të reagojnë ndaj shfaqjeve publike gjithnjë e në rritje të radikalizmit islam edhe përkundër detyrimit ligjor për ta bërë këtë. Një neglizhencë dhe politikë e tillë e mosndëshkimit e institucioneve të Kosovës ndaj individëve apo organizatave që nxisin urrejtje etnike dhe fetare padyshim ka kontribuar në inkurajimin e mëtejshëm të radikalizmit islamik në vend, dhe shtrembërimin e karakterit sekular të identitetit shqiptar dhe bashkëjetesës fetare.

Edhe pse të gjitha partitë kryesore politike në Kosovë janë sekulare, ato në përgjithësi kanë dështuar në adresimin e shenjave gjithnjë e në rritje të radikalizmit në mesin e shqiptarëve myslimanë të Kosovës. Me përjashtim të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e cila në mënyrë të hapur ka dënuar fjalimet e tilla publike, partitë e tjera politike kanë qëndruar mjaft të heshtura në këtë drejtim. Fatkeqësisht, shumica e partive të tjera politike kanë flirtuar me grupet e tilla radikale me qëllim të sigurimit të mbështetjes elektorale.

Për sa i përket religjionit dhe ndërrimit të identitetit në mesin e shqiptarëve të Kosovës, krijimi i identitetit të ri kosovar paraqet një pasojë tjetër të rëndësishme të pavarësisë së Kosovës. Shqiptarët e Kosovës, të cilët ndër shekuj kanë kultivuar një identitet të fortë etnik, pas pavarësisë janë përballur me një realitet paksa konfuz. Pas përfundimit të projektit politik për një Kosovë të pavarur, ata papritur ju ekspozuan lojaliteteve divergjente. Natyrisht, duke qenë një shtet i pavarur, Kosova u përballë me sfidën e krijimit të një identiteti kombëtar sekular, i cili do të mund të tejkalonte ndarjet etnike dhe fetare. Si rezultat, simbolet e shtetit të ri, si flamuri dhe himni kombëtar iu shmangën çdo simboli kombëtar shqiptar nga e kaluara. Megjithatë, “ri-brendimi” i Kosovës ka pasur në mënyrë të pashmangshme një ndikim denacionalizues mbi shqiptarët e Kosovës. Fatkeqësisht, në vend se identiteti shtetëror i Kosovës dhe ai shqiptar të trajtoheshin si komplementare, debatet politike në Kosovë shpeshherë i kanë portretizuar ato si ekskluzive. Një gjë e tillë pastaj e ka dobësuar identitetin historik tradicional shqiptar të shqiptarëve të Kosovës, në veçanti në mesin e të rinjve të Kosovës. Vakumi ideologjik i krijuar i ka dhënë hapësirë shtesë manovrimi për forcimin

e identitetit fetar (musliman) në kurriz të identitetit etnik, dhe radikalizimit eventual të një numri të caktuar të myslimanëve shqiptarë të Kosovës. Institucionet e Kosovës dhe partitë kryesore politike, nuk kanë arritur që të pajtojnë në një rën anë identitetin kosovar me atë shqiptar, si identitetet fetare me identitetin sekular etnik të shqiptarëve të Kosovës. Si pasojë, besnikëria e shqiptarëve të Kosovës nga koha e pavarësisë është zhvendosur ngadalë nga shqiptaria dhe shteti i Kosovës, në një identitet fetar, me shfaqjen e elementeve të islamit radikal.

Këto gjetje janë mbështetur në rezultatet e sondazheve të opinionit publik, të cilat qartë indikojnë një zhvendosje madhore të identitetit të shqiptarëve të Kosovës nga identiteti sekular etnik në një etni fetare. Për sa i përket nivelit të fetarizimit të identitetit, rezultatet tregojnë se ky nivel në mesin e shqiptarëve myslimanëve është më i lartë se sa ai i shqiptarëve të krishterë. Përveç kësaj, distanca socio-fetare në mes të myslimanëve është më e lartë se sa ajo në mes të krishterëve. Gjithashtu, distanca negative socio-fetare në mes të të krishterëve shqiptarë është më e ulët se sa ajo në mesin e myslimanëve shqiptarë, përkundër faktit se të krishterët janë minoritet. Një fakt interesant, është se niveli i mos-tolerancës së lartë dhe ekstreme në mesin e myslimanëve jo-praktikues është në grupmoshat nën 24 vjeçe, përderisa tek praktikuesit është në grupmoshat prej 25 deri në 34 vjeçe. Prandaj, ky fakt dëshmon që gjenerata e cila është e rritur ose ka arritur moshën e pjekurisë pas çlirimit të Kosovës është në shënjestër të ekstremizmit.

Në anën tjetër hulumtimi tregon që nuk ka ndonjë ndërlidhje të qartë në mes të nivelit arsimor dhe atij fetarizimit. Gjithashtu, rezultatet e hulumtimit tregojnë që standardi i jetesës nuk është përcaktues as i bashkëjetesës fetare dhe as i mos-tolerancës fetare dhe ekstremizmit. Këto rezultate sfidojnë seriozisht paradigmen socio-ekonomike për shpjegimin e mos-tolerancës fetare dhe ekstremizmit. Në vend të kësaj, paradigma ideologjike, siç është e dokumentuar gjithashtu edhe nga hulumtimi kualitativ, provon të jetë korniza shpjeguese për zhvendosjen e rëndësishme sociale dhe të identitetit në mesin e shqiptarëve të Kosovës, përkatësisht nga identiteti sekular etnik dhe bashkëjetesës fetare në një fetarizim të shpejtë etnik, me një rritje graduale të mos-tolerancën fetare dhe ekstremizmit.

Fakti më brengosës që nxirret nga këto gjetje është projektimi që nëse trendi i tanishëm i de-sekularizimit të identitetit etnik të shqiptarëve të Kosovës vazhdon me të njëjtin ritëm edhe në dy dekadat e ardhshme, atëherë në Kosovë shumë lehtë mund të shfaqen edhe tri sub-identitete nacionale, gjegjësisht, muslimanët shqiptar, krishterët shqiptar, dhe shqiptarët (e vjetër). Kjo pa dyshim që do të shënonte përfundimin e shqiptarizmit siç ne e njohim, e me të bashkë edhe fundi i Kosovës sekulare dhe pro-perëndimore.

Rekomandime:

- Institucionet qeveritare dhe udhëheqësit politik duhet që të prezantojnë një diskurs të përbashkët publik i cili do të promovonte identitet sekular dhe bashkëjetesën fetare në mesin e shqiptarëve të Kosovës, si dhe harmoninë në mes të identitetit etnik shqiptar dhe atij kosovar, të cilat janë mjetet më të natyrshme dhe më efikase në trajtimin e religjiozitetin politik, radikalizmit dhe ekstremizmit.
- Meqenëse karakteri sekular i identitetit etnik të shqiptarëve të Kosovës përkon me vlerat moderne evropiane dhe Kushtetutën e Kosovës, ai nuk duhet të shihet si një rrezik nga bashkësia ndërkombëtare për ndërtimin e një vendi koheziv multi-etnik; përkundrazi, një karakter i tillë duhet të konsiderohet si pasuria më e vlefshme për mbrojtjen e rendit të tij sekular kushtetues.
- Sistemi i drejtësisë i Kosovës duhet që shumë shpejt të zbatojë kornizën ligjore (Kodin Penal) ndaj gjuhës së urrejtjes, për sa i përket urrejtjes fetare dhe etnike, si dhe predikimit të ekstremizmit.
- Ligji për Bashkësitë Fetare duhet të miratohet sa më shpejt që të jetë e mundur, i cili duhet të përcakton vendin këtyre bashkësive në rendin sekular kushtetues të Kosovës, si dhe llogaridhënien e tyre financiare, përfshirë edhe Shkollat Kuranore të jashtë-ligjshme.
- Fakulteti i Shkencave Islame të Kosovës duhet të përfshijë në planprogramet etij edhe lëndët e Religjioneve Krahasuese, Historinë e Popullit Shqiptar dhe të Kosovës, si dhe Historinë e Shtetit dhe Ligjit Shqiptar, në mënyrë që t'i shmanget modeleve arsimore të mohimit të së kaluarës fetare dhe nacionale, me qëllim të kultivimit të bashkëjetesës ndër-fetare.
- Planprogramet e shkollave të mesme duhet të përfshijë lëndën mbi Historinë e identiteteve kulturore dhe fetare në Kosovë, përkatësisht krishterimit romak, krishterimit ortodoks, islamit dhe protestantizmit, në mënyrë që të forcojë mirëkuptimin reciprok dhe bashkëjetesën fetare në vend. Planprogrami dhe tekstet përkatëse duhet të porositen nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, që të hartohen nga një universitet ndërkombëtar i rangut më të lartë në këtë fushë.
- Prishtina duhet t'i korrigoj marrëdhëniet e saj me Ankaranë në lidhje me ndikimin fetar dhe nënvlerësimin e sekularizmit të shqiptarëve të Kosovës dhe të shtetit të Kosovës. Turqia duhet të kuptojnë se marrëdhëniet miqësore me Kosovën mund të zhvillohen në një mënyrë të shëndetshme, vetëm duke respektuar identitetin sekular etnik të shqiptarëve të Kosovës, si dhe interpretimin e tyre të së kaluarës historike.

ANEKSI I: Bibliografia

a) Libra, Revista, Raporte dhe Documente

1. Hupchick, Dennis P., *The Balkans: from Constantinople to Communism*. New York: Palgrave Macmillan, 2002
2. Misha, Piro, "Invention of Nationalism: Myth and Amnesia," in Stephanie Schwandner-Sievers and Bernard Fisher eds. *Albanian Identities: Myth and History*, London: Hurst, 2002
3. Vickers, Miranda, *Between Serb and Albanian: A History of Kosovo*. New York: Colombia University Press, 1998
4. Skendi, Stavro, *The Albanian National Awakening*, Princeton: Princeton University Press, 1967
5. Sami Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është, e çdo të bëhetë?*, Prishtinë: Dijsa, 1999 (This book that was originally published in 1899 in Bucharest)
6. Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit Shqiptar: lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*, Tiranë, Botime Përpjekja, 2012
7. G. W. Gawrych, *The Crescent and the Eagle: Ottoman Rule, Islam and the Albanians, 1874-1913*, London and New York, 2006
8. Pashko Vasa, "Oh, Albania, Poor Albania," in *Albanian Literature: A Short History* ed. Robert Elsie, London: I.B. Tauris, 2005
9. Licursi, Emiddio Pietro, "Empire of Nations: The Consolidation of Albanian and Turkish National Identities in the Late Ottoman Empire, 1878 – 1913," Bachelor Thesis, Columbia University, 2011
10. Hastings, Adrian, *The Construction of Nationhood: Ethnicity, Religion and Nationalism*, Cambridge University Press, 1997
11. Skendo Frasheri, "Fe Ç'është, Komp Ç'është," *Journal Albania*, Brussels, 25 June 1897
12. Bernd J. Fischer, "A Brief Historical Overview of the Development of Albanian Nationalism," Presented at East European Studies center discussion on March 23, 2005, Washington D.C
13. Noel Malcolm, "Myth of Albanian National Identity: Some Key Elements," in Schwandner-Sievers & Bernd J. Fischer eds. *Albanian Identities: Myth and History*, Indiana University Press, 2002
14. Csaba-Barnabas Horvath, "The Onset of Albanian Nationhood," *International Relations Quarterly*, Vol. 3, No. 2, Summer 2012
15. Guy, Nicola C., "Ethnic nationalism, the Great powers and the question of Albanian independence, 1912-1921," PhD thesis, Durham University. Department of History, 2008
16. Jonilda Rrapaj and Klevis Kolasi, "The Curious Case of Albanian Nationalism: the Crooked Line from a Scattered Array of Clans to a Nation-State" *The Turkish Yearbook of International Relations*, Volume 44, 2013, Ankara University, Faculty of Political Science.
17. Payton, James R. Jr., "Ottoman Millet, Religious Nationalism, and Civil Society: Focus on Kosovo," *Occasional Papers on Religion in Eastern Europe*: Vol. 26: Issues 1, Article 2, 2006
18. Roumen Daskalov and Alexander Vezenkov eds., *Entangled Histories of the Balkans - Volume Three: Shared Pasts, Disputed Legacies*, Brill, 2015
19. Duijzings, Ger, *Religion and Politics in the Identity of Kosovo*, London: Hurst & Company, 2000
20. Barbara Jelavich, *History of the Balkans: Twentieth Century*, Cambridge, Cambridge University Press, 1999
21. Perry, Duncan, "Conflicting Ambitions and Shared Fates: The Past, Present and Future of Albanians and Macedonians," in Victor Roudometof ed., *The Macedonian Question: Culture, Historiography, Politics*, Boulder: Columbia University Press, 2000.

22. Judah, Tim, *Kosovo: What Everyone Needs to Know*, Oxford: Oxford University Press, 2008.
23. Poulton, Hugh, *Who Are the Macedonians?*, London: Hurst, 1995.
24. Gewehr, Wesley M., *The Rise of Nationalism in the Balkans, 1800-1930*. New York: H. Holt and Company, 1931
25. Gallagher, Tom, *Outcast Europe: The Balkans, 1789-1989*. London: Routledge, 2001
26. Carnegie Endowment for International Peace, *Report of the International Commission to Inquire into the Causes and Conduct of the Balkan Wars*, Washington, D.C., 1914, <http://www.archive.org/details/reportofinternat00inteuoft>
27. Perritt, Jr Henry, *The Road to Independence for Kosovo: A Chronicle of the Ahtisaari Plan*, Cambridge: Cambridge University Press, 2010
28. Merdjanova, Ina, *Rediscovering the Umma: Muslims in the Balkans between Nationalism and Transnationalism*, Oxford University Press, 2013
29. Malcolm, Noel, *Kosovo: A Short History*, New York: New York University Press, 1998
30. Vokri, A., *Shkollat dhe arsimit në Kosovë ndërmjet dy Luftërave Botërore (1918–1941)*, Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Kosovës, 1990
31. Pirraku, M., "Kulturno-prosvetni pokret Albanaca u Jugoslaviji (1919–1941)," *Jugoslavenski istorijski casopis* 1–4, 1978
32. Banac, Ivo, *The National Question in Yugoslavia: Origins, History, Politics*, Ithaca, NY: Cornell University Press, 1984
33. Calic, Marie-Janine, "Kosovo in the twentieth century: A Historical Account," in Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur eds. *Kosovo and the Challenge of Humanitarian Intervention: Selective Indignation, Collective Action, and International Citizenship*, Tokyo: United Nations University Press, 2000
34. Rusinow, Dennison, *The Yugoslav Experiment 1958-1974*. Berkeley and Los Angeles: University of California Press, 1977
35. Iseni, Bashkim, "National Identity, Islam and Politics in the Balkan," *Brückenschläge - "Bosnischer Islam" für Europa*, Stuttgart-Hohenheim, 20-22.11.2009
36. Gagnon, V. P., "Ethnic Nationalism and International Conflict: The Case of Serbia," *International Security*, Vol. 19, No. 3, Winter 1995
37. Muhamedin Kullashi, "Kosovo and Disintegration of Yugoslavia," in Dusan Janjic and Shkelzen Maliqi, eds. *Conflict or Dialogue: Serbian-Albanian Relations and Integration of the Balkans*, Subotica: Open University, 1994
38. Agani, Mentor, "The Integration of Kosovo's Political Parties in International Political Party Organizations: An Explanation of the Delay," Prishtina: KIPRED and KAS, 2015
39. Maliqi, Shkelzen, "Self-Understanding of the Albanians in Nonviolence," in D. Janjic´ and S. Maliqi (eds), *Conflict or Dialogue: Serbian-Albanian relations and integration of the Balkans*, Subotica, 1994
40. Clark, Howard, *Civil Resistance in Kosovo*, London: Pluto Press, 2000
41. Kostovicova, Denisa, *The Politics of Identity and Space*, New York: Routledge, 2005
42. Pula, Besnik, "The Emergence of the Kosovo 'Parallel State' 1988-1992," *Nationalities Papers* 32, no. 4 (December 2004)
43. Kastrati, Ardian, "Civil Society Development and its Impact on the Democratization Process in Kosovo," *Mediterranean Journal of Social Sciences*, Vol. 6 No. 2 S5, April 2015
44. Pratt, Suzana, "Gjakmarrja: Albanian Blood Feuds and Restorative Applications of Traditional Justice," GAPS Conference submission, 2013, p. 13; <https://www.academia.edu/4654081/Gjakmarrja>
<https://www.academia.edu/4654081/Gjakmarrja> (25.04.2016)

45. Clark, Howard, "Nonviolent Struggle in Kosovo," *War Resisters' International*, 1 January 2001; <http://www.wri-irg.org/nonviolence/nvse16-en.htm> (25.04.2016).
46. Totten, Michael J., "Kosovo's Moderate Muslims: The world's newest country is a model of tolerance," *The Wall Street Journal*, 30 December 2008; <http://www.wsj.com/articles/SB123059201269240805> (25.04.2016).
47. "Administration and Governance in Kosovo: Lesson learned and lessons to be learned," Pristina-Geneva: Kosovar Institute for Policy Research and Development, June 2005
48. Yannis, Alexandros, "The UN as Government in Kosovo," *Global Governance* 10, 2004
49. "UNHCR Shelter Verification: Agency Coverage," UNHCR GIS Unit, Pristina, Kosovo, 9 November 1999
50. Blumi, Isa, "Political Islam among the Albanians: Are the Taliban coming to the Balkans?," Policy Research Series, Paper #2, Prishtina: KIPRED, 2005
51. Blumi, Isa. "Religion and Politics among Albanians of Southeastern Europe," in *Religion and Politics in Central and Southeastern Europe: Challenges since 1989*, ed. Sabrina P. Ramet, New York: Palgrave, 2014
52. Mehmeti, Jeton, "Faith and Politics in Kosovo: The Status of Religious Communities in a Secular Country," in *The Revival of Islam in the Balkans: From Identity to Religiosity*, ed. Arolda Elbasani and Olivier Roy, New York: Palgrave Macmillan, 2015
53. Blumi, Isa, "Religion and Politics among Albanians of Southeastern Europe," 2014
54. Blumi, Isa, "Albanians' Islam[s]," in *Handbook for European Islam*, ed. Jocelyne Caesari, New York: Oxford University Press, 2014
55. International Crisis Group, "Religion in Kosovo," *ICG Balkans Report N° 105*, Pristina/Brussels, 31 January 2001
56. Kursani, Shpend, "Report inquiring into the causes and consequences of Kosovo citizens' involvement as foreign fighters in Syria and Iraq," Kosovar Center for Security Studies. April 2015
57. Bougarel, Xavier, "The New Balkan Islam," *Regional Issues*, ISIM Newsletter, No.6, 2000
58. International Crisis Group, "Religion in Kosovo," 2001
59. "Curriculum of Islamic Studies," The Faculty of Islamic Studies, Prishtina, 2016
60. Deliso, Christopher, *The Coming Balkan Caliphate: The Threat of Radical Islam to Europe and the West*, Westport and London: Praeger Security International, 2007
61. Öktem, Kerem, "New Islamic actors after the Wahhabi intermezzo: Turkey's return to the Muslim Balkans," paper presented at the conference "After the Wahhabi Mirage: Islam, Politics, and International Networks in the Balkans," European Studies Centre, Oxford University, June 2010
62. Fazlic, Hasim, "Islam in the successor states of Former Yugoslavia - Religious changes in the post-communist Balkans from 1989-2009," PhD Thesis, University of Birmingham, 2011
63. Philips, David, "Turkey's Islamist Agenda in Kosovo," *The World Post*, 29 December 2015; http://www.huffingtonpost.com/david-l-phillips/turkeys-islamist-agenda-i_b_8891634.html
64. United Nations, "Report of the Special Envoy of the Secretary-General on Kosovo's Future Status," S/2007/168, 26 March 2007
65. Tansey, Oisín, "Kosovo: Independence and Tutelage," *Journal of Democracy*, Vol. 20, No. 2, April 2009
66. "The Constitution of Kosovo," Assembly of the Republic of Kosovo, Prishtina, 15 June 2008
67. Berishaj, Anton, "Religion and Politics in Kosovo," in Gorana Ognjenović and Jasna Jozelić eds. *Politicization of Religion, the Power of State, Nation, and Faith: The Case of Former Yugoslavia and its Successor States*, New York: Palgrave Macmillan, 2014
68. Basha, Dimal, "Globalization and the Rise of Salafism in Kosovo. How Gulf Countries Spearheaded a Transnational Advocacy Network that is Challenging a New Democracy," The New School University, Master of Arts Thesis, 2013

69. Kosovo International Religious Freedom Report for 2014," United States Department of State, Bureau of Democracy, Human Rights, and Labor, 2014
70. Gul, Imtiaz, "Transnational Islamic Networks," International Review of the Red Cross, Vol. 92 No. 880, December 2010
71. Toby Dodge eds., "After the Arab Spring: Power Shift in the Middle East?," IDEAS Report, London School of Economics, May 2012
72. Bradley, John R., After the Arab Spring: How Islamists Hijacked The Middle East Revolts, St. Martin's Press, 2012
73. Al-Alawi, Irfan, "Extremists Establish Foothold in the Balkans," Gatestone Institute, 24 September 2012
74. "Strategy on Prevention of Violent Extremism and Radicalization Leading to Terrorism 2015-2020" Office of the Prime-Minister, Republic of Kosovo, September 2015
75. "Country Reports on Terrorism 2015," United States Department of State Publication, Bureau of Counterterrorism and Countering Violent Extremism, June 2016

Intervistat:

1. Dr. Fatmir Sejdiu, ish - President i Republikës së Kosovës dhe ish - President i LDK-së, Prishtinë, 10 shkurt 2016
2. Agim Çeku, ish - Kryeministër i Republikës së Kosovës, ish-Ministër I Forcës së Sigurisë dhe deputet i Kuvendit të Kosovës, Prishtinë, 07 prill 2016
3. Albin Kurti, ish – Kryetar i Vetëvendosjes dhe deputet i Kuvendit të Kosovës, 04 April 2016.
4. Ramush Haradinaj, ish – Kryeministër i Republikës së Kosovës, Kryetar i AAK-së, Prishtinë, 10 Mars 2016
5. Dr. Anton Berishaj, Profesor në Universitetin e Prishtinës, Prishtinë, 10 shkurt 2016
6. Dr. Xhabir Hamiti, Profesor në Fakultetin e Studimeve Islame në Kosovë, Prishtinë, 10 Mars 2016
7. Dr. Naim Ternava, Kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 24 mars 2016
8. Dr. Don Shan Zefi, Kancelar i Kishës Katolike në Kosovë, Prizren, 31 mars 2016.
